Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 12 (92). DHJETOR 2013. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.



Market KEN

Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

RRETH E RROTULL-A

Ç'kemi asaj Dibre!

Nga **BUJAR KAROSHI** - FAQE 2

ESE

Punëtori i thjeshtë i shkrimtarisë..

Nga **RAMIZ GJINI** - FAQE 11

BOTIME

Në një odë dibrane me Haziz Ndreun

Nga **VIRON KONA** - FAQE 15

REPORTAZH

Ismail Keta, tre herë Kampion Bote

Nga **DEFRIM METHASANI** - FAQE 12-13

Çfarë do të ndodhë me **ujërat e Radikës?**

Një panoramë e çështjes dhe skenat dhe prapaskenat mes qeverisë së Maqedonisë dhe Shqipërisë? A do t'i merret ujërat Radikës dhe nëse ndodh, sa ujë do ti merret dhe cilat janë ndikimet në mjedis? Një vështrim "Pro" dhe "Kundër" që nga nisja e kësaj historie deri më sot.

kryesore



A ka **dritë** në fund të tunelit?

Viti që po lëmë pas ka shënuar një histori të rëndësishme të shoqërisë civile, përsa i përket përpjekjeve për sensibilizim të opinionit dhe qeverisë në rrugën e Arbrit. Që nga nisja e peticionit online më 18 mars 2013, iniciuar nga Dr. Gëzim Alpion, profesor në Universitetin e Birmingamit, mbi 5 mijë qytetarë e kanë firmosur atë online dhe në letër, duke treguar domosdoshmërinë e ndërtimit të saj sa më shpejt dhe sa më mirë.

FAQE 3

refleksione

Maqellarë, festë dhe firma ditën e Krishtlindjes



Nga **IDA NURÇE** - FAQE 2

Për shumë vjet
Vitin e Ri!

Ardhtë me
Rrugën e Arbërit
dhe mos shteroftë Radikën!

Kontribuo për vendlindjen duke u pajtuar në gazetën

RRUGA E ARBËRIT

Merr versionin PDF ose kopjen print.

Për informacion shkruaj: rrugaearberit@gmail.com

Çështja e ujëravë të Radikës po gjen një vend të gjerë ne mjedisin mediatik dhe politik në Maqedoni dhe Shqipëri. Gazeta "Rruga e Arbërit" i ka kushtuar një vend të rëndësishsëm kësaj çështje që në Mars 2012, me një shkrim të Prof. dr. ing. Abdyl Koleci, por për më shumë se një vit, asnjë institucion apo organizëm joqeveritar nuk u interesua. Vetëm gjatë verës disa qytetarë filluan të kërkonin reagime publike lidhur me çështjen dhe në gusht 2013, institucionet vendore në Komunën e Dibrës së Madhe reaguan kundër projektit, për të ardhur sot në fund të vitit, si çështje themelore dhe e paszgjidhur mes Maqedonisë dhe Shqipërisë.

Po si kanë rrjedhur ngjarjet rreth devijimit të ujërave të Radikës?

(Lexoni në faqet 4-5)

opinion

Radika është pjesë e **historisë** dhe **kulturës** shqiptare

Nuk është me rëndësi se cila do të jetë sasia e ujit që do t'i rrëmbehet Radikës: një pjesë e tij, gjysma apo edhe në tërësi (informatat lidhur me këtë janë kontradiktore); shqetësues është fakti që po preket një pasuri natyrore, një lumë, ndër më të pastrit në Evropë, uji i të cilit, qoftë edhe pjesërisht, nuk do të derdhet më në detin Adriatik, si gjithmonë, prejse mbahet mend, por në detin Egje!

Nga **AGIM VINCA** - FAQE 6

oponence mjedisore

Rrezikohet Rrëqebulli i Ballkanit në Maqedoni

Në mënyrë ironike, kur kërkuam leje për të vizituar zonën e "Fusha e Llukovës" jo vetëm që na u mohua leja por autoritetet kërkuan që të ishte e nevojshme që disa prej stafit të tyre të mbikqyrnin praninë tonë. Ne besojmë që disa prej zonave duhet të jenë dukshëm zona të ndaluara, por kjo duhet të aplikohet si për buldozerët ashtu edhe për ambientalistët...

Nga **PETR HLOBIL** - FAQE 7

cyan magenta yellow black 1

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 12 (92). 1 - 30 Dhjetor 2013

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Njoftojmë zotërinjtë: Xh.Martini, H.Gonxhja, M. Dume, S.Mëziu, I.Cani, H.Përnezha, M. Buci, J.Selmani, D.Tërshalla, se shkrimet e tyre janë në redaksi dhe do të shqyrtohen për botim në numrat e ardhshëm.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.

Arkivi i gazetës është pa pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

KËSHILLI BOTUES:

Musa Riçku
Mentor Hoxha
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Kontribuan për këtë numër:
Agim VINCA
Adem BUNGURI
Viron KONA
Gafur MUKA
Naim PLAKU
Arian KADIU
Ramiz GJINI
Vehbi BAJRAMI
Petr HLOBIL
Afrim KAROSHI
Ida NURÇE
Hysen LIKDISHA
Defrim METHASANI
Gazmend KËRKUTI
Ilmi DERVISHI
Beqir SINA
Destan RAMA
Selman MEZIU
Xhelal ROÇI
Sali AJAZI

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Maqellarë, festë dhe firma ditën e Krishtlindjes

Nga ***IDA NURÇE***

Në ditën e Krishtlindjes, në komunën e Maqellarës letrat e peticionit po "hidhnin valle" në rrugët e saj. Edhe pse ishte ditë feste, gatishmëria për të plotësuar "zërin tonë" nuk mungoi. U dynda nëpër rrugët e fshati, duke takuar njerëz nga shtresa të ndryshme. Po u tregoja rreth peticionit dhe sapo dëgjonin 'Rruga e Arbrit', u shkëlqenin sytë nga gëzimi. Më dëgjonin tërë kërshëri, teksa u shpjegoja për peticionin. Treguan një gatishmëri të parezistueshme. Dukej qartë që donin të dilnin sa më parë nga ky mjerim i mjerë. Madje, kishte edhe nga ata që thonin "Do të të jap 10 firma, vetëm të na bëhet ajo rrugë".

Bisedova me biznesmenë, shitës, farmacistë, punëtorë, fshatarë dhe e vetmja dëshirë që i bashkonte ishte të firmosnin peticionin. Kërkonin të dëgjohej zëri i tyre dhe të kishin mundësi të ecnin nëpër rrugën që na afron me kryeqendrën, me pjesën e lirë...

Gjatë bashkëbisedimit me to, hidheshin batuta, ca me shpoti e ca për të qeshur. Por u treguan të qetë e të komunikueshëm. Treguan vlerat e vërteta të dibranëve, kulturën e tyre. Me prisnin me buzëqeshje dhe krejt miqësisht. Sa mirë u ndjeva nga ky komunikim i munguar prej kohësh. Peticioni më ndihmoi të zbuloj edhe një pjesë tjetër të dibranëve: kurajën, guximin dhe gatishmërinë për të mbrojtur trojet e tyre. Për të "çliruar vendin e tyre". Siç tha edhe një nënshkrues sot: " Ku ta gjej të ndërtohet ajo rrugë? E ku ka gjë më të mirë?"

Sot ishte Krishtlindje. Dhe dhurata më e bukur për në do ishte "rregullimi i Rrugës së Arbrit". Por ajo nuk vjen dot brenda natës. Ndoshta, duke e dashur Shqipërinë dhe duke punuar mirë, na vjen edhe Rruga e Arbrit si dhuratë për Krishtlindjet e ardhshme!



Kontribuo për vendlindjen duke u pajtuar në gazetën

RRUGA E ARBËRIT

Merr versionin PDF ose kopjen print.

Për informacion shkruaj: rrugaearberit@gmail.com

Abonimi vjetor kushton 600 lekë

rreth e rrotull-a

Ç'kemi asaj Dibre!

Nga **BUJAR KAROSHI**

Ky muaj nisi me grevë urie në Bulqizë. Por dy ditë e pat puna e grevës. Të tretën mbaroi. Shkoi puna e grevës si lojë kukafsheti: Të kapa, e zura, iku më shpëtoi!

Andej nga Dibra zien mileti për ujin e Radikës. Dhe nuk kanë faj! U bë peticion, firmosi i madh e i vogël, burra dhe gra, të papunë e zyrtarë, qytetarë e qeveritarë, madje firmosi edhe përfaqësuesi i ELEM-it bashkë me dy ministra. U dorëzua peticioni edhe në qeveri. Por..., projekti vazhdon. Një ministër i qeverisë së Shkupit shkoi mes vllaznëve dibranë dhe u tha: "Derisa ju jeni kundër projektit, edhe unë jam kundër". Ndërsa në Tiranë u hapën letrat dhe doli se ai ia paska propozuar ministrit shqiptar kërkesën me i dhanë veç 2 metër kub ujë në sekondë ti kalojë andej nga Vardari... Ma vonë doli se për 2 metër donin me marrë leje, ndërsa metrat e tjera i vidhnin pa leje...

Si është puna andej nga New Yorku? Më thanë është bërë një protestë e madhe për të mbrojt Radikën? Kishte pas më shumë parulla se njerëz!

Ca hajdutë hynë në një banesë në Bulqizë dhe dhunuan një fëmijë 13 vjeçar. I mituri thotë se është goditur me lopatë në kokë nga grabitësit. Kur u pyet se a i njohu hajdutët, ai tha se nuk e di kush janë, pasi në lagje ka shumë hajdutë...

Këndej është hapur një debat i madh për tatimin mbi rrogat. Opozita thotë janë rritur, qeveria thotë janë ulur. Dhe mora në telefon një mikun tim në Dibër ta pyesja se ç'mendonte. Dhe ai më tha: "Ma gjej një vend punë asaj Tiranë ose knej ka Dibra, pastaj ta thom se çmendoj për tatimin"...

Këto ditë u zbulua edhe pse nuk ecnin punimet në Rrugën e Arbrit! Një patriot i joni i kishte blloku llogaritë bankare firmës që ndërtonte. Firma nuk kishte paguar punëtorët, punëtorët nuk kishin punuar, pa punë rrugë nuk bëhet, ndaj ... kanë ngecur punimet! Tani, që të fillojnë punimet duhet zhbllokuar llogaria, që të zhbllokohet llogaria duhet vendim gjykate, që të dalë vendimi i gjykatës duhet zhvilluar gjyqi, sa të vendosë gjyqi duhen ca muaj, kështu që punimet do vonohen... Me sa duket, që të mbarojë rruga ka mbetë me marrë kazmat e me shku me punu vullnetarë, si dikur...

Ku është qeveria, do më thuash ti, pse nuk ndërhyn? Ndërhyn edhe ajo e shkretë qeveri ndërhyn, por kanë ndryshuar kohërat. Dikur thoshim se "qeveria e kap lepurin me qerre", ndërsa sot "ta ngre çarkun me telefon"...

Një fshat në Dibër e kaloi muajin pa drita. Ishte dëmtuar transformatori. Kur shkuan të elektrikut për ta rregulluar, pjesët e transformatorit ishin shitur për skrap.

Një faqe në Facebook shtroi një pyetje si për natë dimri: Për çfarë njihet katundi juaj? Ishte statusi më i komentuar dhe ku unë mësova xhevahire. P.sh. ca thoshin se katundi im njihet për *garipa*, ca të tjerë për *magjar*, pastaj vazhdonin se katundet e tyre njiheshin për *hajdutë*, për *fudullojk* e për *trejma*, për *alkël* e *politikanë*, për *qen* e *grësh*, për *budallenj* dhe *kunja*, për *krosa* e *pijanecë*, për *sherr, dajak, grusht t'thatë*, për *gjela*, *tërngëllik* e për *rehatllik*, për *hallvë* dhe *petlla*, e kështu me radhë llojë-llojë xhevahiresh. Ndërsa unë e dija se dibranët janë punëtorë, fjalëpak, trima e të besës!

Në fund fare, i shkrova një miku dhe i kërkova të firmoste për Rrugën e Arbrit dhe kundër devijimit të ujërave të Radikës. Dhe ai me shkroi:

"Unë, filani nga Belgjika jam kundër devijimit të lumit Radika. Unë me gjithë familje, gruan dhe fëmijët, prindërit, motrat dhe vëllezërit, gjithë dashamajrt, shokt e miqt, nga katundi e qiteti, nga Tirana deri n'Konispol, nga Greqia deri n'Gjermani, kudo si jemi, e mbështesim iniciativën tuj dhe ju thom: Zoti ua baftë kabull! Amin! "

kryesore



RRUGA E ARBRIT

A ka **dritë** në fund të tunelit?

Në foto: Tuneli i Qafës së Tujanit, ndërtuar larg standardeve të kërkuara. Foto: © Bujar Karoshi

Viti që po lëmë pas ka shënuar një histori të rëndësishme të shoqërisë civile, përsa i përket përpjekjeve për sensibilizim të opinionit dhe qeverisë në rrugën e Arbrit. Që nga nisja e peticionit online më 18 mars 2013, iniciuar nga Dr. Gëzim Alpion, profesor në Universitetin e Birmingamit, mbi 5 mijë qytetarë e kanë firmosur atë online dhe në letër, duke treguar domosdoshmërinë e ndërtimit të saj sa më shpejt dhe sa më mirë.

Partitë politike djathtas dhe majtas e patën këtë premtim në agjendën e tyre gjatë fushatës elektorale, dhe si e tillë pati edhe ndikimin e saj mbi zgjedhjet e qershorit.

Ndërsa qeveria e djathtë e pati prioritet në program rrugën e Arbrit gjatë 8 viteve të mandatit të saj, në praktikë realizoi një projekt të mangët me plot defekte dhe probleme, ndërsa kandidati për kryeministër i opozitës Edi Rama, e shtroi çështjen më parimore se kurrë më parë. "Ky (Rruga e Arbërit) është një projekt kombëtar, është një projekt shumë i rëndësishëm jo vetëm për ju, por është shumë i rëndësishëm për Shqipërinë. Është një projekt që nuk garanton thjeshtë lëvizjen, nuk shkurton lëvizjen thjeshtë, po garanton një zhvillim për një territor të tërë që tani është jashtë hapësirës së zhvillimit dhe është një projekt që për ne hyn tek projektet strategjike që ne do ta çojmë përpara me shumë vullnet", - ka thënë kryetari i Partisë Socialiste gjatë fushatës elektorale në Klos më 12 qershor 2013. Të njëjtën gjë Kryeministri Edi Rama tha edhe në prezantimin e programit të qeverisë në parlament më 11 shtator 2013. Duke folur për pikat e rëndësishme të programit të qeverisë së tij, ai përmendi "Projektin e zhvillimit në infrastrukturë duke nisur nga Rruga e Arbrit si prioritet...".

Firmat e peticionit patën edhe një jehonë mediatike nga media shqiptare dhe të huaja, duke e bërë çështjen të prekshme për çdo shqiptar dhe mik të Shqipërisë në të katër anët e botës.

Dr. Gëzim Alpion i tha korrespondentit të gazetës "Rr.A." se kanë filluar procedurat e dorëzimit zyrtar të peticionit, ashtu siç ishte premtuar në nisje të peticionit, dhe për këtë jemi duke vendosur kontakte me qeverinë shqiptare dhe institucione të tjera, dhe në fillim të pranverës së ardhshme do të kemi një fushatë lobimi në Tiranë me qeveritarë, parlamentarë, ministra, anëtarë të shoqërisë civile dhe grupe interesi, për të bërë të mundur që Rrugë e Arbrit të mos mbetet një rrugë e harruar".

"Ndërkohë që presim të dëgjojmë nga Kryeministri i Shqipërisë, z. Edi Rama, për kërkesën që i kemi paraqitur për takim, për t'i dorëzuar peticionin për Rrugën e Arbrit, Kryetari i Kuvendit të Shqipërise, z. Ilir Meta, ka konfirmuar se do të takohet me delegacionin e intelektualëve dibranë gjatë vizitës së tyre në Tiranë", tha Alpion. "Me këtë rast, tha ai, ne sigurojmë të gjithë qytetarët që e kanë firmosur dhe të gjithë ata që do ta bëjnë një gjë të tillë në vazhdim, se ne do jemi këmbëngulës deri në përfundimin e metrit të fundit të rrugës, me cilësi dhe standarde".

Ndërkohë, në parlamentin po diskutohet draftbuxheti i vitit 2014 dhe qeveria është përqendruar në shlyerjen e borxheve të prapambetura dhe në investimet në rrugët e mbetura përgjysëm, njëra prej të cilave është edhe Rruga e Arbrit.

Por ndërkohë, Edmond Haxhinasto, Ministri Transportit dhe Infrastrukturës, në një intervistë për televizionin kombëtar "Vizion Plus", duke folur për investimet në rrugë, tha se "po bëjmë përpjekjet maksimale për të konkluduar dhe filluar vitin e ardhshëm një segment të rëndësishëm të Rrugës së Arbrit. Urojmë që të konkludojmë një marrëveshje konsencionare me një investitor të rëndësishëm strategjik në këtë rrugë". Por ai nuk tha se cili ishte ky investitor dhe nuk dha ndonjë afat kohor.

Punimet e para në Rrugën e Arbrit kanë filluar më shumë se 8 vjet më parë, më 3 korrik 2005, kur një ekskavator gërmoi pak dhè në Fushë Bulqizë, te vendi i quajtur Gurët e Skënderbeut, sa për të prerë kryeministri i atëhershëm një shirit inaugurimi. Por tenderi i parë për një segment të rrugës nga Bulqiza te Ura e Çerenecit u zhvillua në Tetor 2007 për të filluar punimet në fund të atij viti. Disa segmente të tjera, nga Bulqiza drejt Urës së Vashës dhe nga Tirana për në Qafë të Tujanit janë në ndërtim. Ndërkohë që zyrtarisht thuhet se kanë përfunduar projektet e zbatimit dhe janë gati për tenderim edhe rreth 34 km rrugë, ekspertë të fushës, inxhinierë, specialistë si dhe anëtarë të shoqërisë civile thonë se Rruga e Arbrit nuk ka filluar, pasi segmentet e ndërtuara janë larg standardeve të kërkuara.

Mes debateve për nevojën për ndërtim me standarde dhe mungesën e financimeve, a është koncensioni një dritë në fund të tunelit për Rrugën e Arbrit?

> "Kanë filluar procedurat e dorëzimit zyrtar të peticionit, ashtu siç ishte premtuar në nisje të peticionit, dhe për këtë jemi duke vendosur kontakte me qeverinë shqiptare dhe institucione të tjera, dhe në fillim të pranverës së ardhshme do të kemi një fushatë lobimi në Tiranë me qeveritarë, parlamentarë, ministra, anëtarë të shoqërisë civile dhe grupe interesi, për të bërë të mundur që Rrugë e Arbrit të mos mbetet një rrugë e harruar".

Komente në faqen e peticionit **change.org**



Firmos dhe **komento peticionit** në **change.org**

http://www.change.org/en-GB/petitions/complete-the-construction-of-the-arb%C3%ABri-road-nd%C3%ABrtoni-sa-m%C3%AB-shpejt-dhe-me-standarde-rrug%C3%ABn-e-arb%C3%ABrit?utm_campaign=petition_created&utm_medium=email&utm_source=guides

Njazi Vranezi, PESHKOPI, ALBANIA: Kjo rrugë është e nevojshme për të tërë trojet shqiptare duke shërbyer si urë lidhëse të Shqipërisë verilindore me Lindjen e Mesme dhe me gjerë.

Bardhul Marke, DEBAR, MACEDONIA: Kjo rrugë do na lidhë me kryeqytetin e shqiptarisë, dhe vetëm për 80 km do jem atje, mund të shkoj të pi kafe dhe të kthehem në shtëpi.

Najada Mehmeti, PESHKOPI, ALBANIA: Do të ishte një ndryshim rrënjësor për të gjithë qytetarët e Peshkopisë dhe të Shqipërisë :)

Fatos Ylli, TIRANA, ALBANIA "Një rrugë e re mbi gjurmët e një rrugë të shumë të vjetër

Ana Bino, VERONA, ITALY: Koha është flori!

Ragip Gashi, PRISHTINë, KOSOVO: Sa mund të gjykoj unë, po më duket se kjo rrugë qenka "RRUGA E KOMBIT" - 2, sipas pozitës që e paska. I thërras të gjithë të përgjegjshmit (sidomos politikanët tanë) të mos grinden e përçahen aq shumë me njëri-tjetrin për çështje pushteti se kush e mban karrigen, por le të merren më shumë me çështje të këtilla që e çojnë përpara kombin tonë, sepse jemi akoma komb i pazhvilluar...!

Esmeralda Mikli, PESHKOPI, ALBANIA: Sepse është jetike për banorët e Peshkopisë

Jeton Muça, STRUGA, MACEDONIA: Vende të bukura dhe njerëz të mrekullueshëm që jetojnë andej. Ata e meritojnë rrugën.

Lulzime Nuhiji, DEBAR, MACEDONIA: Vende të bukura dhe njerëz të mrekullueshëm që jetojnë andej. Ata e meritojnë të jetojnë më mirë.

Ronjet Pilafi, PESHKOPI, ALBANIA: Është e rëndësishme për vetë faktin se ky është vendi me më histori në tërë Shqipërinë dhe Dibranët e meritojnë të paktën mundësinë e vetme për t'u lidhur me Tiranën dhe me vendet e tjera me afër se kurrë se janë njerëz që i duhen kësaj Shqipërie në këtë gjendje që është .....

Aida Mali, SHKODRA, ALBANIA; për ndryshim.

Ylli Bara, DURRËS, ALBANIA: Unë dua të vizitoj vendlindjen time kur të dua dhe të mos dërrmohem për të udhëtuar andej.

Renata Nuhiju, DEBAR, MACEDONIA: Për të rikthyer dinjitetin dhe vlerën një qyteti mijëvjeçar, ashtu si e ka krijuar natyra, të cilën armiqtë kanë dashur ta shkatërrojnë!

Malfor Saja, KRUJË DISTRICT, ALBANIA: Është e rëndësishme për të gjithë vendin tim :)

Mirela Jaupaj, TIRANA, ALBANIA: Për të na lidhur me pjesën tjetër të Shqipërisë në të gjitha kuptimet

Aleksandër Huna, PESHKOPI, ALBANIA: për rrugën e Arbërit.

Admir Begu, DIBËR, ALBANIA: të bëhet rruga o dalim në protesta shkatërrojmë vendin.

Leonard Seferi, ESKIŞEHIR, TURKEY: Sepse do të ndihmojë të zhvillohet e gjithë kjo zonë e mrekullueshme. Do të lidhë Shqipërinë me Shqiptarët e Maqedonisë! Do të krijojë mundësi të reja punësimi për brezin e ri të cilët jetojnë atje.

Halim Ilnica, TIRANA, ALBANIA: Sepse e lidh vendlindjen time me kryeqytetin e Shqipërisë në një orë.

Cani Bujar, ELBASAN, ALBANIA: Po jam dakord shumë me këtë peticion edhe si biri i kësaj treve të lavdishme shqiptare.

Mario Mario, ITALY: sa ma shpejt t'na bëhet rruga e Arbrit.

Esi Ersi, PESHKOPI, ALBANIA: Për zhvillimin e zonës verilindore.

Gjylsime Hoxha, PESHKOPI, ALBANIA: është e rëndësishme për zhvillimin e mëtejshem të ekonomisë dhe të mirëqënies sociale që këtyre zonave.

Laçi Flamur, TIRANA, ALBANIA: Rruga e Arbërit është një vlerë kombëtare dhe ndërajonale, që lehtëson jo vetëm Dibranët por lidh dhe shqiptarët e Maqedonisë, u jep një shtysë të gjithë shqiptarëve për zhvillim dhe ndërtim, gjithashtu ndikon dhe në rritjen e shkëmbimeve të mallrave midis dy shteteve, rritjen e të ardhurave në buxhet... kështu që i kërkoj qeverisë shqiptare të marrë parasysh gjithë resurset e kësaj rruge, dhe ta ndërtoj sa më parë...

Anjesa Skura, PESHKOPI, ALBANIA: Sepse është qyteti im.

Herman Lami, TIRANA, ALBANIA: shkurtimi rrugës Tiranë - Peshkopi.

Redon Veliu, PESHKOPI, ALBANIA: Jam nga Dibra.

Mirush Deda, PESHKOPI, ALBANIA: Është e rëndësishme për ne që jetojmë në Prefekturën e Dibrës sepse kjo rrugë do na ofrojë shumë lehtësira në shumë drejtime.

Edison Kurti, CAMBRIDGE, UNITED KINGDOM: Sepse është shtëpia ime dhe ajo rrugë është më e rëndësishmja në Shqipëri...

Astra Murra, SHUPENZË, ALBANIA: Kam jetuar, jetoj, dhe do të jetoj aty...

Majlinda Hoxha, PESHKOPI, MACEDONIA: Patjeter që është e rëndësishme rregullimi i këtij segmenti rrugor, pasi jo vetëm lish kryeqytetin me rrethin e Dibrës, por ndikon pozitivisht në zhvillimin e kësaj zonë. Marrëdhenien që do këtë me vendet fqinje, pasi infrastruktura e mirë bën që import-eksporti të jenë me kosto më të vogla. Dibra me historinë e saj të bujshme, me traditat e saj, meriton të paktën një rrugë për së mbari!

Halim Ilnica, TIRANA, ALBANIA: Sepse lidh një rajon të varfër me kryeqytetin e Shqipërisë.

Almir Datja, TIRANA, ALBANIA: Vendlindja ime.

Marjana Shahu, BROOKLYN, NY: Për një mënyrë të shkurtër edhe të lehtë për udhëtuar drejt Dibrës....

Majlinda Hoxha, PESHKOPI, MACEDONIA: Sepse rruga e Arbrit bashkon më shumë të gjithë shqiptarët

Sejid Gorenca, DEBAR, MACEDONIA: Përfundoni ndërtimin e Rrugës së Arbrit.

Vjollca Avdyli, GJILAN, ALBANIA: vetëm se kam dëshirë që njerëzit të lidhen mes vete.

Rruga e Arbërit nr. 92

Një panoramë e çështjes dhe skenat dhe prapaskenat mes qeverisë së Maqedonisë dhe Shqipërisë? A do t'i merret ujërat Radikës dhe nëse ndodh, sa ujë do ti merret dhe cilat janë ndikimet në mjedis? Një vështrim "Pro" dhe "Kundër" që nga nisja e kësaj historie deri më sot.

ngjarja

Çfarë do të ndodhë me **ujërat e Radikës?**

Nga **BUJAR KAROSHI**



Çështja e ujëravë të Radikës po gjen një vend të gjerë ne mjedisin mediatik dhe politik në Maqedoni dhe Shqipëri. Gazeta "Rruga e Arbërit" i ka kushtuar një vend të rëndësishsëm kësaj çështje që në Mars 2012, me një shkrim të Prof. dr. ing. Abdyl Koleci, por për më shumë se një vit, asnjë institucion apo organizëm joqeveritar nuk u interesua. Vetëm gjatë verës disa qytetarë filluan të kërkonin reagime publike lidhur me çështjen dhe në gusht 2013, institucionet vendore në Komunën e Dibrës së Madhe reaguan kundër projektit, për të ardhur sot në fund të vitit, si çështje themelore dhe e paszgjidhur mes Maqedonisë dhe Shqipërisë.

Po si kanë rrjedhur ngjarjet rreth devijimit të ujërave të Radikës?

INICIATIVA

Në vitin 2011 ELEM nënshkroi kontratë me kompaninë gjermane "Consulting Company Poyry infra" për hartimin e Studimit për vlerësimin e ndikimit në Mjedis nga realizimi i projektit "Fusha e Llukovës". Përpunimi i studimit është 272,000 euro dhe do të financohej me një kredi të Bankës Botërore

Nje video që mund te shihet në Youtube, e hedhur nga shoqeria energjetike ELEM në qershor 2011, tregon se si do të jetë Hidrocentrali në Urë të Boshkuti. Në video shikohet një projekt ide e hidrocentralit që merr ujërat e Radikës. Sipas saj, ujërat që do të derdhen në hidrocentralin e ri do të kenë një prurje prej 5.64 m2 në sekondë, diga do të jetë e lartë 33 metra, dhe kapaciteti ujëmbledhës i saj do të jetë 160 mijë metër kub ujë.

Ujërat që do të furnizojnë hidrocentralin do të kalojnë me anë të një tuneli të gjatë 8742 m dhe tunelet do të jenë me një diametër 3 m. Kapaciteti instalues i hidrocentralit do të jetë 68 MW dhe do të prodhojë elektricitet prej 117 GWh. Investimi parashikohet të jetë 80 milionë euro.

Ndërsa diga që do të ndërtohet në fushën e Lukovës do të jetë e lartë 71 m dhe do të ketë një kapacitet mbledhë ujor prej 39 milionë m3 ujë. Investimi do të kushtojë 62 milionë euro. Në këtë linjë do të ndërtohen hidrocentrale me një prodhim prej 159 GWh energji.

Videot janë interesante. Tregojne malet e zhveshura dhe ca pulëbardha që fluturojne mbi digë. E bukur si video. Po në terren, çfarë do të ndodhë në të vërtetë?

REAGIMI I PUSHTETIT LOKAL DHE SHOQËRISË CIVILE

Që nga mesi i vitit 2013 e në vazhdim, disa organizata joqeveritare në Dibër të Madhe kërkuan reagimin publik në lidhje me devijimin e ujërave. Qeveria maqedonase nuk jepte informacion lidhur me çështjen dhe po ashtu as kompania energjetike ELEM. Gjithashtu, edhe zyrtarët lokalë nuk kishin informacione mbi projektin.

Këshilli i Komunës në Dibër të Madhe, në një mbledhje të saj gjatë muajit Gusht mori

në analizë problemin dhe vendosi të marrë përgjegjësi lidhur me atë që po ndodhte. Duke parë se projekti nuk sjell të mira për Dibrën, pushteti vendor vendosi ti shfrytëzojnë të gjitha mekanizmat ligjorë në mënyrë që "qeveria maqedonase të heqë dorë nga grabitja e paligjshme e ujërave të Radikës. Për ndryshe dibranët do të jenë të detyruar ti drejtohen Gjykatës Ndërkombëtare në Strasburg".

Kryetari i Komunës së Dibrës së Madhe, Rruzhdi Lata, i tha korrespondentit të gazetës atje, se "një grup prej 20 personash nga ELEM, Banka Botërore dhe një shoqatë ndërkombëtare ekologjike, mes të cilëve asnjë shqiptar, u takuan me ne në komunë dhe parashtruan projektin". Por, theksoi ai, nga pushteti vendor u argumentua se " kjo sasi e ujit që do

të devijohet për Vardar për prodhimin e energjisë elektrike, po përdoret edhe tani për prodhimin e energjisë elektrike duke u derdhur në Liqenin e HC të Spiles. Po ashtu, pyetjes se a ka marrëveshje me qeverinë e Shqipërisë për këtë problem, ata iu referuan një marrëveshje të vitit 1963 mes Shqipërisë dhe ish-Jugosllavisë."

Kryetari i Komunës u tha atyre qëndrimin zyrtar se "historikisht Radika është e Dibrës dhe duhet të derdhet në Drinine Zi dhe të vazhdojë rrugën e mëtejshme për në Detin Adriatik".

Po ashtu, Bashkim Mashkulli, kryetar i Këshillit Komunal në Dibër të Madhe, kërkoi ndërhyrjen e qeverisë shqiptare në lidhje me këtë problem. "Ne shpresojmë se Qeveria e Shqipërisë do të ndalojë realizimin e këtij projekti, sepse edhe me konventat ndërkombëtare rrjedhjet natyrore të lumenjve nuk mund të ndryshohet... Shpresojmë se edhe Bashkia e Peshkopisë do të ndikojë te qeveria e Shqipërisë që ky projekt i dëmshëm i Maqedonisë të mos realizohet".

Gjatë muajit nëntor disa shoqata në qytetin e Dibrës së Madhe bënë thirrje për një protestë publike në sheshin kryesor të qytetit dhe me këtë rast iniciuan një peticion drejtuar qeverisë maqedonase. Shumë shpejt u mblodhën rreth 7 mijë firma dhe disa media në Shkup dhe Tiranë e përcollën lajmin.

Po ashtu, protesta janë zhvilluar në mjedise publike, shkolla etj. Ndërsa dibranët e amerikës organizuan një protestë përpara OKB më 20 Dhjetor 2013 dhe kërkuan ndihmën e organizatës për të mbrojtur ujërat e Radikës. Një faqe në WEB është ndërtuar me këtë rast (www.saveriverradika.com), dhe informacioni për mbrojjen e Radikës duket se po kryen fuqishëm ndikimin e vet.

REAGIMI I QEVERISË SHQIPTARE

Qeveria e Shqipërisë nuk ka dhënë akoma një qëndrim zyrtar. Në një emision televiziv në Top Channel, ministri i energjisë dhe industrisë, z. Damian Gjiknuri, i shkuan shumë pyetje në lidhje me Radikën dhe ai dha një përgjigje shpresëdhënëse se problemi do trajtohej me seriozitet: "Jam i kënaqur që ka një shqetësim për këtë çështje. Një arsye e vizitës time në Maqedoni ishte edhe kjo çështje. Krahas bashkëpunimit për ndërtimin e linjës së tensionit të lartë mes Shqipërisë dhe Maqedonisë, ka një projekt nga pala maqedonase, që bëhet fjalë për devijimin e vogël të ujit. Ne kemi patur një marrëveshje me ish-Jugosllavinë për ujërat, detyrimet e marrëveshjes besoj rrjedhin edhe sot. Kemi kërkuar që të ngremë një komison të përbashkët që të bindemi që ky projekt nuk ka ndikim tek siguria energjitike e Shqipërisë. Shqipëria është e shqetësuar për këtë çështje, ndaj duhet të flasim. Ne nuk duhet t'u lëmë vend spekullimeve, duhet të jemi transparentë me njëri-tjetrin dhe të mbajmë qëndrimet tona bazuar në marrëveshjet ndërkombëtare dhe menaxhimin e ujërave. E shohim me shqetësim këtë gjë. Është një problem serioz. Shteti shqiptar niset në këtë rast nga interesat e veta strategjike në gjetjen e një mekanizmi të përbashkët që të ruajmë regjimin e ujërave që kemi historikisht."

MINISTRAT SHQIPTARË NË QEVERINË E SHKUPIT DHE PETICIONI

Pas protestës së 30 nëntorit, përfaqësuesit e shoqatave joqevritare në Dibër udhëtuan drejt Shkupit për të firmosur peticionin. Menjëherë pas kësaj, ministrat shqiptare të qeverisë së Maqedonsië udhëtuan drejt Dibrës së Madhe për t'u takuar me pushtetarët vendore. Minisitrat Abdylaqim Ademi dhe Valon Saraçini morëm me vete edhe përfaqësuesin e ELEM, Fatmir Limani. Në takim me Kryetarin e Komunes, Kryetarin e Këshillit Komunal dhe deputeten e Dibrës Julieta Marku, ata deklaruan njëzëri se ishin në mbështetje të banorëve.

"Ardhja jonë në Dibër është shkas që tu tregojë dibranëve që janë në anën e tyre, që të mos ketë spekullime, dhe t'ju bëjmë me dije që ata do të jenë të fundit të cilët do t'i thonë po apo jo këtij projekti", tha në këtë takim Valon Saraçini ministër i ekonomisë në republikën e Maqedonisë.

Por nga ana tjetër, në parlamentin e Shqipërisë, Komisioni i Politikave të Jashtme po zhvillonte një mbledhje me dyer të mbyllura. Media e Tiranës bëri publike procesverbalin e takimit dhe sipas saj, ka qënë ministri Saraçini që i ka propozuar marrëveshjen homologut shqiptar Gjiknuri, për devijimin e 2 metra kub në sekondë nga 17 metra që ka Radika."

Sipas të dhënave që ofron media, ose Saraçini është i pasinqertë me dibranët ose procesverbali i takimit i botuar në mediat e Tiranës është i rrejshëm.

Ç'DO TË NDODHË ME RADIKËN?

Sa metër kub ujë do t'i ikin Radikës? 2 metër kub? 6 metër kub? 8 metër kub apo do t'ia marrin të gjithë ujin?

Radikës tanimë i janë marë 10 m3 ujë në sekondë gjatë ndërtimit të liqenit të Mavrovës, nga 30m3 ujë në sekondë që ka pasë asokohe Radika. Kjo do të thotë se kanë ngelë edhe 20 m3 ujë në sekondë, e jo 15 m3 ujë në sekondë sic deklarojnë në ELEM. Një deklaratë e këtillë mundëson vjedhjen e 5 m3 ujë të cilat nuk figurojën askund, thotë një përfaqësues i një shoqatë joqeveritare në Dibër.

Gazeta "Dnevnik" boton një shkrim më 24 dhjetor dhe nxjerr përfitimet e ndërtimit të hidrocentralit të "Fushës së Llukovës". Sipas gazetës, "Maqedonia do të marrë prodhimin shtesë prej gati 160 gigavatë - orë energji elektrike në vit , e cila do të sigurohet nga hidrocentralet e "Vrben", "Vrutok" dhe "Raven" dhe hidrocentralet i ri "Guri i Zi", dhe në këtë mënyrë rritet energjia elektrike e rinovueshme

→

Pjesë nga Procesverbali me dyer të mbyllura i komisionit të Politikës së Jashtme

Me Maqedoninë

Qeveria maqedonase i ka propozuar qeverisë shqiptare një projekt për të devijuar në tri kanale të nëndheshme burimin e lumit Radika, për të ndërtuar një hidrocentral në Fushën e Likovës. "Ministria e Punëve të Jashtme është në ndjekje të problematikës së krijuar qoftë me komunitetin e Dibrës së madhe, për çështjen e një projekti të cilin qeveria maqedonase e ka miratuar nga ana teknike për ndërtimin e një hidrocentrali në Fushën e Llukovës. Ideja është se duke qenë se burimet natyrore nuk janë të mjaftueshme në këtë zonë, është menduar që të merren pesë degë të lumit Radika dhe të çohen në 3 kanale të nëndheshme, drejt fushës së Llukovës", ka deklaruar drejtoresha e Traktateve dhe të Drejtës Ndërkombëtare në Ministrinë e Jashtme, Suela Janina. Këtë kërkesë pala maqedonase e ka paraqitur gjatë takimit të zhvilluar mes ministrit të Energjetikës Damian Gjiknuri dhe homologut maqedonas, Valon Saraçini. "Çështja është ngritur edhe në rrugë zyrtare nga ana e qeverisë maqedonase në takimin që ka pasur ministri i Energjisë, zoti Damian Gjiknuri, me homologun e tij maqedonas në Shkup, në datën 26 nëntor të këtij viti, ku është diskutuar dhe janë paraqitur nga pala maqedonase disa elementë paraprakë të këtij projekti. Sipas të ministrit të Ekonomisë Valon Saraçini, projekti nuk do të ketë ndikim ndërkufitar, pasi thuhet nga pikëpamja teknike që lumi i Radikës ka 17 metra kub prurje në sekondë, ndërkohë që mendohet të devijojnë vetëm 2 metra kub në sekondë. Kurse nga ana e ministrit Gjiknuri është mirëpritur fakti që kjo është ngritur si çështje për diskutim dypalësh dhe është rënë dakord që të vlerësohet nga ana teknike ky projekt", është shprehur drejtoresha e Ministrisë së Jashtme.

NDIKIMI

Pala shqiptare është e mendimit se devijimi i një prej burimeve të lumit Drin i Zi nuk do të jetë i madh, por kjo do të vlerësohet nga komisionet ndërqeveritare. "Mendojmë se është çështje ditësh që të komunikojmë në mënyrë diplomatike me palën maqedonase, për të bërë mbledhjen e komisionit ndërqeveritar të ujërave dhe ky është i vetmi instrument ligjor, i cili do të shërbejë për diskutimin e të gjitha problemeve që mund të lindin mes dy shteteve dhe kryesisht problemi kryesor që kemi aktualisht është çështja e devijimit të lumit të Radikës dhe të ndikimit që do të ketë në Drinin e Zi, sepse realisht nga informacionet që kemi për momentin, mendohet që nuk do të ketë ndikim shumë të madh, por kjo është një çështje që ekspertëve u takon ta vlerësojnë realisht sesa do të jetë, duke parë në mënyrë më të detajuar vetë projektin dhe se çfarë parashikon ai", ka thënë zyrtarja e lartë në MPJ.

Foto të Radikës së bukur, por edhe liqenit pa ujë, krijojnë një kontrast të menjëhershëm mes asaj që shfaqet sot dhe asaj që mund të jetë përgjithmonë në Dibër.
Sido që të jetë, Jetë pa Ujë nuk ka!







→

e prodhimit të përgjithshëm në Maqedoni". Gazeta thotë se do të zbatohen të gjitha standardet mjedisore dhe protestat në Dibër i quan si kundërshtime të autoriteteve lokale dhe OJQ-ve lokale, të mbështetura nga diasporat e tyre jashtë vendit". Gazeta e quan fakt të kryer projektin dhe se Radikës do ti merren 2.2 metër kub deri në 7.2 metër kub, nga 8 metra kub në sekondë, siç lejohet nga marrëveshjet ndërkombëtare..." Po se cilës marrëveshje i referohet, gazeta nuk e thotë.

Gazeta gjithashtu, rendit një listë të gjatë përfitimesh nga turizmi, ndërkohë që shumë veta në rrjetet sociale ankohen sepse gazeta ju censuron opinionet e tyre kundër projektit.

REAGIMI INTELEKTUAL DHE DISA MËNYRA PËR TA MBROJTUR RADIKËN

Kim Mehmeti, shkrimtar, i njohur në publik edhe si një publicist në mbrojtje të lirive dhe të drejtave të shqiptarëve në Maqedoni, thotë në një postim të tij në rrjetet sociale se "siç duket regjimi aktual i Maqedonisë është i vendosur që ujërave të lumit Radikë t'ua ndryshojë rrjedhën dhe, në vend se në Adriatik, ato të derdhen në detin Egje. E ne ndërkohë, pushtetarët e këtushëm shqiptarë heshtin dhe mbase si gjithmonë, do paraqiten me shpjegime pasi çdo gjë të ketë përfunduar. Pra pasi të thahet shtrati i Radikës. Por kësaj radhe do gabojnë rëndë pasi që të gjithë shqiptarët, kudo që janë, ndjehen dibranë dhe do mund të ndodh që më parë të thahet shtrati i iluzioneve të mbrapshta të këtij regjimi, se sa ai i Radiksë, nga ka rrjedhë jeta e dikurshme dhe nga doemos duhet të rrjedhë ajo e ardhmja e tokave shqiptare që ky lum i lagë me ujërat e veta!"

Intelektualët dibranë në Maqedoni po bëjnë përpjekje për mbajtjen gjallë të opinionit dhe për të gjetur rrugët dhe mënyrat për ta shpëtuar Radiken. Bardhyl Marku, njëri prej tyre, thotë se është koha që të bëhemi të gjithë bashkë. "Duhet të krijojmë një qendër të ideve, thotë ai, në mënyrë që të shohim se çfarë duhet të bëjmë për të shpëtuar lumin Radika e me të edhe liqenin e Dibrës dhe stopim të realizimit të projektit "Fusha e Llukovës". Ai shton se është e nevojshme që "duhet të formohet një grup pune i legjitimuar në seancë të Këshillit Komunal, në përbërje profesioniste të cilët kanë informata, përgaditje dhe dëshirë t'i bashkohen kësaj iniciative. Ky grup pune të merret seriozisht dhe të informohet permes të gjitha materialeve, të cilat janë siguruar deri tani për këtë çështje në forma të ndryshme dhe materialet të cilat ka siguruar komuna. Gjithashtu, t'i kërkohen ELEM-it dhe Bankës Botërore të gjitha materialet që kanë lidhje me këtë çështje, si p.sh: projekti, kontratat të cilat kanë mundësuar nisjen e kësaj inciative; raportin e plotësuar të firmës gjermane e cila bën analizë të ndikimit social dhe ambientor të këtij projekti, jo vetëm në brezin e kapjes së ujërave të Radikës por edhe përgjatë rrjedhës së saj deri në liqenin e Dibrës. Ti kërkohet ELEM-it të japë informata të sakta për sasinë reale të ujit që planifikojnë të marrin. Gjithashtu, thotë ai, duhet që të organizohen takime me qeverinë e Republikës së Shqipërisë, të mbahen kontakte me ministrat shqiptarë të qeverisë së Maqedonisë si dhe të punohet për përgatitjen e materiali profesional, nga specialistë dhe profesorë, për ndikimet sociale dhe ekologjike në rajonin e Dibrës dhe me gjerë. "Politikanët, thotë B. Marku, duhet t'i lënë menjanë ngjyrimet politike dhe të bashkohen për Dibrën, pasi bëhet fjalë për diçka jetike".

* **

Reagimet mbi ujërat e Radikës i kanë bërë njerëzit aktiv në rrjetet sociale, pse jo dhe nostalgjikë. Foto të Radikës së bukur, por edhe liqenit pa ujë, krijojnë një kontrast të menjëhershëm mes asaj që shfaqet sot dhe asaj që mund të jetë përgjithmonë në Dibër.
Sido që të jetë, Jetë pa Ujë nuk ka!

MINISTRAT ABDYLAQIM ADEMI DHE VALON SARAÇINI NË MBËSHTETJE TË DIBRANËVE

Nuk mund të ndryshohet
rrjedhja natyrale e Lumit Radikë

Abdylaqim Ademi, ministër për ambientin jetesor dhe Valon Saraçini ministër i Ekonomisë së Maqedonisë të ejnten pasdite me date 12 dhjetor 2013 vizituan Dibrën për të marrë informata burimore lidhur me shqetësimin e dibranëve për sinymin e Elem-it për ndërtimin e HC në Fushë të Lukovës. Ata u priten nga Mr.Ruzhdi Lata kryetar i Komunes se Dibres, Bashkim Mashkulli kryesues i Keshilli Komunal dhe Julieta Marku deputete.

Mr.Ruzhdi Lata, kryetar i Komunës së Dibrës pas takimit me ministrat para gazetarëve, deklaroi se: "Shpreh mirënjohje sepse gjaku njeh gjakun, ministrat na kuptuan për hallet që kemi në Dibër ndaj dhe biseduam për problemin e projektit ,"Fusha e Lukovës" devijimi i lumit Radikë. Nga ky projekt, prezantuam qëndrimin e të gjithë dibranëve dhe pushtetit vendor që ky projekt është i papranueshëm por këtë problem mund ta zgjidhim vetëm me ndihmën e tyre", tha Lata.

Abdylaqim Ademi, ministër për Ambientin jetësor, u shpreh se "pas dorëzimit të peticionit nga ana e disa shoqatave qytetare në Qeveri dhe në Parlament, erdhëm që të dëgjojmë zërin e dibranëve për projektin "Fusha e Lukovës,, por edhe për t'i informuar në mënyrë burimore çka do të thotë ky projekt dhe cilat janë gjasat e këtij projekti. Në bazë të konventave ndërkombëtare ,në bazë të direktivave të BE dhe ligjit të ujërave devijimi i rrjedhave të lumenjve është i ndaluar dhe devijimi eventual shkakton efekte negative ne florë, faunë, ekosistem, biodiversitet dhe në aspektin socio-ekonomik. Ne para dibranëve dëshiroj të themi që në asnjë mënyrë nuk do



të ketë devijim të lumit Radikë. Do të jemi në kontakt me pushtetin vendor, por do të kemi kontakte edhe me shtetet fqinje si Shqipëri, Kosovë dhe Greqia,, shtoi Ademi.

Valon Saraçini ministër i ekonomisë tha se "ardhja jonë në Dibër është shkas që tu tregojë dibranëve që janë në anën e tyre, që mos ketë spekulime, dhe t'ju bëjmë me dije që ata do të jenë të fundit të cilët do t'i thonë po apo jo këtij projekti. Derisa dibranët janë kundër këtij projekti edhe ne jemi kundër, derisa nuk realizohen punët konkrete duke mos marrë parasysh përfitimet ekonomike ky projekt nuk bëhet dhe nuk do të realizohet pa u themeluar një grup punues duke i kyçur të gjitha institucionet relevante, por edhe shtetin shqiptar dhe Kosovën. Pa u shqyrtuar konventa ndërkombëtare, marrëveshjet e nënshkruara mes shteteve, atëherë do të kemi vendimin final. Ne jemi me dibranët, ky projekt do të realizohet kur dibranët do të japin dritë jeshile, nëse dibranët janë kundër, ky projekt nuk realizohet", tha në fund Saraçini.

Fatmir Limani, zëvendës drejtori për energji elektrike deklaroi se "Kam ardhur në thojza për të realizuar projektin por është normale që ka protestues, ne bartim përgjegjësi të ndryshme dhe e kemi të qarët këtë problem ekologjik. Ne nuk mund të jemi kundër Zotit sepse ai rrjedhat e lumenjve i ka përcaktuar në drejtime, jam për projekte në favor të popullit tonë por duke mos dëmtuar në asnjë moment popullin në përgjithësi, nënvizoi Limani.


Përfaqësuesit e OJQ-ëve kishin dalë me pamkarta për të shprehur kundërshtimin për ndërtimin e HC "Fusha e Lukovës". Dritan Lleshi, njëri nga përfaqësuesit e OJQ-ve tha se qëllimi i tyre ne pankarta ishte që tu jepej përkrahje ministrave që janë kundër projektit, gjithashtu përkrahin kryetarin e komunës, këshillin komunal dhe mbarë qytetarët që janë kundër projektit. Për këtë qëllim OJQ-të organizuan edhe një peticion prej shtatë mijë banorëve të cilin e dorëzuan në Parlamentin e Maqedonisë dhe në përfaqësitë e huaja në Maqedoni.

Rexhep TORTE



Kur preket gjeografia e një vendi, me a pa dashje, preket edhe historia e tij. Prandaj, mos e trazoni Radikën, zotërinj! Mos e vrisni lumin, të cilin, siç thotë poeti, edhe po të mos ekzistonte do të duhej ta krijonim!

Radika është pjesë e **historisë** dhe **kulturës** shqiptare



Nga **AGIM VINCA**

> Një lumë nuk është thjesht një lumë. Një lumë është shumë më shumë.
> Një lumë, ashtu sikurse edhe një fushë a një mal, një liqen a një det, një katund a qytet, një krahinë a shtet, është pjesë e kulturës materiale e shpirtërore të një bashkësie dhe e kujtesës së saj individuale e kolektive.

Edhe kjo s'ishte dëgjuar: qeveria e Maqedonisë, nëpërmjet një projekti bizar, të paparë ndonjëherë në këto anë, synon ta devijojë rrjedhën e lumit Radika dhe t'i kthejë ujërat e tij në Vardar! Kështu shkruan këto ditë shtypi shqiptar në Maqedoni dhe, aty-këtu, edhe ndonjë medie tjetër. Nuk është me rëndësi se cila do të jetë sasia e ujit që do t'i rrëmbehet Radikës: një pjesë e tij, gjysma apo edhe në tërësi (informatat lidhur me këtë janë kontradiktore); shqetësues është fakti që po preket një pasuri natyrore, një lumë, ndër më të pastrit në Evropë, uji i të cilit, qoftë edhe pjesërisht, nuk do të derdhet më në detin Adriatik, si gjithmonë, prejse mbahet mend, por në detin Egje!

Vetëm ky fakt, kjo e dhënë, mjafton për të ngritur zërin në kupë të qiellit; për të vënë kujën si plaka Ajkunë e "Urës me tri harqe" ndaj atyre që i bien në qafë lumit të Ujanës së Keqe: firmës "Rrugë&ura", të konvertuar në këtë rast në ndërmarrjen ELEM (Elektranat e Maqedonisë), projektin e së cilës po e financuaka Banka Botërore!

Pas ndërhyrjes së faktorit njeri, në të vërtetë të faktorit shtet dhe mekanizmave të tij, një aset i rrallë natyror, lumi përrallor rrëzë Korabit, rrezikon të shterë, të thahet, të zhduket përgjithmonë nga faqja e dheut!

Dhe ky veprim i paparë, që lirisht mund të quhet krim, pavarësisht nga motivet prapa të cilave fshihet, nuk është vetëm cenim i ekosistemit, i biodiversitetit, i florës dhe faunës, siç është thënë me të drejtë nga subjektet që kanë reaguar deri më sot, por edhe diç më shumë, që nuk është vërejtur nga reaguesit. Prekja e Radikës, grabitja e ujërave të saj, devijimi i tyre, është cenim direkt edhe i kulturës dhe historisë së banorëve që jetojnë në brigjet e tij; që lindin, jetojnë e vdesin aty brez pas brezi.

Radika, sikurse edhe lumenjtë e tjerë të gjeografisë shqiptare: Drini, Shkumbini, Vjosa, Valbona, Mati, Semani, Osumi, Buna, Vardari, Ibri e të tjerë, është pjesë e historisë dhe e kulturës shqiptare. Prekja e këtij lumi, prandaj, është edhe prekje e kujtesës dhe e krenarisë kombëtare. Lumenjtë kudo në botë kanë një konotacion të tillë.

Një lumë nuk është thjesht një lumë. Një lumë është shumë më shumë. Një lumë, ashtu sikurse edhe një fushë a një mal, një liqen a një det, një katund a qytet, një krahinë a shtet, është pjesë e kulturës materiale e shpirtërore të një bashkësie dhe e kujtesës së saj individuale e kolektive.

Në këngën popullore të Hajredin Pashës, që është një nga perlat e epikës historike shqiptare, në të cilën flitet për kryengritjen antiturke të banorëve të krahinës së Dibrës kundër perandorisë osmane, të përfaqësuar nga pashai zullumqar, gjithçka sillet rreth Radikës, fillon e mbaron me të. *"Hajredin Pasha, po na vjen-o Radikës/ Vallë ku jan-o k'to malet e Dibrës?"* - shtron pyetjen rapsodi popullor që në vargjet e para të këngës, për të dhënë sakaq përgjigjen: *"Malet e Dibrës more kanë lidhë besë/ Kanë lidhë bes-o, more të tanë/ Turkut Dibrën-o mos me ja lanë"*. Krijuesit të kësaj kënge, që ka ushqyer me shekuj ndjenjën e dashurisë për atdheun dhe lirinë, as që i ka shkuar ndër mend se një ditë mund të zhbëhet krejtësisht apo edhe pjesërisht, lumi-dëshmitar i kësaj ngjarjeje të madhe historike, të skalitur përgjithmonë në kujtesën e njerëzve.

Në një këngë tjetër popullore, që, ndryshe nga e para, është lirike, shfaqet pak a shumë i njëjti peizazh dhe imazh: ai i shkrirjes së njeriut me natyrën, me lumin në këtë rast; i fatit të tyre të përbashkët. Poeti popullor këndon për fatin tragjik të një vashe, që bie viktimë e zakoneve prapanike. Dhe e tërë "ngjarja" ndodh buzë lumenjve: Drinit e Radikës, që janë të pashkëputur nga njëri-tjetri. *"Dri, o Dri, o i ziu Dri,/ t'u thaftë shtrati, nata raftë mbi ty!/ Kur të dridhet hana përmbi valë/ breg më breg po më kërkon një djalë,/ kur ta shohësh diellin tuj prendue,/ kujto, nanë, se cuca tasht martue,/ të ashtë martue, nanë, me gurët e zallit,/ më përcollën nuse zogjtë e malit"*. (Revista "Nëntori" nr. 11, Tiranë 1988, f. 50). Në gjithsej tetë vargje zhvillohet një dramë e tërë: drama e cucës dibrane, që hidhet në valët e Drinit, për shkak të dashurisë së ndaluar nga kanuni i egër i maleve. Fjala është për një tekst poetik me fuqi e bukuri të rrallë artistike: baladë e Orfeut shqiptar, që vajton Euridikën e tij, duke shqiptuar invenktiva të denja për penën e një Homeri a Fishte.

Poeti Adem Gajtani, njëri nga krijuesit më të talentuar të brezit të vet, i përkthyer edhe në maqedonisht, ka një poezi kushtuar Radikës, në të cilën, nëpërmjet gjuhës poetike, ku pleksen metafora e hiperbola, glorifikon bukurinë e Radikës, këtij lumi të pastër si loti, uji i të cilit, sipas poetit, ka fuqi magjike: *"Kaprojt që pinë ujin tënd nuk i zë plumbi"*. Një varg antologjik, që nuk do të mund të lindte pa objektin e vet të këngëtimit - lumin e Radikës.

Edhe autori i këtyre rreshtave, në një poezi të tij i referohet Radikës si lumë, por edhe si simbol i qëndresës së një etnosi e bote, që i kanoset rreziku i vdekjes. Madje, për çudi, me këtë poezi ai e mbyll librin e tij "Kohë e keqe për lirikën" (1997), sikur ta dinte se një ditë do të vinte kohë e keqe për Radikën! *"Rrjedh Radika mes maleve -/ lot i ngrirë në qepallë./ Përpëlitet me shpirt ndër dhëmbë/ Reka, vendi im"*. Reka e Dibrës dhe banorët e saj shqiptarë të besimit ortodoks a "drejtlavdor", si e quante biri i saj poet, Josif Bageri, po birren nga dita në ditë. Andaj: *"Gjëmon Radika e Drini plak./ Kollitet Korabi kreshtëbardhë"*.

Shembujt e mësipërm dhe shumë tjerë, që s'u përmendën këtu, dëshmojnë se sa e lidhur është memoria historike, por edhe imagjinata artistike e banorëve të kësaj treve me Radikën dhe Drinin, që bëhen bashkë në ish-fushën e Udovës, të shndërruar në liqen, për të vazhduar rrugëtimin si një trup i vetëm në territorin e shtetit shqiptar.

Radika është, siç dihet, dega kryesore e Drinit të Zi; pa ujërat e saj do të pësonte shumë kjo arterie vitale e trojeve shqiptare, që krahas begatisë natyrore, ka edhe një të kaluar të lavdishme historike.

Çështja "Radika", prandaj, nuk është problem vetëm i ekosistemit; ajo ka edhe përmasën e saj jo më pak të rëndësishme kulturore dhe, doemos, edhe aspektin e saj politik. Qeveria shqiptare, ajo e mëparshmja, e cila, për çudi, nga pjesa dërrmuese e shqiptarëve në Maqedoni perceptohej si "kombëtare", në mos edhe "nacionaliste", duket se e ka dhënë pëlqimin e saj për këtë projekt kaq problematik, të dëmshëm për jetën e banorëve të kësaj treve, të banuar kryesisht me shqiptarë, por edhe për vetë Shqipërinë si shtet (projekti daton nga viti 2008), ashtu siç pat vepruar edhe me marrëveshjen për detin me Greqinë, të cilën e hodhi poshtë si të kundërligjshme dhe të dëmshme për interesat kombëtare e shtetërore Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë. Është detyrë e qeverisë së re shqiptare që t'i thotë jo këtij projekti famëkeq të qeverisë së Maqedonisë, ashtu siç u tha jo armëve kimike të Sirisë. Për lumenjtë dhe ujërat në përgjithësi ekzistojnë konventa ndërkombëtare, që përcaktojnë rregullat e shfrytëzimit të tyre. (Një marrëveshje e tillë ka ekzistuar edhe mes qeverive të ish-Jugosllavisë dhe të ish-RPS të Shqipërisë si shtete fqinje). Mjafton të kërkohet respektimi i tyre dhe të përfillet vullneti i popullsisë vendore, interesat e saj social-ekonomike dhe, pse jo, edhe vlerat kulturore, që janë vlera universale. Në një protestë të ditëve të fundit, banorët e Dibrës së Madhe, e kundërshtuan kategorikisht këtë projekt, siç u tha, të përbashkët mes Maqedonisë, Kosovës e Shqipërisë dhe artikuluan qartë arsyet e heqjes dorë nga ky projekt.

Thirrja: "Ta mbrojmë Radikën!" është bërë tashmë moto e ditës e banorëve të Dibrës së Madhe, e cila, për shkak të politikave të këtilla në dëm të saj, po zbrazet nga dita në ditë; të Dibrës si krahinë dhe të gjithë shqiptarëve, por edhe e të tjerëve që jetojnë në këtë hapësirë e që janë jetësisht të lidhur me bukuritë dhe pasuritë e saj.

Kur preket gjeografia e një vendi, me a pa dashje, preket edhe historia e tij.

Prandaj, mos e trazoni Radikën, zotërinj! Mos e vrisni lumin, të cilin, siç thotë poeti, edhe po të mos ekzistonte do të duhej ta krijonim!

ADEM GAJTANI

Radika

Kush e di se çfarë zogu diellor
ka kaluar këtu dhe me flatra
i ka prerë shkëmbinjtë?
Dielli është rob i përmakëve
të lartë kreshtash,
hëna turpërohet nga ergjënti
i shkumës sate,
kaprojt që pijnë ujin tënd
s'i kap plumbi,
në djepin tënd lind nata më e bukur.

Kah më vrapojnë kuajt e tu të bardhë,
çfarë nusesh agimi çojnë?
Krushqit ti m'i vret me bukuri,
shkëmbijve u fal sytë e blerimit
dhe të ruajnë me xhelozi e amshim.
Edhe në mos qofsh,
duhet të të trillojmë.

(As dru as zog dashuri,
"Flaka e vëllazërimit", Shkup 1982)

AGIM VINCA

E prapë ai lumë...

Rrjedh Radika mes maleve -
lot i ngrirë në qepallë.
Përpëlitet me shpirt ndër dhëmbë
Reka, vendi im.
Bageri vdes sërish në Prishtinën
e okupuar.
E askund varri. As kortezhi.
Askund gjëmë as vajtim.
Një plak i thinjur mbëlton pemë
e i lutet zotit për një pikë shi.
Një re e zezë harbon qiellit
me breshër e mëri.
Thyen filiza, faron farë
një larash i marrë.
Rivdes Bageri në Prishtinë,
Bogdani meshon për shpirtin e tij.
Gjëmon Radika e Drini plak.
Kollitet Korabi kreshtëbardhë.
E prapë ai plak e ai kopsht
e ajo re idhnake.

Kot e ke mike
Jam rrap jo shkurre!

15. XI. 1995
(Kohë e keqe për lirikën,
"Rilindja", Prishtinë 1997)


oponencë

Hidrocentralet rrezikojnë

Rrëqebullin e Ballkanit në Maqedoni

Nga **PETR HLOBIL**
Bankwatch.org

Një mision faktmbledhës në Maqedoni ka konfirmuar merakun tonë që dy hidrocentrale të planifikuara mund të shkatërrojnë mjedise natyrore të rëndësishme në Parkun Kombëtar të Mavrovës.



Humbja e ujit është një problem për të dy hidrocentralet dhe është veçanërisht një problem serioz: Disa prej digave ekzistuese në parkun nuk lejojnë minimumin biologjik të ujit në rrjedha. Flora dhe fauna e parkut është tashmë afër thatësirës për shkak të neglizhencës së menaxhuesve të parkut.

Javës së kaluar vizitova Parkun Kombëtar të Mavrovës në Maqedoni ku Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Banka Botërore po ndërtojnë hidrocentrale. Në udhëtim, bashkë me mua ishte edhe eksperti i hidrobiologjisë Dr. David Pithart nga Instituti i Ekologjisë së Përshtatur të Dafne.

Me shqetësim ne dolëm në përfundimin që autoritetet e parkut kombëtar po propozojnë ndryshime në zonat e mbrojtura të parkut që do të sjellin si rrjedhim zhvillimin e hidrocentraleve. (Ky është një vendim i pazakontë për një park kombëtar, por nuk është surprizë duke pasur parasysh që parkut i mungojnë specialistët e ambientit - shumica e 80 punonjësve që mbulojnë një zonë prej më shumë se 700 km2 janë punonjës pyjesh dhe administratorë).

Çfarë do të thotë zhvillimi i këtyre hidrocentraleve për parkun kombëtar?

BERZH dhe *Boskov Most*

Një nga projektet në fjalë është projekti *Boskov Most* i mbështetur nga BERZH, i planifikuar të ndërtohet në një zonë që jo vetëm do të bëhet një zonë e "Natyrës 2000" kur vendi ti bashkohet Bashkimit Europian, por gjithashtu zhvillohet në zonën e Rrëqebullit të Ballkanit *(Lynx Lynx Balcanicus)* që është në rrezik të zhduket. Nga një popullsi totale prej 100 rrëqebullash, të gjithë gjenden në malet e Ballkanit, 30-50 jetojnë në Parkun Kombëtar të Mavrovës.

Ndikimi i mundshëm i projektit mbi këto kafshë është injoruar krejtësisht në Vlerësimin e Përgjithshëm Mjedisor për projektin *Boskov Most,* duke përfshirë edhe faktin që organizata joqeveritare Shoqata Ekologjike e Maqedonisë, ndërsa po monitoronte biodiversitetin e kësaj zone ka fotografuar Rrëqebullin mbi zonën ku do të ndërtohet hidrocentrali.

Ndërsa Vlerësimi i Përgjithshëm Mjedisor nuk është aprovuar akoma nga qeveria maqedonase, sponsorizuesit e projektit ELEM ka vendosur, pas kritikës nga grupet maqedone të mbrojtjes së natyrës - që të organizojë vetë monitorimin e biodiversitetit të zonës Boskov Most. Megjithatë, tani, punë ndërtuese e dendur po mbushin zonën me zhurmë, duke trembur shumë kafshë dhe patjetër duke larguar edhe popullsinë e rrëqebullit. (Një hidrocentral i vogël gjithashtu i financuar nga BERZH po ndërtohet disa qindra metra larg zonës *Boskov Most*.)

Shanset që Rrëqebulli të dallohet në zonë tani janë të pakta, që do t'i jepte ELEM shfajësimin për të vazhduar përpara me projektin *Boskov Most*. Por, vetëm nëse akoma nuk është regjistruar deklarata: Rrëqebulli tashmë është dalluar në të zonë!

E gjithë kjo nuk e ka ndaluar BERZH që të aprovojë një kredi për projektin. Ndaj në Nëntor të vitit të kaluar anëtari maqedonas i mbikqyrjes së bankave Eko-svest, plotësoi një ankimim që është konsideruar i vlefshëm nga mekanizmi i ankimimeve të BERZH-it dhe do të vlerësohet në detaje.

Banka Botërore dhe Rregullimi Ujor i "Fusha e Llukovës" dhe Projekti për Rinovimin e Energjisë

Ndërsa projekti *Boskov Most* është aprovuar (duke pritur rezultatin e ankimimit) ky nuk është rasti akoma për projektin tjetër që vizituam, Rregullimi i Ujërave të "Fusha e Llukovës" dhe Projekti për Energjinë e Rinovueshme për të cilin një borxh nga Banka Botërore po pret aprovimin në vjeshtë të 2012.

Sipas dokumenteve të Bankës Botërore, "Zona e Projektit është e vendosur një një hapësirë gjysëm-alpine me bukuri të konsiderueshme natyrore dhe faunë dhe florë të shumëllojshme dhe një hapësirë relativisht të paprekur".

Përveç dërgimit të buldozerëve në një zonë të paprekur më përpara, projekti ka edhe një numër problematikash të tjera:

- punë hidrologjike e shumtë në një luginë me lartësi të lartë, duke përfshirë edhe ndërtimin e një pellgu të madh dhe një zhvendosje të një kanali prej 20 km për të transferuar ujë nga burimet e Malit të Korabit në rezervuar.

- Siç e ka vënë në dukje edhe ENEL, kompania energjitike Maqedonase: kushtet gjeologjike të terrenit e bëjnë "shpesh janë të pafavorshme ndërtimin" për shkak të rrezikut të "rrëshqitjes së dheut, anëve të paqëndrueshme, materialeve rrjedhëse, pranisë së përhershme të ujërave." Ndërhyrje thelbësore (lexo: ndërveprim me natyrën e paprekur) janë të nevojshme, si p.sh. gërmime deri të themelet gurore (deri në 4 km të thella), tharjes së sipërfaqes dhe nëntokës dhe të tjera.

- Gjatë këtij ndërtimi masiv të kanalit dhe rrugëve dytësore, përsëri mund të presim që do të ketë shqetësim thelbësore që do të largojë më shumë Rrëqebullin - në një kohë kur zona të tjera të përshtatshme për Rrëqëbullin e Ballkanit gjithashtu janë në të njëjtat kushte.

- Ndërtimi do të sjellë një presion shtesë në një zonë që përfshin pyje të virgjëra në parkun dhe burimet e ujit që do të humbasin shumicën e ujërave.

Humbja e ujit - një problem për të dy projektet

Humbja e ujit është një problem për të dy hidrocentralet dhe është veçanërisht një problem serioz: Disa prej digave ekzistuese në parkun nuk lejojnë minimumin biologjik të ujit në rrjedha. Flora dhe fauna e parkut është tashmë afër thatësirës për shkak të neglizhencës së menaxhuesve të parkut.

Kjo situatë do të përkeqësohet nëse *Boskov Most* dhe "Fusha e Llukovës" do të ndërtohen, meqë nivelet minimale të shkarkimit të propozuara janë kaq të ulta sa praktikisht disa shtrate lumenjsh do të thahen dhe do të ketë humbje mjedisore për jetën ujore.

Ne shpresojmë që specialistët mjedisorë të Bankës Botërore do të kenë më shumë guxim sesa kolegët e tyre të BERZH për të hedhur poshtë një projekt që kaq dukshëm dëmton hapësira mjedisore kritike natyrore.

P.S.

Në mënyrë ironike, kur kërkuam leje për të vizituar zonën e "Fusha e Llukovës" jo vetëm që na u mohua leja por autoritetet kërkuan që të ishte e nevojshme që disa prej stafit të tyre të mbikqyrnin praninë tonë. Ne besojmë që disa prej zonave duhet të jenë dukshëm zona të ndaluara, por kjo duhet të aplikohet si për buldozerët ashtu edhe për ambientalistët.

5 Qershor 2012

Përktheu: **Afrim KAROSHI**



Komuniteti shqiptar në SHBA në mbrojtje të Radikës

Pranë selisë së OKB-së në Nju Jork, sheshin e njohur Dag Hamarskjold Plaza, më 20 dhjetor 2013 u mblodhën dhjetra shqiptar, përfaqësues nga disa shoqata dhe organizata të komunitetit për më shumë se dy orë për të protestuar si thanë ata: "kundra Planit të Qeverisë Maqedonase, për të ndërruar rrjedhën e lumit historik të Radikës".

Protesta ishte organizuar nga Shoqata Atdhetare "Dibra", e cila i bëri thirrje me anë të medias dhe rrjetit social Fb dhe Twitter, të gjithë shqiptarëve në SHBA, që ti bashkëngjiteshin protestës së ditës së sotme para OKB-së, në mbrojtje të lumit Radika. Megjithëse pjesmarrja ishte e vogël - protestuesit e ngrizën zërin e tyre për një të drejt që thyen edhe ligjet ndërkombëtare, "ajo për kontrollin e ujrave në mes dy shteteve".

Me këtë rast, pjesëmarrsit nënshkruan edhe një Peticion të Komunitetit Dibran në SHBA i cili do ti dorëzohet në mënyrë zyrtare, të hënën, Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Ban Ki Moon dhe zyrës së OKB-së për ujrat (UN Water). Peticioni, është kundër projektit të hidrocentralit "Fusha e Lukovës", që parashikon ndryshimin e rrjedhës së lumit Radika, duke i`u shmangur rrjedhjes së tij natyrore nëpër Dibër.

Një kopje e këtij peticioni, sqaroi organizatori i kësaj proteste, është paraparë t'i drejtohet edhe Presidentit të Asamblesë së Përgjithshme të OKB, ambasadores amerikane Susan E. Rice në OKB, administratës së Presidentit Obama, si dhe ambasadave të shteteve të mëdha në Kombet e Bashkuara, Britanisë së Madhe, Francës, Gjermanisë e Italisë,etj,.

Protesta fillojë në orën 1:00 të mesditës sipas orës amerikane. Këtë protestë e udhëhiqën anëtarët nga Komisioni organizator, Din Radoveshi, Ylber Pilku, Haxhi Maqellara, që u ngrit në takimin e Shoqatës Atdhetare "Dibra", javën e kaluar, kryesuar nga kryetari i saj Musa Paçuku.

Protestën me telegrame nga Dibra e Madhe, e përshëndetën dhe Kryetari Komunës së Dibrës së Madhe, maxhistër Ruzhdi Lata dhe Kryetari i Këshllit të Komunës Bashkim Mashkulli

Këtë protestë e hapi këngëtari i njohur dibran Haxhi Maqellara me një përshëndetje rasti. Më pasë dy hymnet kombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Shqipërisë, shënuan zyrtarisht fillimin e protestës e cila u shoqërua më pas me fjalime dhe thirrjet " Stop Lumit të Radikës". Kurse e moderojë gazetari i komunitetit Beqir Sina. Peticionin në gjuhën anglisht e lexoi anëtari i kryesisë së shoqatës Dibra zoti Murat Mela. Kurse, telegramet përshëndetëse, i lexoi; zoti Qenan Ame.

Plani të paligjshëm i cili, është miratuar nga qeveria Maqedonase, në kundërshtim me konventat Ndërkombëtare të Ujarave - ruajtjen dhe Mbrojten me Ligj të ujrave natyrore, e quajti në fjalën e tij, kreu i dibranëve Musa Paçuku, pra Planin e Shkupit, i cili sipas tij, është edhe në kundërshtim të papërgjegjshëm me Ligjet nderkombetar mbi Ujërat (resolution adopted by the UN, 63/124, (2009) anksi, Article 10).

"Ne, shqiptarët e Amerikës, kemi jetuar dhe jetojmë gjithmonë me shetësimet e vëllezërve e motrave tona në vendlindje, tha zoti Paçuku, dhe përcjellim me vëmëndje të madhe çdo gjë që shkon në dëm të popullatës shqiptare, kudo si në Kosovë, Mal të Zi, Maqedoni, Luginën e Preshevës dhe në Çamëri. Ne me protestat tona - por edhe me reagimet tona nuk do të lejojmë që edhe pushtetarët tanë, që për shkak të "kolltukut" të bëhen palë me qeveritaret Maqedonas. Ne do të përkrahim dhe mbështesim pushtetarët dhe politikanët shqiptar, vetëm atëhere, kur at atë jenë njësh me popullin e tyre, të punojnë dhe dëgjojnë popullin e tyre, i cili u ka besuar dhe u ka dhënë votën" tha ai.

"Protestën, theksojë Paçuku, po e mbajmë, mbasi këto ditë janë duke protestuar edhe qytetarët dibranë, pra edhe ne jemi duke iu bashkëngjitur me këtë rast, kërkesave të bashkëqytetarve tanë, në Dibër të Madhe, dhe kryetarit tonë të Komunës së Dibrës së Madhe, zotit Ruzhdi Lata, Këshillit të Komunës, zotit Bashkim Mashkulli, si dhe shoqërisë civile, duke menduar se kjo protest është vetëm fillimi dhe se do vazhdojë deri në arritjen e qëllimit tonë, për të qenë në krah të qytetarve tanë në çdoher që qeverija anashkalon transparencën me qytetarët e Dibrës" tha Paçuku.

Në emër të FederatësPan Shqiptare të Amerikës VATRA, protestën e dibranëve, e përshëndeti kryetari i saj Dr. Gjon Buçaj. "Lumi Radika që derdhet në Shqipëri, duke ndryshuar drejtimin e saj të rrjedhës, ka për t'u bërë edhe një çështje ndërkombëtare dhe mund të ndikojë negativisht edhe në marrëdhëniet mes dy vendeve fqinje, Shqipërisë dhe Maqedonisë", tha ai.

Një solidarizim të fuqishëm me dibranët shprehu në fjalën e tij, edhe kryetari i Akademise Shqiptaro Amerikane te Shkencave Porf. dr Skender Kodra. Protestën e përshëndetën edhe ish- kryetari i shoqatës Dibra, zoti Lavderim Cami, kryetari i Fondacionit Palvë e Guci, Esat Gjonbalaj. Zoti Grid Rroji - Kandidat për Ph.D. aktualisht Lektor i Ideologjisë dhe Propagandës në Departamentin e Politikës në Universitetin NYU, përshëndeti në emër të FSHAD. Ndërkohë, edhe Kryetari i Këshillit Kombëtar Shqiptaro-Amerikan, Martin Shkreli, Sekretari i Përgjithshëm i shoqatës Çamëria inxhinier Sali Bollati, dhe Ish Kandidati për Kongresmen Emin Eddie Egriu, Kryetari i PUSH. përshëndetë gjithashtu protestën.

Në emër të komunitetit të artistëve shqiptarë në Amerikë foli Roland Uruçi, producent dhe skenarist me origjinë nga Dibra e Madhe, sikurse edhe Përparim Prapaniku, që në fund foli në emër të komunitetit Dibran në Dibër të Madhe dhe atij në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Koresp. "Rr.A"

Në rolin e detyrës së gazetarit bëhemi dëshmitarë të skenave vërtet tronditëse kur shohim fëmijët të qajnë pasi janë me barkun bosh dhe dëgjojnë rrëfimet e prindërve në zgrip të jetës, pa asnjë mundësi mbijetese, qoftë edhe për të mbushur barkun me bukë thatë edhe pse jemi në shekullin e 21-të.

Varfëria, frika e të jetuarit me ankthin e marrjes **peng** të fëmijëve

Nga **HYSEN LIKDISHA**

Familja Rina, në fshatin Dragu të komunës Fushë-Bulqizë, po shkon drejt "ngujimit", pasi përjeton frikën e marrjes peng të fëmijëve. Shkak i kësaj frike që ka mbërthyer këtë familje janë bërë borxhet e shumta që ajo u detyrohet një numri të madh personash. Borxhet e shumta të kësaj familje, të cilat ajo i ka marrë për të mbajtur frymën gjallë me bukë dhe pamundësia absolute e shlyrjes së tyre, ka ngjallur për këtë familje frikën e marrjes peng të fëmijëve nga ana e borxhdhënësve.

Familja prej 6 anëtarësh, aktualisht nuk ka asnjë person të punësuar dhe jeton në kushtet e një varfërie ekstreme. E vetmja shpresë për punë në këtë familje mbetet i zoti i shtëpisë, Shaqir Rina, 42 vjeç, pasi 4 fëmijët janë në moshë minorene dhe e shoqja Fatbardha, duhet të bëjë punët e shtëpisë. 42 vjeçari Rina, ka punuar në minierën e Bulqizës për 11 vite, ku me punën e vështirë në galeritë e thella, nisi të ndërtojë jetën për vete dhe familjen e tij. Por, fati nuk e deshi që kjo të vijonte gjatë.

Krejt papritur atij nisi t'i shfaqej një dhimbje koke, disi e lehtë dhe e papërfillshme në fillim, por që për çdo ditë vinte e rritej. Deri sa një ditë kjo dhimbje e fortë e kokës e detyroi atë që t'i drejtohej Tiranës, ku nga ekzaminimet mjekësore u konstatua se ai vuante nga një tumor në kokë. Pasi ju nënshtrua një ndërhyrje kirurgjikale në kokë, 42 vjeçari Rina, bëhet i paaftë për të punuar aq më tepër në galeritë e thella të nëntokës së minierës. Në të tilla kushte, familja Rina, nis të mbahet në këmbë vetëm duke marrë borxhe. "Borxhe për tu operuar në kokë dhe më pastaj borxhe nëpër dyqane e komshinj për të ushqyer veten dhe fëmijët, kjo ishte mundësia e vetme e imja, pasi nuk kisha asnjë rrugë tjetër, - thotë 42 vjeçari Rina. - Pas operimit dola i paaftë për punë dhe më kanë lidhur një pension prej 10 mijë lekësh të reja, por edhe këto prej disa muajsh ende nuk i kam marrë".



Fatbardha Rina, bashkëshortja



Shaqir Rina, i zoti i shtëpisë

"Borxhet e shumta, - vijon të tregojë ai, - më kanë shtuar frikën se ata që më kanë dhënë borxh, mund të më marrin fëmijët peng".

"Kam shumë frikë, - nis e tregon mes lotësh bashkëshortja e Shaqirit, Fatbardha, - se mos më marrin fëmijët, që me aq mund po përpiqem t'i rris. Sytë e mi nuk teren nga lotët gjatë gjithë ditës kur shikoj sytë e përlotur të fëmijëve që "luten" për një kafshatë bukë thatë dhe unë nuk kam mundësi që tjua plotësoj. Ndaj për çdo ditë rrimë e vëzhgojmë nga dritaret dhe sa herë shohim se vijnë persona që u kemi borxh, mbyllim derën duke u ngujuar së bashku me fëmijët brënda shtëpisë", e përfundon mes lotësh fjalën e saj Fatbardha, zonja e shtëpisë.

Të futesh brenda shtëpisë përdhese, të familjes Rina në fshatin Dragu, të komunës Fushë-Bulqizë, përballesh vërtet me pamje tronditëse, kur sheh vetëm sy të përlotur, asnjë kafshatë buke, asnjë mobilje, dhoma krejt të zbrazura dhe vetëm një dyshek dopio, i cili ishte shtruar në mes të dyshemesë, ku flenë fëmijët me barkun bosh, të mbërthyer nga moria e ëndërrave fëminore. Nuk bëhet fjalë të gjesh në këtë shtëpi paisje elektroshtëpiake apo televizor, por as edhe divane për tu ulur apo tavolinë për të ngrënë bukë, përveçse një rafti buke krejt të zbrazur. Varfëria ekstreme e kësaj familjeje ka shkuar deri në palcë, deri aty ku nuk mban më.

Në rolin e detyrës së gazetarit bëhemi dëshmitarë të skenave vërtet tronditëse kur shohim fëmijët të qajnë pasi janë me barkun bosh dhe dëgjojnë rrëfimet e prindërve në zgrip të jetës, pa asnjë mundësi mbijetese, qoftë edhe për të mbushur barkun me bukë thatë edhe pse jemi në shekullin e 21-të.

Dialogu, ndërpritet greva e urisë së 70 minatorëve

Dialogu i qeverisë me minatorët grevistë, të Zonës D, në minierën e Bulqizës, zhvilluar në fillim të muajit dhjetor, ka çuar në ndërprerjen e grevës së urisë. Siç dhe u njoftua nga ministri i Energjetikës dhe Industrisë, Damian Gjiknuri, në orët e para të mëngjesit të sotëm, kanë mbërritur në ambientet e zhvillimit të grevës së urisë pranë minierës së Bulqizës, një ekip i ministrisë së Energjitikës dhe Industrisë i kryesuar nga zëvëndësministri Ilir Bejtja, për të dialoguar me 70 minatorët e ngujuar në grevë që nga dita e hënë e kësaj jave.

Morën pjesë në këtë takim edhe përfaqësues të sindikatës së minatorëve, si dhe përfaqësuesi i kompanisë nënkontraktore Tur-Alba. Takimi i njoftuar më parë kishte si piksynim zgjidhjen e ngërçit të krijuar me urdhërin e dhënë nga qeveria për pezullimin e punës në galeritë e kompanisë Tur-Alba, për shkak se gjatë kontrollit të ekipeve të RISHM-it dhe AKBN-së, u konstatua se nënkontraktori nuk ka realizuar kushtet kontraktuale dhe ata të sigurisë në punë për minatorët, të nënshkruara midis kësaj kompanie dhe qeverisë. I vetmi pretendim i grevistëve minatorë, në këtë takim, ishte ai që kishte të bënte me çeshtjen e trajtimit me pagesë të tyre për periudhën gjatë së cilës kompania Tur-Alba është pezulluar për punë në prodhimin e kromit. Në përfundim të takimit zvministri Bejtja konfirmoi se është arritur marrëveshja me kompaninë nënkontraktore Tur-Alba, që minatorët të paguhen për gjithë periudhën e përgatitjeve të galerive për punë, si dhe të plotësimit të kushteve të sigurisë për punëtorët. Pagesa e këtyre ditëve deri në përgatitjen e galerive për punë do jetë e plotë 100 për qind.

Ndërkohë për sa i takon kohës së rinisjes së punës në galeritë e kromit, Bejtja bëri me dije se duke filluar që nga dita e nesërme një ekip nga ministria e Energjetikës dhe Industrisë, do të vijë në Bulqizë për të parë në detaje plotësimin e



detyrave të lëna për kompaninë nënkonçensionare, ku dhe do dalë me konkluzionin e rifillimit ose jo të punës në galeritë e pezulluara.

Me këtë rast ai siguroi edhe njëherë minatorët se qeveria dhe kryeministri Rama janë tejet të vendosur për vijimësinë e punës në minierën e Bulqizës, por po kaq janë të vendosur edhe në plotësimin e kushteve të kontratave dhe sigurisë në punë për punëtorët, të lidhura nga kompanitë dhe firmat e vogla private me qeverinë, që çdo gjë të jetë konform kontratës së nënshkruar mes palëve, si dhe ligjit e rregullave përkatëse në këtë drejtim.

Hysen Likdisha

botime

Dy letra të Abdyl Frashërit dërguar Iljaz pashë Dibrës,
shkëputur nga monografia "Abdyl Frashëri" e akademikut Kristo Frashëri,
botuar nga Shtëpia Botuese "M&B"

Shkëlqesisë së tij **Iliaz Pashës,** *fisnik i nderuar* **i Dibrës**

Shkëlqesisë së tij Ilias Pashës,
fisnik i nderuar i Dibrës

I lumnueshëm shkëlqesi!
Pasi u largova nga Dibra erdha në Elbasan, ku u njoha me shoqërinë e lidhjes dhe bisedova (me anëtarët e saj – red.) i lashë atyre letrën tuaj së bashku me shkresën e Përfaqësisë, që është për t'u vulosur. Mora premtimin e tyre se do ta vulosin dhe do t'ua dërgojnë zotërisë suaj. Prej andej shkova në Berat. Në Berat paria si edhe i gjithë populli, myslimanë e të krishterë, u gëzuan jashtëzakonisht shumë për vendimet e Dibrës. Shkresën e Përfaqësimit ata e vulosën menjëherë dhe gjithashtu e dërguan edhe nëpër rrethet vartëse me njerëz të posaçëm. Prej Beratit shkuam në Vlorë. I nderuari Mustafa Pasha u gëzua shumë për përpjekjet që po bëni zotëria juaj për atdheun dhe e gjithë parësia e Gegërisë. Letërpërfaqësimi u vulos menjëherë. Mustafa Pashai më tha se ishte bërë gati për t'u nisur vetë për në Stamboll. Ai shtoi se nuk do të kishte ndonjë të keqe edhe sikur të vononte disa ditë shkuarja e tij në Stamboll, për faktin se qeveria këto ditë është e zënë me punët politike (të jashtme), të cilat kanë marrë përsëri rëndësi. Këto që m'i tha mua mund t'ua ketë shkruar ai vetë edhe zotërisë suaj. Unë i thashë atij se pikërisht për këtë arsye që punët politike të Turqisë kanë marrë një ngjyrë të rëndësishme ne na duhet të ngutemi që të shkojmë një orë e më parë në Stamboll. Ai i pranoi fjalët e mia.

Nga Vlora shkova në Delvinë. Edhe atje e vulosa Letërpërfaqësimin. Prej andej shkova në Prevezë. Në Prevezë kur u takuam me shkëlqesinë e tij Abedin Beun, si edhe me njerëz të tjerë të respektuar të Çamërisë, këta u gëzuan shumë tepër për bashkimin e plotë dhe për vendimet. Vetë Abedin Beu shkoi nëpër rrethinat e Çamërisë me shkresat e përfaqësimeve për t'i vulosur ato dhe më tha se është gati të shkojë në Stamboll si përfaqësues i vendit. Nga Preveza erdha këtu. Këto punët tona qeveria i ka marrë vesh plotësisht dhe përveç pëlqimit dhe lavdërimit nuk ka thënë gjë tjetër. Përfaqësimet po vulosen nga të gjitha kazatë e çdo sanxhaku dhe vazhdojnë të vijnë këtu të vulosura.

Kategoritë që do të jenë përfaqësues të Toskërisë për të shkuar në Stamboll u vendosën dhe që të gjithë janë gati për t'u nisur sapo të arrijë njoftimi juaj për nisjen e tyre.


Përfaqësuesit në fjalë janë: Mustafa Pashai, Abedin Beu, Mehmet Ali Beu, Sabri Beu nga Gjirokastra (ose Ahmed Efendiu) dhe nga të krishterët: Mihal Harito Efendiu (dhe unë vetë), kurse nga Gegëria dihet se do të jetë zotëria juaj Hasan Pashai, Shejh Mustafa Efendiu dhe disa të tjerë. Nisja e këtij delegacioni një orë e më parë për në Stamboll është shumë e domosdoshme, sepse tani do të bisedohen përsëri çështja e pazgjidhur (e kërkesave) greke dhe ajo e bullgarëve.

Që të dyja këto çështje i përkasin edhe Shqipërisë. Zoti mos e dhëntë në qoftë se çështja e bullgarëve do të shikohet dhe likujdohet mbi themel të vendimeve të paktit të Shën Stefanit dhe çështja e grekëve mbi themel të kufijve të caktuar në Kongresin (e Berlinit), atëherë thuajse gjysma e Shqipërisë do të bjerë në duart e armiqve dhe kështu Lidhja dhe Bashkimi ynë nuk do të vlejë për asgjë.

Është e qartë se po të shkojnë në Stamboll delegatët e Shqipërisë më parë se të zgjidhen këto çështje, ata do të kryejnë shumë punë me dobi. Pra, jeni të lutur që të përpiqeni që të mblidhen sa më parë letërpërfaqësitë e Gegërisë dhe të keni mirësinë të njoftoni telegrafisht Mustafa Pashën, Mehmed Ali Beun dhe mua sapo të jetë gati delegacioni për të shkuar në Stamboll.

Lidhur me sa u thanë më sipër mbetem në urdhrin tuaj, shumë i nderuari zotni.

Janinë, më 20 nëntor 1294
Abdyl Hysni Frashëri



Akademik KRISTO FRASHËRI
ABDYL FRASHËRI
Botimet M&B
ISBN: 978-9928-172-12-9
Çmimi: 1500 lekë

BOTIME TË TJERA NGA KRISTO FRASHËRI





Botimet e Shtëpisë Botuese M&B, mund t'i gjeni pranë librarisë në Rrugën e Dibrës, në rrjetin e librarive "Adrion", libraria "Eva" pranë Pallatit të Kulturës, Libri Universitar si dhe në pikat e shpërndarjes së librit.

Letra e dytë e Abdyl Frashërit drejtuar Ilias Pashë Dibrës

Shkëlqesisë së tij Ilias Pashës,
pari dhe fisnik i nderuar i Dibrës

I lumnueshëm shkëlqesi!
Pak kohë më parë ju kam dërguar me anën e Beratit dhe Elbasanit, ku ju lajmëroja se letërpërfaqësimet e pjesës së Toskërisë u bënë dhe u vulosën në çdo anë dhe janë gati. Meqë nga ana e zotërisë suaj ende nuk më ka ardhur ndonjë letër, jam mjaft i shqetësuar dhe në merak. Mendoj se Mustafa Pasha ju ka shkruar që do të ishte mirë të vonohej edhe pak kohë të nisurit e përfaqësuesve të Shqipërisë për në Stamboll. Mendimi i tij për të bërë këtë vonesë nuk ka ndonjë tjetër shkak përveç faktit se Stambolli ndodhet në një gjendje shumë të turbulluar. Megjithatë, nuk kemi të drejtë të mënojmë këtë punë.

Arsyeja që na detyron dhe na ngut të veprojmë në këtë drejtim është pikërisht pasja parasysh e faktit që punët paraqesin trazim të madh. Sidomos tani në Stamboll po vendoset përfundimisht çështja e Greqisë dhe e Bullgarisë; ndërkaq do të vendoset edhe si do të qeveriset Shqipëria këtej e tutje dhe do të zgjidhet çështja e ndarjes dhe reformimit të vilajeteve. Vendimi që do të merret për tokat që do t'u jepen Greqisë dhe Bullgarisë, është e ditur se do të jetë në dëm të Shqipërisë.

Në qoftë se do të veprohet për riorganizimin e administratës, prapëseprapë Shqipërinë do ta ndajnë në disa vilajete dhe qendrat e vilajeteve do të jenë përsëri Selaniku,

> Për të mirën e Shqipërisë duhet të venë të gjithë delegatët në Stamboll dhe të venë një orë e më parë. Meqenëse vajtja e delegatëve kushtëzohet me vajtjen edhe të zotërisë suaj, nuk ka dyshim se për çështjen e mbrojtjes së mëmëdheut dhe të kombit do të merrni përsipër këtë barrë dhe do të vendosni që të shkoni vetë në Stamboll.

Janina dhe Manastiri, në këto vise natyrisht si gjuhë të vendit do të jenë greqishtja dhe bullgarishtja. Pasi të marrë puna një vendim të këtillë dhe pasi të aprovohet edhe nga Fuqitë e Mëdha që kështu të bëhet, atëherë vajtja e përfaqësuesve të Shqipërisë në Stamboll do të jetë e kotë dhe në rast se për Shqipërinë janë për t'u dhënë të tilla vendime, është e qartë se Shqipëria shkatërrohet sot e përgjithmonë. Prandaj, është e domosdoshme shkuarja sa më parë e delegatëve të Shqipërisë në Stamboll. Ta zëmë se përfaqësuesit tanë të kishin shkuar fjala vjen një muaj më parë (nga koha e duhur), kjo nuk do të kishte asnjë të keqe, kurse paraqitja atje një muaj më vonë, domethënë pasi të jenë përfunduar punët, në atë rast dëmi ynë do të jetë i pallogaritshëm.

Jua theksoj përsëri, sikurse jua pata shkruar edhe më parë, se Mustafa Pashai pranon të shkojë në Stamboll në qoftë se shkoni edhe zotëria juaj. Po nuk shkuat ju as ai nuk shkon. Me mosvajtjen e Mustafa Pashait është e ditur që edhe delegatët e tjerë nuk do të shkojnë.

Prandaj, për të mirën e Shqipërisë duhet të venë të gjithë delegatët në Stamboll dhe të venë një orë e më parë. Meqenëse vajtja e delegatëve kushtëzohet me vajtjen edhe të zotërisë suaj, nuk ka dyshim se për çështjen e mbrojtjes së mëmëdheut dhe të kombit do të merrni përsipër këtë barrë dhe do të vendosni që të shkoni vetë në Stamboll.

Kur do të merrni vendim për t'u nisur për në Stamboll, ashtu sikurse do të njoftoni edhe delegatët e tjerë, ju lutemi të njoftoni telegrafisht Mustafa Pashanë, Mehmed Ali Beun dhe mua.

Fundja, marr guximin të them se në rast se kjo punë mbetet në zvarritje, atdheu mbetet në rrezik dhe perspektiva e së ardhmes do të jetë e shkatërruar.

Pres urdhrin e zotërisë suaj.

Janinë, më 9 dhjetor 1294
/ 21 dhjetor 1878
Abdyl Hysni Frashëri
(Firma dhe vula e tij)

Rruga e Arbërit nr. 92
kritikë

Çfarë historie përmban në vetvete kjo Fushë, kjo Fushë e emërtuar heret dhe e specifikuar jo pak?

Fusha e Korabit, *mrekullitë dhe misteret e saj*

Nga Prof.dr. **ARIAN KADIU**



Foto: © B.Karoshi

Në ditët e verës Fusha e Korabit, pa e zmadhuar aspak, i ngjan një qilimi gjigand lulesh, të cilat nga java në javë sikur i lënë vendin njëra-tjetrës. Kjo Fushë u ofron vizitorëve ajër të pastër, aromë dhe bukuri mahnitëse, por edhe pista skish dhe veprimtarish të tjera dimërore, sepse bora këtu qëndron afro 6 muaj...

Çfarë historie përmban në vetvete kjo Fushë, kjo Fushë e emërtuar heret dhe e specifikuar jo pak?

A mund të lindëte kënga pa këtë Fushë? Gjithashtu, kjo Fushë e Korabit nuk mund të përfytyrohet pa një këngë burrërore. Njëheraz ajo nuk është si çdo Fushë tjetër. Sigurisht që kjo Fushë e njohur ka një histori krejtësisht të vetën, të gjatë a të shkurtër, të cilën e mira e do që të zbulohet e zhbirohet pjesë – pjesë.

Kënga "Oj, Fusha e Korabit" këndohet shumë mirë me kavall. Kavalli i ngjanë një fyelli të gjatë druri. Para se të përdoret është mirë që ai të lyhet me vaj ulliri, që të dalë tingulli sa më i butë e i ëmbël për dëgjuesin, duke fituar një bukuri të pashoqe. Këtë e thomë specialistët.

1. OJ FUSHA E KORABIT, - O NJERA UN-O

Që në përfytyrimin e parë kjo Fushë nuk mbetet më një objekt, një gjendje pa formë. Sapo nis vargu i parë ajo animizohet, bëhet vërtetë qënie e gjallë (një figurë e shfrytëzuar me dhjetra herë në letërsinë tonë të dëshirës, përtej njerëzores). Vargu të sjellë parasyve një Fushë me shprt, që ndienë dhe ankohet bashkë me thirrjen e fuqishme njerëzore. Me këtë thirrje emocionuese. Këtë e bën të njohur vargu refren, vargu i zemrës së djegur, ku shpuza është mbi e nën thëngjij.

Oj Fusha e Korabit, - o njera un-o
Tëj na erdhe hakit, - o njera un-o
Tëj na erdhe hakit - o njera un-o,.
Tëj na dave shtratit, - o njera un-o

Është kjo një thirrja e dalë nga shpirti (duhet të besosh se ka shpirt, ndryshe mos i lexo këto shënime), së bashku me ofkëllimin e shpirtit: o njera un-o. Thirrja që lëshojnë gratë, sikur është edhe një thirrje e fshehtë që lëshon vetë Fusha. Pas kësaj piskame njerëzore Fusha e Korabit druhet se mos e mallkojnë. Edhe njerëzia e zonës ruhen shumë që të mos e mallkojnë kurrë, ndonëse padashje, edhe e lëndojnë. Nëpër atë Fushë burrat, djemtë e rinj a të moshuarit me përvojë merrnin udhën e largë të shtegëtimit..

Fjala hakut (hakut), këtu e gjetkë ka disa kuptime Nusja e re pret me padurim burrin e saj. Ajo e ndienë veten të vetmuar, as shtrati nuk e qetëson. A mund ta qetësonte një cak i zbrazët, bosh, ku ka vetëm ftohtësi. Ajo nuk ka dashur t'i largohet burri i saj, sepse nuk e do as shtratin bosh. Ajo ndjehet keq, si e anashkaluar, si e nëpërkëmbur e harruar, vajmedet, sikur të jetë edhe e braktisur. Rrengu që mendohet se u ka "punuar" Fusha, është i madh: ajo ua rrëmben burrat e rinj, i rrëmbeu baballarët e fëmijëve të tyre, ua rrëmbeu gëzimin njerëzor që e zbukurojnë jetën.

Nuk kemi atë lloj kënge që përshkruan vetëm e vetëm vuajtjet e mërgimtarit, por edhe dramën që ai lë pas, ata shpirtëra njerëzorë që drithërohen për të, për jetën e tij, për

shëndetin e tij. Nënës që mbetet me sytë nga porta e jashtme, motrave e vëllëzërve u pëlcet zemra, prandaj ato i luten sërish djalit, që të vij, se pa të jeta e tyre shkon keq e më keq. Nuk është nevoja që të flasë se ç'ndien nusja e re, pasi ajo ka folur në strofat e para. Tashti pra, rradhën e kanë njerëzit e tij të tjerë më të afërt.. Po përse këta njerëz drithërohen e shqetësohen për burrat që janë larguar. Ata e dijnë se ata do të kthehen, por e kanë edhe një merak e këtë më shumë e kanë nuset e reja. Ky shqetësim-largim njerëzorë është I përvitshëm, si një ritual që patjetër do të ndodh, si një mister që mbetet i tillë.

Megjithëatë, sikur koha ka ngecur në vend, pasi kishin mbetur pa u kënduar të gjitha ninullat, sepse fëmijtë po mugonin në vatrat e tyre, se burrat ishin larg, padashurinë e babait, pa "rritjen" kur e kishin të atin pranë. Ata ishin larg pas tonelatash të ujëvarave qiellore. A kemi të bëjmë me një legjendë, ku njerëzit ishin pas shtatë malesh e shtatë detrash që gratë e vjehrrat i pëshpërsinin nën buzë, ndërsa burrat me kavall. Ja si vijon kënga e drama:

Shkove kapërceve – o njera un-o / krajet s'e thkeve – o njera un-o,/ Pse s'e thkeve krajët – o njera un-o,/ Vet I patë fajet – o njera un-o.

Nusja e re ka pritur se mos vallë burri i saj nuk do të shkonte në shtegtim kësaj here. Ajo e ndjek gjatë gjithë kohës që ai ta kthente kokën pas e ajo t'i bënte ndonjë isharet që ai të mos shkonte. Por ai është i vendosur në atë që do të bënte dhe për të mos iu ligështuar zemra nuk e kthen fare kokën pas. Po nusja a mund të bënte një shenjë të tillë, ku jeta luftonte për mbijetesë? Edhe nusja e di se ai duhet të shkonte, pasi ndryshe jeta e tyre shuhej. Prej aty nusja shkon në dhomën e saj të gjumit. Aty s'duron më: ajo shkrehet me lot, aq sa i mbufaten sytë. Edhe kur po bënte gati teshat (rrobat) për të fjetur asaj nuk i pushojnë lotët. Poeti popullor përdor edhe figura letrare të goditura si metafora, epitete, krahasime. Poshte jorgani burri ka lënë kollanin e fishekëve, ashtu edhe qostekun (orën e xhepit) që nusja i gjen poshtë jorganit dhe dyshekut. Ndonëse ai e ka bërë edhe për të, ajo është kaq e dëshpëruar sa që orë e çast shfaqet edhe meraku i saj ai nuk është larguar për një ditë ose dy, por për gjashtë muaj. Kjo kohë kaq e gjatë është shumë torturuese për të. E kënga vijon e vijon:

Thkeva hina n'odë/ Sajt mushen me lot/ Kur bana me shtraue/ Lotët më shkojshin kraue. / Kur grajta jorgjonin,/ Xheç dada kollanin,/ Kur grajta dyshekin,/ Xheç dada qestekin. /. Kur shkova me ra,/ Desh qasa tu ka, S'jan nji dit e di,/ Jan' gjashtmujt e zi.

2. PAK FJALË PËR DIBRËN, FUSHËN DHE MALIN

Krahina e Dibrës është një zonë që ka pasur peshën e saj të rëndë në historinë kombëtare dhe në shumë raste fjala e pushka e saj kanë qenë vendimnarrëse dhe vendimtare. Kjo nuk është krenari lokale apo krenari krahine. Pa mohuar rolin e trevave të tjera, Dibra e ka thënë kryefjelën dhe kryevendimin e saj, në momentet më kyçe e dramatike të lëvizjeve tona për për liri e troje të përbashkëta. Nuk po hyj në histori, sepse do më duheshin vërtetë faqe e faqe pambarim për të ravijëzuar historinë e saj.

Ajo shtrihet në lartësinë mbi 350 metra mbi nivelin e detit. Lartësia 2751 metra bën që mali i Korabit, të bëhet i njohur si mali më i lartë i Ballkanit. Ky mal qendron mbi të tjerët dhe është si babagjyshi i malave të tjera të Ballkanit. Kurrizi i Korabit ndahet me tre kreshta kryesore, gropat e të cilit përbëjnë edhe pika takimi ndërmjet tyre. Ato kanë disa emra sinjifikativë sikurse janë: Kreshta e Panairit, e Staneve të Preshit dhe e Bjeshkës së Shehut.

Nuk mund të la pa bërë këtë parantezë. Gjyshja ime, ndjesë pastë, ishte një grua që gjithë jetën e kishte kaluar në Peshkopi, pranë përroit, buzë Teqes së dikurshme e xhamisë së qytetit. Kështu ajo njihte shumë histori që lidheshin me këto vende. Kur e pyesja, ajo më fliste për malet, për fushat e lumenjtë që Dibra i ka me bollëk. Kur përmendëte malet më thoshte:Mali ma i naltë është Kurupi. Unë e kisha mësuar në shkollë se atij mali I thonin Korab. Pse Kurup? "Kështu i kemi thanë evel ezel (pra: mot për moti), që kur unë isha vajzë e vogël e kam dëgjuar nga prindërit e mi". Mos vallë gjyshja kishte të drejtë dhe ky mal krenar e simbol heroizmi është quajtur kështu dikur? Unë them se po. Gjyshja mbante mend shumë gjëra, madje para austuries (Austrohungarisë), shumë më përpara. Gjyshja rrojti gjatë, mbase më shumë se 90 vjeç, derisa Perëndia e mori për në Parajsë. Veçse emërtimi që i bënte këtij mali, më ka mbetur në kujtesë..

Udhëtarët e vizitorët thonë se Fusha e Panairit ka një peisazh madhështor, ku mbi të, në perëndim, qëndron maja e Korabit. Ajo ka formën e një stadiumi, në krye të të cilit është një burim me ujin më të ftohtë që buron në Shqipëri. Është ë habitshme se në muajin qershor, vizitori në këtë fushë do të gjejë borë, ujë burimi tepër të ftohtë dhe shumë lule të çelura që kanë një shumëllojshmëri të pazakontë gjethesh e ngjyrash.

Emërtimi "Panairi" nuk është një rastësi. Ky vend është përdorur në shekuj si panairi i blegtorisë për shumë vise të Ballkanit. Para se vizitori të arrijë në Panair, duhet të kalojë Rrafshin e gjerë të Korabit apo sikurse quhet nga vendasit Fushën e Korabit. Historikisht ajo ka shërbyer si urë lidhëse e Kalasë së Dodës me shqiptarët e Kosovës e ato të Maqedonisë.

Në ditët e verës së pakët, Fusha e Korabit, pa e zmadhuar aspak, i ngjan një qilimi gjigand lulesh, të cilat nga java në javë sikur i lënë vendin njeratjetrës. Kjo Fushë u ofron vizitorëve ajër të pastër, aromë dhe bukuri mahnitëse, por edhe pista skish dhe veprimtarish të tjera dimërore, sepse bora këtu qëndron afro 6 muaj. Ajo u ofron vizitorëve jo vetëm ujë të ftohtë, por edhe bulmet bio që është tepër I shijshëm, mbase kjo vjen edhe nga gjethet e bari që ka kjo Fushë.

Teksti I kësaj kënge është poezi. Kjo poezi është, në të vërtetë, edhe një tablo epike me situata rrënqethëse, me një dramë të fshehur e të pa shprejur, por lirisht të nënkuptuar. Vetëm një popull me shpirt artisti mund të sajojë perla të tilla. Kjo këngë më kujton jaret e mrekullueshme shkodrane. Ajo është lehtësisht e krahasueshem me to. Është një tablo e tillë që i jep krahë imagjinatës dhe përfytyrimit për të "parë" me sytë e mendjes, detaje të kësaj drame njerëzore, të ndikuar nga rrethanat e mbijetesës. Atje tej, në gryka malesh e honesh, nën tisin verbues të një mjegulle të dendur, udhëtarët, që më pas do të jenë refugjatë janë nisur në kërkim të fatit të tyre per një jetë më të mirë. Ajo që ata presin të arrijnë, nëse e arrijnë, është shumë pak me atë që lënë. A mund të preferonin më tepër se një dhomë të ngrohtë, me një tavolinë të madhe të mbushur me ushqime të bollshme, apo t'i linin ato zemra që drithërohen për çdo rrahje të pulsit të tyre, për ato shprtra që do të jepnin edhe pjesë të jetës së tyre, për t'i siguruar një jetë të mirë për të dashurin e vet.

Madje, ky njeri që udhëton e shtegton nëpër botë, për kë përpiqet ta sigurojë këtë jetë, vetëm për vete apo edhe njerëzit më të dashur të jetës së tij, të atyre që i kanë qendruar afër, që e shihnin në dritë të syrit. Ata nuk e kanë ndaluar dot këtë marshim maratonomaku, por as edhe e kanë nxitur. "Mos leftë (lindtë) ai djalë që nuk vlen". Kjo sentencë është e njohur edhe në krahinë. Madje nusja e re dhe nëna do të ishin më të lumtura që ta kishin pranë e jo, diku, shtegtuar e harruar dyerve të botës, me tufën përpara. K'to gjashtmujt e verës / T'I shkruej në'qoshe t'pashterkës/ Këto gjssht mujt e dimnit/ T'I shkruej n'qoshe t'çilimit.

A s'janë këto të gjitha një pjesë e mrekullisë dhe e misterit të saj?

3. "SI T'ISHTE SEBEPI,/ T'MË MIRRSHE ME VETE,

Si t'vajsha me t'aj / Rregzinat t'i laja, / Bukën ta gjatuja / koliben ta ruja.

Kuptohet halli i nuses që do të dëshironte të shkonte me të shoqin. Nga ana tjetër shtegëtimi është një punë e vështirë me përgjegjësi, që mbase ajo nuk mund ta përballonte. Madje ai pranonte të qëndronte edhe pa miklimet e saj, të cilat edhe mund ta vononin. Stanet ishin ditëshkurtra dhe barinjët ishin gjithnjë në kërkim për kullosat e tjera që i prisnin.

Nuk mund të rrish e të presësh vendin e përshtatshëm për të shkruar disa rradhë për tufat e dhenëve. Tufat merrnin udhën. Deshët përçorë tundnin këmborët e mëdha. Delet shkonin si të menduara, por edhe të kënaqura për ushqimin që kishin gjetur. Gjatë rrugëtimit të gjatë, ndonjë dele më e dobët mbetej në brinja e nuk ngrihej më. Barinjtë ngrinin e hiqnin stane. Në këto stane të vogla fillonte puna e madhe që I priste. Ndizeshin zjarre dhe burrat vlonin qumështin, e tundnin. Qentë kontrollonin bagëtinë, e kështu me rradhë, gjersa sosnin në destinacion.

Këto momente janë të derdhura në këngë. Më ka mjaftuar e më mjafton të dëgjoja e të dëgjoj masën e parë muzikore të shoqëruar me vargun e parë të kësaj kënge, që më nxisnin të ndiqja me kënaqësi, ndërsa më pushtonin disa ndjenja të forta atdhedashurie e krenarie për trojet e bukura e punëmira të dibranëve. Në trup më përshkonin mornica tek dëgjoja këtë këngë dhe s'ngopesha me atë melodi e ato vargje të qëndisura nga duar mjeshtërore e të skalitura në gojën e bilbIlave të këngës popullore dibrane.

Pas çdo vargu të këngës përmendet e na ndjek vaji i nuses, "O mjera unë". Është një dhembje që jo vetëm prindërit e djalit e kanë, por më të fortë e ka nusja, e cila zakonisht është ë re, sepse djemtë e rinj shkonin të shtegtonin bagëtitë, zakonisht, tufën e deleve, në vende të tjera të ngrohta që kishin kullosë të mirë. Nusja qan hallin e saj. Por edhe djali (burri) e ka hallin e saj e të gjithë familjes. Ata s'mund të bënin pa këtë shtegtim. Burrat do të përgatisnin qumështin, për të bërë djathë, për të bërë gjizë, për ta bërë gjalpë. Me këto zahire do të ushqehej familja, por edhe se një pjesë do ta shiste e do të bilnte sende (dyshekë, jorganë, dru zjarri, unaza) e ushqime të tjera. Në shtegtim nuk shkonte vetëm një bari, Bëheshin bashkë disa që mblidhnin disa tufa (tufat e tyre) dhe shkohej me shokë. Por shtegtimi ishte shumë i vështirë, ndonëse me pushime. Nga vargjet e këngës kuptohet se shtegtimi nisej e kalonte edhe në Maqedoni e në Greqi. Po nusja ka frikë "shkinat do t'i duen, do t'i duen shkinat si t'u lajnë rregzinat" Për fjalën shkinë kujtoni vargjet e Fishtës te "Lahuta e malsisë", ku ai flet disa herë për shkja.

(Vijon në faqen 16)

ese

Duke i qëndruar besnik realitetit, një shkrimtar, nuk mund të bëjë kurrë letërsi të vërtetë.

Punëtori i thjeshtë i shkrimtarisë ose letërsia mes meje dhe teje*


Nga **RAMIZ GJINI**

Ndryshe nga socrealizmi, që solli para lexuesit letërsinë e përçudnuar të marrëveshjes solide mes pushtetit dhe shkrimtarit, pasnëntëdhjeta, krahas disa vlerave të lëna në hije, shfaqi edhe një dukuri masive negative, kryesisht në gjininë e prozës dhe poezisë.

Mendoj, se lipset të merremi më shumë me të si dukuri, se sa duke e analizuar si produkt letrar me minivlerat dhe antivlerat e saj.

Fjala është për një të ashtuquajtur letërsi të tipit hidh e prit me njëri-tjetrin, ose e thënë më troç, një letërsi mes meje dhe teje.

Kjo lloj letërsie ka gjetur një shtrat vegjetimi sidomos në internet, në faqet e mediave të shkruara dhe në emisionet mbi artin dhe kulturën të mediave vizive në vendin amë, por edhe në diasporë, në vendet e Europës dhe Amerikës. Këta shkrues, mund të klasifikohen si punëtorë të thjeshtë të brigadës së madhe të shkrimtarisë.



Suksesi i një shkrimtari nis kur ai vendos në punë imagjinatën e tij dhe e ka të qartë çfarë do të tregojë. Në procesin letrar, imagjinata është më e rëndësishme se njohja. "Imagination is more important than knoëledge", - thonë amerikanet.

PUNËTORI I THJESHTË I SHKRIMTARISË

Punëtori i thjeshtë i shkrimtarisë, ka ekzistuar edhe gjatë regjimit të vjetër diktatorial, por ka qenë i seleksionuar dhe i kontrolluar me brutalitet nga shteti. Strukturat e shtetit i përpunonin talentet duke u injektuar në gjak frymën revolucionare dhe luftën antagoniste të klasave dhe jepnin direktiva se si duhej shkruar letërsia.

Ajo brigadë, qe njohur me emrin Lidhja e Shkrimtarëve, e cila, kishte punëtorët e saj të shkrimtarisë.

E ashtuquajtura letërsi e realizmit socialist, që lakohet rëndom edhe sot me këtë term, në fakt, nuk ishte, dhe nuk duhet quajtur e tillë. Ajo letërsi, vetëm realizëm nuk kishte. Ajo qe një produkt propagandistik letrash i brigadës së thjeshtë të shkrimtarisë, e cila bëri çfarë deshi kupola e pushtetit. Nëse ka ndonjë meritë, ajo qëndron në faktin, që një pakicë e bëri mirë, kurse shumica e bëri keq.

Për shkak të rrethanave në të cilën u shkruajt kjo letërsi, pjesa më e madhe e saj, sot është harruar duke mbetur ato vepra, heronjtë e të cilave, nuk mbartinin karakteristikat e njeriut të ri socialist, por mbartin njeriun e vërtetë me problemet dhe hallet e tij të përditshme. Ndryshimi mes dy kohërave qëndron, sepse në atë kohë, autorët shkruanin pak prej qejfit dhe shumë prej hallit, sot këto punëtorë të thjeshtë shkrimtarie, e bëjnë sepse thjeshtë, u pëlqen të jenë shkrimtarë.

"MIQTË" DHE "ARMIQTË"

Një tjetër karakteristikë e brigadës së punëtorëve të thjeshtë të shkrimtarisë, është edhe këmbëngulja e autorëve për të gjetur me çdo kusht mirëkuptim tek lexuesit.

Ata duan, që produkti i tyre, i ashtuquajtur letrar, të pranohet patjetër nga lexuesi. Rëndom, ato gjenden dukshëm përballë dy kategorish ekstremiste lexuesish, që janë: lexuesit "miq" dhe lexuesit "armiq". Brenda këtyre dy kategorish lexuesish futen edhe lexuesit - shkrimtarë kolegë të autorit.

Për vetë qëllimin, që ka lufta mes "miqve" dhe "armiqve", ajo gjithnjë ka atmosferë donkishoteske.

Ajo është shfaqur dhe vazhdon të shfaqet, sidomos, në listat e internetit. Ne njohim raste kur në Tiranë, janë botuar libra nga personalitete të medjave dhe të politikës. Duke qenë se kanë patur në dorë mjetet e propagandës, ata i kanë ngritur në qiell me bujë krijimet e tyre si vepra me shumë vlera. Mirëpo kjo bujë, ka zgjatur, aq sa është dashur të binte libri në duart e lexuesit, i cili, i ka ndëshkuar me pluhurin e harresës.

Dashakëqinjtë më të mëdhenj të punëtorëve të thjeshtë të brigadës së shkrimtarisë, gjenden brenda llojit. Ata janë gjithnjë cinik, përpiqen të të dekurajojnë, sepse nuk duan të bësh karrierë. Karrierën e duan me çdo kusht për veten e tyre.

Nganjëherë konfliktet acarohen aq shumë sa pason kërcënimi "shihemi në gjyq".

Është një traditë, që shkrimtarët, u japin të tjerëve t'i lexojnë krijimet e tyre. Ata kanë maninë për t'u bërë të njohur dhe kjo mani, në shumicën prej tyre, ngrihet mbi arsyen.

Taktikisht, në fillim, kjo kategori shkruesish, punon shumë me "miqtë", që në shumicën e rasteve, janë sivëllezër të tij. Motoja: më lavdëro ti, të të lavdëroj edhe unë, mbetet himni më skandaloz i kauzës së punëtorëve të thjeshtë të brigadës së shkrimtarisë.

E ashtuquajtura kritikë letrare, që i bëhet një libri me shumë superlativa nga "miqtë', ka po aq efekt negativ, sa ç'ka një kritikë, që vjen me dashakeqësi nga "armiqtë".

Është naivitet i madh, që një shkrimtar, të mendojë se po arrin sukses, kur shikon, që i thurin lavde persona, që nuk kanë eksperienca leximi dhe nuk e njohin fare letërsinë. Në rastin më të mirë, autori është skeptik ndaj lavdeve, që i bën kjo kategori lexuesish. I dëgjon ato me respekt, por ia rezervon vetes një farë dyshimi, që e çon në vetkontroll dhe e bën të njohë mire veten.

Në rastin më të keq, ai beson se shkruan vërtet mirë dhe këto lavde, i përdor si armë për të dërrmuar ata që nuk e duan.

Këto lavde, i shikojmë në gazeta si artikuj kritikësh të ngazëllyer, por dhe në emisione televizive, kur i prezantojnë apo prezantohen vetë këta autorë.

Të gjitha konsideratat personale të mbushura me superlativa, që miqtë shkëmbejnë privatisht me njëri-tjetrin, postohen në të gjitha adresat e listave të internetit, për të marrë vesh armiku brenda klasës së punëtorëve të thjeshtë të brigadës së shkrimtarisë, se sa i madh është filani apo filanka.

Kësisoj, është gënjeshtra, që ata sajojnë vetë, ajo që punon më fort për të dalë në dritë e vërteta.

TË SHKRUARIT SI NJË ZEJE QË MUND TA BËJË GJITHSECILI.

Sado të përpiqemi të jemi racional në gjykimin e këtij produkti punëtorësh të brigadës së madhe të shkrimtarisë, serioziteti bie që në hapin e parë.

Arti i të shkruarit, që normalisht duhet të jetë privilegj i atyre, që talentin e kanë dhuratë prej Zotit dhe suksesin e arrijnë me punë të madhe e të palodhshme, duket se është shndërruar në një zeje e lehtë, që pretendon ta bëjë gjithsecili.

Nëse një person kërkon të arrijë lartësi profesionale duke e studiuar zanatin e të shkruarit e duke u praktikuar gjatë gjithë kohës, e pastaj publikon pareshtur dyzinat e shkrimeve të tij, atëherë kësisoj, të gjithë mund të bëheshin shkrimtarë. Kjo formë arritje e punëtorit të thjeshtë në shkrimtari, fatkeqësisht, sot është bërë e modës në atdhe, por jo pak edhe në diasporë.

Punëtori i thjeshtë i shkrimtarisë, bën, si të thuash, biznes më vete: kultivon bimë shkrimtarie, frutat e të cilave, ndonëse të papjekura, memzi pret t'ia shesë lexuesit si fruta të arrira.

Kësisoj, punëtori i thjeshtë i shkrimtarisë, zgjedh rrugën dhe mjetet e gabuara kur kërkon të fitojë famë e respekt me anë të artit si produkt konsumi të përditshëm, i sërvirur vetëm për rrethin e shokëve dhe miqve të tij.

ARTI LETRAR SI PERCEPTIM

Punëtori i thjeshtë i shkrimtarisë, e përdor shkrimtarinë për të qarë hallet e tij, duke u përpjekur të trajtojë problematika të rëndomta të jetës së përditshme.

Kjo ndodh sepse perceptimet intuitive për të rrokur tema dhe ide, aktualisht paraqiten në nivele mjaft të ulëta. Në gjithë këtë masë gjigante produkti letrar, perceptimin e gjejmë më shumë të një karakteri bajat, të përbashkët e masiv.

Në shumicën e rasteve, për lexuesin e zgjuar, historia tashmë është e njohur: tregimin, ta zëmë, e ka lexuar si artikull në gazetë, është treguar si barcalet, është rrëfyer në ndonjë kafene, ose i ka ndodhur dhe vazhdon t'i ndodhë vetë autorit çdo ditë në jetën e përditshme.

Menyja e këtij produkti letrar, që ka pushtuar tregun, mbetet e varfër. Ajo ngjan me ato ushqimet e përditshme, që në kohën e diktaturës, gatuheshin për drekë në mensat e Stacioneve të Makinave dhe Traktorëve ku spikaste grosha, pilafi dhe kosi.

Këto lloj produktesh që shiten si art, një mik i imi, profesor në një universitet te New Yorkut, i quajti një ditë si me shaka "vezë pularie".

KOPJIMI ME PËRPIKMËRI I REALITETIT DHE IMAGJINATA

Disa shkrues, bëjnë libra, brenda të cilëve gjejmë një realitet të kopjuar me përpikmëri. Realiteti është në pamje të pare i rëndomtë, ndaj është gabim i madh ta kopjosh atë me përpikmëri.

Duke i qëndruar besnik realitetit, një shkrimtar, nuk mund të bëjë kurrë letërsi të vërtetë.

Realiteti, është gjëja më e parrokshme dhe asnjëherë e përcaktuar drejtë ashtu siç duhet. Por shkrimtari mund të flasë për një vezullim, që e ka burimin tek realiteti, për një si shfaqje e një momenti suksesiv, gjithnjë e dyshimtë dhe kurrë e përkufizuar ashtu siç duhet.

Historia e kopjuar me përpikmëri, ashtu siç e ke parë, apo e ke dëgjuar, mund të mos ketë situatë dhe karaktere, mund të mos ketë aksion, mund të mos ketë karaktere të planit të dytë, mund të mos ketë informacion që jepet përmes dialogut, mund të mos ketë mister. Të gjitha këto, janë detyrë e shkrimtarit, i cili duhet t'i krijojë vetë me imagjinatë kur ai punon për ngrehinën e tij letrare, përndryshe, ngrehina do të dalë, pa çati, pa dyer e pa dritare.

Po e ilustroj me një incident të vogël, që më ka ndodhur para pak kohesh:

Dikush më solli një tregim t'ia lexoja dhe t'i jepja një mendim. Pasi e lexova, për t'u treguar i çiltër e njëkohësisht për ta ndihmuar, i thashë të vërtetën. I thashë, që tregimi nuk bënte, sepse kishte inkoseguenca dhe mungesë logjike. Për më tepër, qe shkruar shumë keq duke mos respektuar normat gjuhësore.

Filloi të zemërohej. Tha se çuditej me reagimin tim, pasi të gjithë ia kishin pëlqyer, kurse unë, jo. Mes atyre që ia kishin pëlqyer, gjendeshin edhe shkrimtarë të njohur, disa prej të cilëve jetonin në New York. Nisi të betohej se gjithçka kishte shkruar ishte e vërtetë. Nëse nuk beson, tha, pyet filanin, sepse ka qenë edhe ai aty kur ka ndodhur kjo ngjarje. A thua se letërsia e mirëqenë e merka viston me të pyetur lart e poshtë, apo duke u betuar në kokën e ndonjë të dashuri të shtrenjtë. Pra, personi në fjalë ngatërronte letërsinë e vërtetë me të vërtetën e rëndomtë.

Duke shkruar keq gjithçka ke parë e ke dëgjuar, nuk bëhesh kurrë shkrimtar. Por nuk bëhesh as kur e shkruan mirë, sepse nëse ndodhia nuk thotë asgjë, edhe ai që e shkruan, domosdo, që nuk thotë asgjë.

Suksesi i një shkrimtari, nis kur ai vendos në punë imagjinatën e tij dhe e ka të qartë çfarë do të tregojë. Në procesin letrar, imagjinata është më e rëndësishme se njohja. "Imagination is more important than knoëledge", thonë amerikanet.

TË SHKRUARIT SI AKT KREJT PERSONAL

Mendoj, që nuk është mirë, t'u kërkosh mendim për shkrimet e tua njerëzve që shkruajnë, pasi ata, ose të thonë atë gjë, që do të bënin vetë, ose të thonë një gjë të gabuar. Dhe, nëse i ndjek e bën çfarë thonë ata, kësisoj, ti je automatikisht, jashtë vetes tënde. Gjëja më e mirë është, që të gjesh një mjedis ku shkrimtarët mblidhen dhe diskutojnë për letërsinë, sepse ata kanë eksperiencë në të shkruar dhe njëkohësisht, eksperiencë në lexime.

Është shumë mirë të jesh i pranishëm në mjediset ku flitet për letërsinë, ose për shkrimtarët e mëdhenj të botës dhe veprat që ata kanë shkruar, pasi vetëm kështu mund të kuptojmë se cila është letërsia e madhe, çfarë është vlerë e pafshirë nga koha. Nëse këto mjedise nuk gjenden, - sidomos këtu në New York është e pamundur - në Tiranë ky vend mund të gjendet. Gjej rastin të përmend këtu një nismë të shkrimtarit dhe poetit të Agron Tufa, e thirrur "E premtja letrare", e cila është bërë tashmë një praktikë e përjavshme. Çdo të premte në darkë, krijues të ndryshëm mblidhen në kafe - librarinë "E përshtatshme" , ku flasin për letërsinë si dhe lexojnë krijime dhe përkthime të ndryshme. Por edhe nëse këto mjedise nuk gjenden, të paktën të merremi me lexime, pasi informacion ka sa të duash.Të shkruarit, si çdo art tjetër, është një akt krejt personal. Dhe budallallëku më i madh është gjithashtu, kur kërkon dhe pret mirëkuptimin e gjithsecilit.

Një tjetër budallallëk është të shkruash qëllimisht për shijet e një publiku të zakonshëm. Prandaj le të përpiqemi të shkruajmë për të mbajtur nën kontroll inteligjencën tonë dhe jo duke u përpjekur të çudisim të tjerët. Le të shkruajmë për të ndërtuar jetën tonë rreth këtij zanati e për ta bërë krijimtarinë mënyrë jetese.

Kumtesë e mbajtur në simpoziumin shkencor që Lidhja e Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikane organizoi në New York më 22 Janar 2013

Intervistat dhe fotot nuk mbarojnë pas triumfit dhe ajo nate është gdhirë duke festuar në Shtugard dhe në Mynih, 250 km larg. S'kemi fjetur gjumë. Ishte një fitore e madhe dhe drithëruese, një fitore jo vetëm sportive, por edhe njerëzore.

reportazh

Nga Shtutgardi në Tiranë me Kampionin e Botës

Nga **DEFRIM METHASANI**





FITORJA E NJË KAMPIONI DHE NDERIMET E SHQIPTARËVE

Në Shtugard mbrëmja e 7 dhjetorit ishte e ftohtë. Gjithsesi, moti kurrë s'mund të ishte pengesë, që ajo sallë gjigante në "Porsh Arena" të mbushej plot. Djaloshi shqiptar nga Bulqiza, Ismail Keta, do të ndeshej për titullin e tretë kampion bote, tashmë duke luftuar për dy jetë: Ambrën dhe Sigin, dy vajzat shqiptare që kurohen në spitalet në Mynih dhe Hamburg.

Emocionet ishin të jashtëzakonshme. Kur Ismail Keta u thirr të dilte në ring, spikeri gjerman ka treguar se ndeshja e tij kishte një domethënie të veçantë, sepse bëhej për të ndihmuar dy jetë, dy vajza shqiptare që ndodheshin atje. Duartrokitjet nuk kishin të sosur. Dhjetë mijë vetë u ngritën në këmbë. Një moment shumë prekës. Me pas starton ndeshja, e cila nuk besohej të ishte e atij niveli dhe shkallë vështirësie. Kundërshtari nga Tajlanda kishte një përvojë të jashtëzakonshme, me 168 ndeshje përkundrejt 58 të Ketës. Raundi i pare dhe i dytë kishin një ekuilibër, por një epërsi të lehtë në pikë nga kundërshtari. Por raundi i tretë solli prishjen e magjisë dhe vërshimin e vullkanit të lotëve dhe entuziazmit. Pas disa goditjeve rresht në kokë dhe në trup, kundërshtari ka mbetur i shtrirë. Gjyqtari i ndeshjes ka numëruar, por ai s'ka mundur dot të ngrihej. Tashme Keta fiton ndeshjen, titullin dhe respektin e mijëra njerëzve në stadium dhe miliona të tjerëve që ndiqnin ndeshjen e tij në SAT1.

Pas fitores jemi ngjitur në ring, duke e përqafuar si kurrë më parë, madje përqafimi im, me duket se ishte për të gjithë shqiptarët. Ismail Keta ka nderuar jo vetëm familjen dhe veten, por një komb të tërë.

Intervistat dhe fotot nuk mbarojnë pas triumfit dhe ajo nate është gdhirë duke festuar në Shtugard dhe në Mynih, 250 km larg. S'kemi fjetur gjumë. Ishte një fitore e madhe dhe drithëruese, një fitore jo vetëm sportive, por edhe njerëzore.

Telefonata e pare ishte nga Ambra për kampionin. Ismaili që dëgjohej të thoshte: "Ambra fitova edhe për ty, për jetën tënde…"! Lotët na rridhnin faqeve. Se mbanim dot veten. Vizita në spital kishte emocionet e saj. Një mrekulli e vërtetë. Dukej që Ambra ish shëruar plotësisht. Falë Ismail Ketës edhe ajo ndjehej më mirë.

Pas disa ore qëndrimi fluturuam serish drejt Tiranës, tashmë të qetë që misioni i kampionit u krye, për sportin dhe për jetët e dy vajzave shqiptare. Ai meritonte të pritej si hero ne atdheun e tij dhe realisht ashtu ndodhi..

MEDIA & SPORT: "MIRËNJOHJE KAMPIONIT"!

Titulli i fundit në Kik dhe Tai Boks për djaloshin 37-vjeçar nga Bulqiza Ismail Keta ka qenë më i veçanti dhe që i ka kaluar kufijtë e një përballjeje sportive, sepse i dedikohej dy vajzave shqiptare, Ambra Meda dhe Sigi Gjini. Kjo fitore kaq dinjitoze dhe humane nuk mund të mbetej e heshtur në Tiranë.

Një organizim i shoqatës më të re sportive "Media&Sport" në hotel Tirana Internacional, bëri që kampioni Keta të pritej si hero edhe në atdheun e tij, Shqipërinë. Me emocione të mëdha dhe nën duartrokitjen e të pranishmëve kanë hyrë në sallë kampioni Isamail Keta dhe i vëllai i tij, Gjetani, i cili shumë shpejt do të jetë në ring për titullin Kampion Bote. Moderatorët, babë e bijë, Defrim dhe Lunada Methasani kishin rezervuar shume surpriza për vëllezërit Keta. Këndimi i Himnit Kombëtar nga Dilan Reka, beri hapjen e këtij takimi. Më pas të gjithë të pranishmit kanë ndjekur çaste nga ndeshja e 7 dhjetorit, ku Ismaili u shpall Kampion Bote për të tretin vit radhazi.

Në fillim ka përshëndetur presidenti i KOKSh, zoti Viron Bezhani, i cili ka pohuar se KOKSH do ta ketë misionarin e vitit 2014 këtë kampion, ndërsa vëllai i tij Gjetan Keta do konkurroje në të ardhmen për ngjyrat e Shqipërisë.

Me pas dhuratat dhe mirënjohjet për kampionin kanë qene të shumta. Lidhja e Intelektualëve Dibranë i ka dhënë titullin e mirënjohjes për Ismail Ketën për vlerat e larta humaniste. Mirënjohja ka patur dhe nga jashtë kufijve të shtetit shqiptar, pasi shoqata e Gazetarëve Sportivë Profesionistë të Kosovës, me kryetari Milaim Krasniqin, kanë dashur të vlerësojnë arritjet e njeriut humanist Ismail Keta. Zv.kryetari i Akademisë së Shkencave Prof.dr Gudar Beqiraj ka përshëndetur kampionin, duke e quajtur atë si një vlerë kombëtare që emrin e Shqipërisë e ka ngritur në majat më të larta. Mirënjohje për Ismail Ketën ka patur edhe nga shoqata e të drejtave ndërkombëtare të njeriut me qendër në Bon të Gjermanisë, me president të saj zotin Lulëzim Brahja. Ndërsa mirënjohja e fundit ka qenë nga shoqata e "Djelmënisë dibrane" nga Dibra e Madhe Maqedoni, që kishin ardhur enkas për këtë eveniment.

Përshëndetjet kanë qenë të shumta nga figura e personalitete të ndryshme. Nuk kanë munguar as tingujt e muzikës nga mjeshtrat e këngës si Francesk Radi, Qerim Sula dhe Dritan Jashari, por edhe surpriza e fundit nga miqtë e tij dhe familja Meda ku shkruhej: "Ti je kampioni i jetës së Ambrës dhe gjithë shqiptarëve".

Kampionin e trefishtë e ka nderuar edhe Presidenti i Republikës, Bujar Nishani. Ai i ka rezervuar një pritje kampionit të botës Ismail Keta, duke e quajtur një ambasador të vlerave më të mira shqiptare përtej kufijve. Sipas tij, njerëz të tille i duhen kombit shqiptar, me peshën dhe modelin e tyre, bëjnë punën më fisnike në promovimin e vlerave tona pozitive".

KOKSH: KËTA MISIONARË TË LËVIZJES OLIMPIKE!

Ne mjediset e KOKSH pritja që i është rezervuar një kampioni të madh, ishte po e tillë. Pas dorëzimit të mirënjohjes në emër të KOKSH, presidenti Viron Bezhani, ka treguar se për vitin 2014, Ismail Keta do të jetë misionari i lëvizjes olimpike në Shqipëri. Ndërkaq, një lajm shumë i mirë është fakti që ky institucion ka treguar gatishmërinë që Gjetan Keta, vëllai i kampionit, të konkurrojë për ngjyrat e vendit tonë në arenën ndërkombëtare në sportin e Kik Boksit.

SHKODRA RESPEKT KAMPIONIT

Më tej, është qyteti i Shkodrës që rezervon një pritje të veçantë. Qindra sportistë, trajnerë dhe sportdashës e gazetarë, kishin dalë ta prisnin kampionin te pallati i sportit. Bashkë me ta edhe dy kampionët e njohur shkodranë ne mundje dhe peshëngritje, Elis Guri dhe Erkand Qerimaj. Një ditë që nuk mbaronte, sepse dhjetëra të rinj qëndronin pranë kampionit. Mirënjohje nga klubi Vllaznia dhe ekipi i futbollit të femrave "Juban Danja", ishin për vlerat e Ismail Ketës, që tashmë është i famshëm kudo, pse jo në qytetin e djeplindjes së sportit, në Shkodër. Ajo ditë do të mbetet e paharruar për vetë shkodranët, por edhe për Ketën, që u ndje

cyan magenta yellow black

sport



Me Presidentin e Republikës, Z. Bujar Nishani



Me shkrimtarin Dritëro Agolli - Nderi i Kombit



Vëllezërit Keta, me gazetarin sportiv Defrim Methasani dhe prezantuesen Lunada Methasani



Me nënkryetarin e Lidhjes së Intelektualëve Dibranë, Z. Musa Riçku



Mes miqsh në Shkodër



Me Milaim Krasniqin, kryetarin e Gazetarëve Sportivë Profesionistë të Kosovës

njëlloj si ata, i thjeshtë dhe shumë i dashur me njerëzit..

DITËRO AGOLLI: ISMAIL, TI E RRITE NJË KAT SHQIPËRINË NË EUROPË"!

"Në shtëpinë e Dritëro Agollit gjithnje ka patur miq, por një mik i veçantë si Ismail Keta, s'ka ardhur kurre". Kështu do ta quante njeriu i madh i letrave vizitën e kampionit në shtëpinë e tij. Me tej, ai ka pohuar se "njerëz si ti, e rrisin një kat emrin e Shqipërisë në Europë, ndërsa sporti dhe suksesi yt, është një model edhe për politikanët tanë". Sipas Agollit, "sportistët janë kundërshtarë në ring, por miq pas ndeshjes, ndërsa në politike ka vetëm armiq dhe jo kundërshtarë". Më tej biseda ishte shumë miqësore, madje Dritero Agolli ka recituar poezi që Keta i kishte shumë për zemër dhe i kish patur si frymëzim në jetën dhe sukseset e tij, për ta dashur më shumë Atdheun.

NË LEZHË, MES DIBRANEVE TË MIRË DHE TË ZOTË..!

Në Lezhë ka shumë dibranë, madje janë mjaft të mirë dhe të zotët. Takimi që ata rezervuan për kampionin ishte shumë domethënës. Në një prej mjediseve të bukura si "Gradn Stella", që ka pronar një djalë Dibre, u rezervua takimi emocionues, iniciuar nga drejtuesit e shoqatës së dibranëve në Lezhë. Fjalët të zemrës, dhurata dhe vlerësime të pafund e me tej një drekë e përbashkët ku kujtimet dhe urimet s'kishin të sosur.

Nderimi për kampionin do të vijojë në ditët në vazhdim edhe në Sarandë, sepse bashkia e këtij qyteti do t'i japë simbolin e qytetit për kampionin e shumëfishtë të botes. Ndërsa ministrja e Arsimit dhe Sportit Lindita Nikolla dhe kryeministri Edi Rama, kanë treguar gatishmërinë për të rezervuar takimin dhe pritjen në respekt të Ismailit, kampionit të ringut dhe vlerave njerëzore.

Dibra ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në historinë tonë nacionale për të gjitha periudhat, i cili është bërë i njohur edhe në sajë të studimeve historike të Hazis Ndreut

Hazis Ndreu, përfaqësuesi më i denjë i antropologjisë kulturore dibrane



- Dibra ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në historinë tonë nacionale për të gjitha periudhat, i cili është bërë i njohur edhe në sajë të studimeve historike të Hazis Ndreut.
- Një nga vlerat e qenësishme e studimeve historike të Hazis Ndreut është njohja perfekte e terrenit si dhe e toponimisë historike të Dibrës, pa të cilat është e vështirë të orientohesh në këtë fushë studimesh.

Nga Prof. dr. **ADEM BUNGURI**

Pikësëpari dëshëroj të falenderoj bijtë e Hazis Ndreut, Avniun, Nesimin, Fatmirin dhe Benin, si dhe organizatorin e këtij promovimi për ftesën dhe mundësinë për të thënë dy fjalë për mikun tim të mirë dhe mikun e shumë dibranëve dhe shqiptarëve brenda e jashtë vendit, historianin dhe etnologun shumë të njohur në Shqipëri dhe jashtë saj, Hazis Ndreun e Dibrës. Së dyti, dëshëroj të falenderoj autorin e librit, studiuesin dhe eseistin e mirënjohur, prof. Xhezair Abazi për këtë monografi të shkëlqyer, të plotë dhe dinjitoze, të shkruar me dashuri dhe vërtetësi, e cila ka plotësuar një dëshirë jo vetëm të miqve të Hazizit, por të mbarë dibranëve të të dy Dibrave e më gjërë. Po kështu dëshëroj të falenderoj edhe prof. Gafur Muka për kontributin e tij të çmuar në realizimin e saj. Me këtë monografi është përjetësuar vepra shkencore, kulturore dhe patriotike e Hazis Ndreut, e krahasueshme me një monument, të cilin vetë Hazizi, me punën e tij pasionante, e kishte ngritur që në të gjallë të tij.

Një njeri mund të jetë një këngëtar shumë i mirë, një instrumentist shumë i mirë, një valltar shumë i mirë, një koreograf shumë i mirë, një poet shumë i mirë, një etnolog shumë i mirë, një studiues shumë i mirë, një historian shumë i mirë, një qytetar shumë i mirë etj, por është thuajse e pamundur që të gjithë këto cilësi të bashkohen në një personazh të vetëm. Kjo ka ndodhur me Hazis Ndreun e Dibrës, përfaqësuesin e fundit të shquar të kësaj kategorie njerëzish të rrallë e shumë të vyer. Pasi e ke lexuar këtë libër, ndjehesh më i plotësuar dhe më krenar për vendin tënd dhe bijtë e tij të shquar, siç ishte Hazis Ndreu i Dibrës dhe thua me krenari:" Unë e kam njohur Hazis Ndreun", "Unë kam jetuar në një qytet me Hazis Ndreun", "Unë kam qenë bashkëkohës i Hazis Ndreut", "Unë e kam patur mik Hazis Ndreun"! Dhe ndjehesh disi i lehtësuar, që shoqëria ku ti bën pjesë dhe ku Hazisi kishte shkrirë të gjithë energjitë dhe talentin e tij, po e vlerëson siç duhet personalitetin e tij polivalent, vlerësim që nuk mund të thuhet se i ishte bërë i plotë në të gjallë të tij.

Në këtë fjalë përshëndetje, unë nuk mund të flas për këngëtarin melodioz dhe instrumentistin brilant Hazis Ndreu, që ngrinte peshë zemrat e mijëra shqiptarëve në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni dhe kudo nëpër botë, sepse këtë e ka bërë kompozitori ynë i shquar Mond Zhulali, nuk mund të flas për valltarin fluturues dhe koreografin fanatzist Hazis Ndreu, që përveç çmimeve kombëtare ka rrëmbyer disa çmime ndërkombëtare, në Moskë, në Pekin, në Bukuresht, në Paris etj, se këtë e kanë bërë mjeshtërit e kësaj fushe, Besim Zekthi, Ramazan Bogdani, Skënder Selimi dhe akademiku Vaso Tole, nuk mund të them asgjë për rapsoditë e tij patriotike dhe satirike apo lirikën politike dhe shoqërore, sepse këtë e kanë bërë studiuesit Vaso Tole, Moikom Zeqo dhe Xhezair Abazi, nuk mund të flas për kontributin e tij si etnolog, se nuk mund të them asgjë më shumë se Vaso Tole, Moikom Zeqo dhe Xhezair Abazi, nuk mund të flas për alegorinë e tij dibrane, se këtë e kanë bërë në mënyrë perfekte Xhafer Martini dhe Xhezair Abazi.

Ajo që unë mund të them është kontributi i çmuar Hazis Ndreut në historgrafi. Dibra ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në historinë tonë nacionale për të gjitha periudhat, i cili është bërë i njohur edhe në sajë të studimeve historike të Hazis Ndreut. Hazis Ndreu e kishte kuptuar qysh herët që kultura, tradita, zakonet, kanonet, këngët dhe në përgjithësi i gjithë substrati etnologjik përbënin ADN e një populli. Ai ka meritën e madhe se gjithë jetën e tij ja kushtoi njohjes dhe studimit të ADN-së së popullit të tij. Dhe për këtë ai ka përdorur të gjitha metodat bashkëkohore të studimit të antropologjissë kulturore dhe të historisë, që nga vjelja e arkivit të gjallë nga bartësit e saj (njerëzit e thjeshtë të popullit) apo ***"udhëtimi në rrënjë të jetës dhe historisë"*** siç e quan Xh. Abazi, deri tek arkivat e Vjenës dhe të Venedikut në Tiranë. I bindur thellë në vlerat e studimit të historisë dhe të etnokulturës dibrane, si pjesë e rëndësishme e historisë dhe kulturës kombëtare, ai do të vazhdojë të punojë me përkushtim në këtë fushë të dijes deri në fund të jetës së tij.

Një nga vlerat e qenësishme e studimeve historike të Hazis Ndreut është njohja perfekte e terrenit si dhe e toponimisë historike të Dibrës, pa të cilat është e vështirë të orientohesh në këtë fushë studimesh. Është kjo arsyeja, që studimet e tij historike ishin të argumentuara dhe të publikuara pa hezitim në organet shkencore qëndrore në Tiranë.

Haziz Ndreu ka bërë një punë të shkëlqyer në mbledhjen e toponimisë historike të Dibrës, dhe ka lënë në dorëshkrim një korpus të vërtetë të tyre si dhe qindra faqe me të dhëna burimore e historike, të vjelura me dashuri e pasion nga arkivi i madh i popullit. Unë e konsideroj veten me fat që kam patur mundësinë të njihem dhe të bashkëpunoj me një njeri të rrallë dhe shumë të vyer për historinë, traditën dhe etnokulturën tonë, padyshim përfaqësuesi më i denjë i antropologjisë kulturore dibrane, siç ishte Hazis Ndreu.

Njohja ime me Hazis Ndreun është mjaft e hershme dhe ka kaluar nëpër tri faza kronologjike, edhe pse me hiatuse midis tyre:

Faza e parë dhe më e hershme i referohet kohës së fëmijërisë dhe rinisë së hershme dhe lidhej me festën e çlirimit të Peshkopisë. Duke filluar nga klasa V e tetëvjeçares, çdo vit në ditën e 23 gushtit do të shkonim me patjetër në qytet, ku pasi shëtiteshim dhe blinim akullore dhe shalqin, do të ndiqnim koncertin festiv me rapsodi dhe këngë patriotike, të shtëpisë së kulturës "H. Stërmilli". Koncertet organizoheshin në pika të ndryshme të qytetit. Fillimisht ato bëheshin afër pallatit të sotëm të kultures, aty ku vite më vonë do të ndërtohej ambëltorja e qytetit, më vonë në sheshin "N. Rushiti" etj. I ndiqnim me dëshirë këngët e Muharem Zajmit, Melita Shehut dhe Skënder Calës, si dhe rapsoditë patriotike të Hazis Ndreut.

(Vijon në faqen 19)

Promovohet libri "Ezopi i Dibrës" i shkrimtarit Xhezair Abazi

Një libër dhe një këngë për Haziz Ndreun

Nga ***Ilmi Dervishi***

Më 7 dhjetor, në Muzeun Historik Kombëtar në Tiranë u prezantua libri "Ezopi i Dibrës" të shkrimtarit Xhezair Abazi, një libër më tepër se një monografi për njeriun e artit, enciklopedikun shumëdimensional Haziz Ndreu.

Njerëz të artit, miq e dashamirës të shumtë, mbushën sallë. Kishte personalitete të politikës dhe shkencës dhe përfaqësues të institucioneve.

Prezantimi i librit u moderua nga artisti Bujar Kapexhiu, i cili me batutat dhe grimcat humoristike, e bëri sallën të shpërthente në duartrokitje gjatë gjithë takimit.

U fol për librin, u fol për Hazizin për vlerat e tij të padiskutueshme në jetë, shoqëri, krijimtari dhe historike. Foli Prof. Skënder Selimi, mjeshtri i koreografisë shqiptare. Kandidati i shkencave Gafur Muka, në njohjen e tij prej shumë vitesh se Haziz Ndreu sjell detaje interesante. Profesor Vaso Tole, muzikolog i dëgjuar, duke folur para auditorit thotë se Hazizi mund të quhej dhe Moxarti sepse ishte jo vetëm këngëtar por edhe muzikant. Prof. dr. Adem Bunguri, nxori në pah vlerat e Haziz Ndreut në fushën e historisë, sidomos për vendlindjen e Skënderbeut. Diskutime dhe vlerësime për librin dhe Hazi Ndreun dhe nga Lumturi Çela, regjisori, aktori dhe këngëtari Skënder Cala dhe shkrimtari Viron Kona. Mes duartrokitjeve u prit fjala e aktorit të humorit Veli Rada, një mik i kahershëm i Haziz Ndreut. Me seriozitet dhe humor jep disa nga momentet e njohjes me Hazizin. I thjeshtë dhe plot kuptim ishte fjala e valltarit virtuoz Besim Zekthi, aktorit të madh Luftar Paja, për të cilin Hazis Ndreu ishte nje idhull

Me emocione e duartrokitje u prit përshëndetja e kryetarit të bashkisë së Dibrës së Madhe, zoti Ruzhdi Lata, të cilin e lexoi Bujar Kapexhiu, si dhe kënga kushtuar Haziz Ndreu, kënduar nga këngëtari dërnjan, Kujtim Çerpja me trion e vajzave shkruar enkas për këtë eveniment.

Pas diskutimeve e mori fjalën shkrimtari Xhezair Abazi i cili foli për të pathënat e librit. Në emër të familjes përshëndeti djali i madh i Hazizit, koreografi dhe vallatari Avni Ndreu.

Në fund për të pranishmit pati një koktej.

botime

Haziz Ndreu e ka ngritur monumentin e vetë
me veprimtarinë e tij krijuese, tërësisht origjinale

Në një odë dibrane me Haziz Ndreun

Nga **VIRON KONA**


Faleminderit z. Xhezair Abazi, juve përfaqësues të shtëpisë botuese "Onufri", familjarë e miq të Haziz Ndreut, që sot na keni ftuar në këtë "odë të madhe dibrane", këtu, në Muzeun Historik Kombëtar të Shqipërisë, për të bashkëbiseduar vëllazërisht për veprën kushtuar njeriut simbol të kulturës dhe artit shqiptar, dibranit të mençur dhe të ditur, folkloristit dhe rapsodit, valltarit, deklamuesit dhe poetit popullor, për të cilin, gjithkujt ia ka ënda t`i thotë sot dy fjalë.

Është meritë e vetë Haziz Ndreut, e veprës së tij të madhe, që ne jemi mbledhur, por, është edhe meritë e padiskutueshme e autorit të librit, personalitetit të kulturës dibrane dhe shqiptare Xhezair Abazi.

Kemi përpara një libër të titulluar "Ezopi i Dibrës". Krye-personazhi i këtij libri kaq origjinal, është jo vetëm figurativisht "Ezopi i Dibrës", por ai është "Azizi i Dibrës", njeriu që do ta krahasoja me shumë mendje të shquara, dhe, më shumë, me veten e Tij.

Azizi kishte zërin e tij në deklamim, në bisedë dhe në poezitë e tij. Ai ishte vazhdues i denjë i traditave më të mira të artit, kompozimit, kulturës, valles dhe koreografisë dibrane, ashtu siç është vazhdues i lumit të kristaltë, përroi që vërshon i pastër e i rrëmbyeshëm nga malet e, pastaj, duke "kënduar" zë-ëmbël zbret në lugina. Ai ka gurgullimën e tij, freskinë, dallgët dhe jehonat e tij.

Arti që ka bërë Haziz Ndreu, ka qenë vazhdimisht i ngjashëm me freskinë e flladeve të pyjeve dibrane. Vallja dhe rapsodia e tij, kanë edhe jehonën e krismave dhe gjëmimeve për mëmëdheun, kanë krismën e daulleve, muzikës dhe ritmit dibranë, që ka tingëlluar e jehuar fort, bukur dhe ndjeshëm, që në kohërat e lashta të Iliriadës, në kohën e lavdishme të Skënderbeut, në kohërat e ekzistencës dhe mbijetesës, betejave të pandërprera për liri.



Xhezai Abazi, ka ditur ta paraqesë me shumë vërtetësi këtë njeri fjalë-bukur dhe zemër - bardhë, dhe, ne, sikur e kemi sot fare pranë, i dëgjojmë zërin rapsodik, ndjejmë tempo-ritmin e valleve dhe të deklamimeve poetike, ku shfaqen ndritshëm epitete, krahasime, metafora dhe deti i thellë i alegorisë dibrane.

Shfletojmë faqet e librit dhe na bëhet se e shohim Haziz Ndreun në skenat e Dibrës dhe të Shqipërisë, në sheshet e fshatrave dhe qyteteve, në festivalet e Gjirokastrës, në skenat e kulturës ballkanike dhe europiane e, deri me bashkëkombësit, vëllezërit tanë në kontinentin amerikan.

Xhezair Abazi e ka njohur për shumë vite nga afër njeriun, të cilit i thur me dashuri dhe respekt këtë libër, duke na treguar sesi Hazizi ka vozitur me ekuilibër dhe trimërisht, që 8 vjeç në odën e burrave, që 16 vjeç partizan dhe, më pas, duke përballuar dallgët e turbullta të kohës që kaloi.

Xhezai Abazi, ka ditur ta paraqesë me shumë vërtetësi këtë njeri fjalë-bukur dhe zemër - bardhë, dhe, ne, sikur e kemi sot fare pranë, i dëgjojmë zërin rapsodik, ndjejmë tempo-ritmin e valleve dhe të deklamimeve poetike, ku shfaqen ndritshëm epitete, krahasime, metafora dhe deti i thellë i alegorisë dibrane.

Fjala poetike, kënga dhe vallja ngre peshë zemra, ndez flakë atdhedashurie, transmetonë ndjenja të fuqishme dhe të ngrohta për jetën. Prandaj ato ruhen përherë si vlerat më të çmuara, në arkivin e kujtesës popullore. E, mes tyre, ndriçon edhe vepra poetike dhe artistike e Haziz Ndreut, i cili, është gjithnjë me më të mirët, gjithnjë me më të mëdhenjtë, sepse vepra e tij është e krahasueshme dhe e ngjashme vetëm me më të mirët, vetëm me më të mëdhenjtë. Ajo është krenari e Dibrës dhe e Shqipërisë.

Kam lexuar edhe libra të tjerë biografikë, por jo një të tillë, si ky që na dhuron sot Xhezair Abazi. Me libra të tillë, Shqipëria artistike, jep sinjale dhe mesazhe të një letërsie, që do ta kishin zili edhe penat e shquara.

Haziz Ndreu e ka ngritur monumentin e vetë me veprimtarinë e tij krijuese, tërësisht origjinale. Kurse, Xhezair Abazi, me këtë libër, i ka ngritur Hazis Ndreut një monument të mrekullueshëm shkrimor, dokumentar dhe artistik. Urime Xhezair Abazi!

Më vjen mirë që në libër del se Azis Ndreu ka pasur pika të fuqishme lidhjeje me vlonjatë, me komandant Vehbi Hoxhën, me artistin e shquar të skenës Myqerem Fera dhe të tjerë.

I kam njohur ata burra të urtë, mendjendritur dhe zemërmëdhenj, por, sot, më bëhet se i shoh tek nderojnë dhe respektojnë veprën që flet për vëllain e tyre, dibranin e shkëlqyer, Haziz Ndreu.

Emri i Hazizit e meriton një nderim të tillë, kurse, ne, ndihemi të privilegjuar, sepse, me veprën e Xhezair Abazit, e kemi sot atë dhe veprën e tij fare pranë, ndjejmë rrahjet e zemrave, heqim së bashku vallen dibrane, kuvendojmë e bashkëbisedojmë, kujtojmë dhe respektojmë bashkërisht veprën e Tij, e, njëherazi, edhe kolegët, kulturën dhe artin e Dibrës.

Në një shtëpi dibrane ku shkonte Hazizi, oda ishte plot. Edhe sot që kuvendojmë për Azizin, salla është plot.

Populli nuk i lë të kalojnë në heshtje figurat e tij të ndritura, ai i pasqyron ato në biseda dhe tregime gojore, në tradita dhe zakone, në këngë dhe valle, i ruan të vyera në arkivin e kujtesës së tij.

Teksa, sot, gjerdanit të artë të kulturës, folklorit dhe letërsisë shqiptare, I bashkohet edhe kjo vepër e rrallë, e shkruar mjeshtërisht dhe me zemër nga Xhezair Abazi.

"Ezopi i Dibrës" - konaku i veprave të Haziz Ndreut

Nga Prof. **GAFUR MUKA**

Sot ne jemi mbledhur në promovimin e librit "Ezopi i Dibrës"- të shkrimtarit, kritikut, estetistit dhe publiçistit Xhezair Abazi.

Qysh në fillim unë do ta quaja këtë libër konaku i veprave të Haziz Ndreut. Dhe kur ndërtohen konaqe, ju e dini qëështë zakon të hapen dyert për të pritur të afërm, shokë, miq e dashamirë. Këto të gjithë janë mysafyrët e parë që marrin pjesë në "ziafetin" e të zotit të shtëpisë. Dhe i zoti i shtëpisë përveç "bujrum, e mirëseerdhët" u thotë edhe "M'u shtofshi e ju paça me jetë!".

Haziz Ndreu ka patur shumë miq e shokë, shumë dashamirës, shumë dëgjues, shumë shikues e shumë lexues. Dhe ai i ka mirëpritur ato duke i gostitur me melodité e bukura të këngëve, me zërin e bilbilit të bjeshkëve, me flladin e këndshëm të valleve, me vargjet gurgullues të vjershave, me inteligjencën e hollë të alegorisë, me të vërtetat e palëkundura të historisë. Haziz Ndreu ishte i kudondodhur jo vetëm në gjeografinë e peisazhit por edhe në gjeografinë e krijimit.

Dhe Xhezair Abazit për të krijuar "Ezopin e Dibrës", përveçse ta ritakonte Haziz Ndreun në të gjitha mjediset ku kishin qenë bashkë (libri dëshmon se ato kanë qenë të shumta) i është dashur të ecëedhe nëpër "rrugët" ku kishte ecur Hazizi në shoqërinë familjarëve, bashkfshatarëve, bashkëpuntorëve e kolegëve të tij. Njëndërmarrje e vështirë që donte edhe inat edhe takat. Dhe tani, që ne kemi në duar veprën e tij, pas një leximi të parë, nuk mund të mos themi "të lumshin duart, na e ke sjellë Hazizin ashtu siç e kemi njohur ne dhe ashtu si e donim ne".

Unë kam patur fatin ta ndjek Xhezairin nërrugëtimin krijues të tij. E kam parë edhe entuziast edhe pesimist, edhe plot energji edhe disi të lodhur, edhe rendimentplotë edhe rendimentulët, edhe shend e verë edhe të mërzitur edhe fytyrëqeshur edhe të përlotur- por gjithnjë më ka pëlqyer "inati" i tij për të bërë një vepër të denjë për Hazizin. Një moderator i një emisioni televiziv e pyeti Xhezairin: Pse Ezopi i Dibrës dhe jo psh Moxarti i Dibrës... Në të vërtetë Hazizi është edhe Moxart por, i gjithë talenti i tij ka rrezatuar më së pari risi dhe mençuri. Qoftë t'i dëgjoje melodinë e këngës, qoftë tekstin e saj, qoftë t'i shikoje lëvizjet në valle,qoftë t'i modelojë vektorët e këtyre lëvizjeve, qoftë t'i lexoje krijimet e tij poetike, qoftë t'i dëgjoje recitimet e tij, qoftë t'i bluaje thënjet e tij alegorike "llaf nën mutaf", qoftë t'i mësoje të vërtetat e tij historike ishte e pamundur t'i shpëtoje edhe meditimit për to. Kudo në gjeografinë e krijimit të tij përfundon tek vlerësimi "sa hollë i ka "bluar", sa bukur i ka bërë".

Në gjithë krijimtarinë e tij Haziz Ndreu ishte vetvetja. "**Nëntë Malet e Dibrës nuk kanë lindur asgjë më të veçantë, më të ndritur dhe më të trazuar se shpirti i madh krijues i Haziz Ndreut.**Për mendimin tim Haziz Ndreu është një **ens a se**(produkt i vetvetes)- shkruan në librin e tij Xh.Abazi.

Vërtet,është e kotë të rrekesh të gjesh një zë si të Hazizit në këngë, mjeshtri si të Hazizit në krijimin dhe përpunimin e melodisë popullore dibrane, duar si të Hazizit në telat e çiftelisë, këmbë e mimikë si të Hazizit në valle, aktrim si të Hazizit në recitim, finesë si të Hazizit në mbledhjen e alegorisë dibrane, përkushtim si të Hazizit në paraqitjen e historisë... Dhe gjithkund risi e mençuri si...Ezopi.

Në libër, këtë na u thonë jo vetëm me plot gojën por edhe me emocion akademiku Vaso Tole, kompozitori i talentuar, nxënësi dhe kolegu i Hazizit Edmond Zhulali, koreografët e shquar Profesorët Skënder Selimi e Ramazan Bogdani, valltari ikonë i Ansamblit të Këngëve e Valleve Popullore, mjeshtri i madh Besim Zekthi, historiani emërmadh dhe miku i Dibrës akademiku Kristo Frashëri, poeti, krijuesi dhe studiuesi Moikom Zeqo. Të gjithë këta vendosin në libër gurë të palëvizshëm vlerësimi.

Autori ka mbartur me merak e finesë në libër edhe kujtime të vyera të bashkëkohësve , bashkëpuntorëve dhe personaliteteve të shquara të letërsisë, artit e kulturës sonë si Dritëro Agolli, Drago Siliqi, Kolë Jakova , Kujtim Spahivoglietj të cilët kanë shijuar dhe vlerësuar talentin e shumanshëm të Haziz Ndreut.

Në mbyllje dua të them se më vjen keq për një gjë: Pse nuk e kam shkruar unë librin "Ezopi i Dibrës". Pse nuk më kapi mua xhanëm inati t'i hyja kësaj pune...Me siguri punë takati... Por ama unë jam fatlum, ashtu si të gjithë ju, që jam lexuesi i kësaj vepre, e cila jep mundësinëjo vetëm për të njohur por edhe për të shijuar e vlerësuar në plotërinë e saj krijimtarinë e Moxartit..., më falni... Ezopit të Dibrës-Haziz Ndreut.

Rruga e Arbërit nr. 92

pamflet

Dhe ia mori përsipër t'i bënte një këngë të bukur Soses soliste. Shkoi në shtëpi dhe me vrap ngrehu magnetofonin, vuri në punë kompjuterin, kaloi disa melodi dhe u ndal te kënga

Kunji, Huri dhe solistja Sose

Nga **NAIM PLAKU**

1

Në të vërtetë Kunji, Huri dhe Sosja i kishin emrat e tyre ndryshe, por dibranët e kanë si qejf t'i shkurtojnë. Ata, siç i njeh dhe bota, të shkurtojnë gjuhën e jo më emrin. Kështu emrat e tyre të vërtetë ishin Aikunji, Kihuri dhe Përsose. Por meqë të shkurtuar tingëllonin diçka më mirë dhe ishin më praktik në ligjërim, ato sot e asaj dite, që kur lindën, na i quajtën kështu dhe kështu u njohën e i njohim edhe ne. Kunji dhe Huri (apo Hunji) bënin e bëjnë këngë, pra janë nerëz të muzikës, të ahengut apo të qejfit. Janë, siç u thoshin dikur, rapsodë, apo siç u thërrasin sot kantautorë, sepse gatuajnë edhe vargje, pjekin melodi e servirin këngë e thartojnë qejfe.

Ndërsa Përsosja apo Sosja këndon, është soliste nga ata që kanë braktisur skenat e festivalet dhe janë ngjitur në sheshet e dasmave. Sosja është soliste e përsosur. Erdhi puna që u lidhën ngushtë me Kunjin dhe Hurin, në një grup orkestral. Si të thuash, ata bashkëpunonin ngushtë, prodhonin dhe ushqenin me këngë, nga ato këngët e bukura popullore me jaran e me ashik, grupin dhe grupet, që të linin gojëhapur. Kunji dhe Huri edhe këndojnë nganjëherë duke e vënë Sosen në mes apo duke bërë duete me të plot gjeste dashurie. Edhe i bijen ndonjë vegle muzikore, si tarabukut, dajres, etj.

Ah, kjo gurra popullore sa e bollshme dhe e pastra paska qenë! Paçka se dikush i merr nëpër gojë e kanë shpifur plot thashetheme se gjoja krijuesi Kunj u ka futur kunjin mjaft këngëve popullore e krijuesi tjetër, Huri, i paska hy në hu folklorit tonë të bukur e të pasur. Punë e madhe! Se mos janë si njerëzit ata që të ndjejnë dhimbje, kur u hyn në hu dhe të qajnë e të bërtasin kur u hyn kunji apo kur i përlan në dajak ai tjetri, huri! Dhe Sosja e bukur këndon e këndon:

Sa e mira për së gjati,
Këmbët nuk ti nxe krevati...

... dhe në duet me Kunjin kur ai i thërret dhjetë herë:

Jepma, jepma!

Ose:
Eja pak, eja pak,
Eja pak ta zhvesh fustanin
Ta shoh pak ku e ke nishanin.

2

Kjo janë këngë me vargje e melodi të Kunjit që Sosja i këndon në dasma. Ndërsa Huri ka shkuar pak më larg e është ngjitur pak më lart. Ai zgjedh fabula interesante për këngët e veta dhe synon të jenë sa më lakuriq. Ja, krijoi dhe këngën më të re. Ka zgjedhur një fabul interesante. Subjekti vendoset në një krevat me shtroje e mbuloje mëndafshi plot parfume, që mban brenda një femër të tradhtuar, me gjunj e gjinj të bardhë e me silon brenda, që kërcejnë e hidhen aman, aman, që, ashtu si shumë këngë të repertorit të tij, janë përfshirë në disqet e Soses. Por bukuroshja e Hurit nuk është aq e gjatë sa, kur shtrihet në krevat, t'i mbeten këmbët jashtë, ndaj disa edhe qeshin. Që të korrigjojë këtë sakatllëk të Kunjit, Huri, kohët e fundit, ka zgjedhur e provuar personazhe të kolme e topolake, të rrumbullta si kumbull, të holla si bollë, të kuqe si mollë, të bardha, apo lara- lara si sorrë, etj, etj. Nis konflikti i fabulës. Bukuroshja na ishte tradhtare! Në një duet me Kunjin ky i afrohet Soses dhe i puth syrin, kur e thotë teksti, ama **"jepma, jepma syrin"** dhjetë herë. Kur i thotë **"jepma faqen"** , e puth në faqe. Më poshtë s'ka ku të shkojë. Këtu fillon zgjidhja. Kunji i afrohet Soses, ajo perendon sytë, i fsheh gjoksin dhe i jep një të shtyrë Kunjit duke i thënë fjalët skenike **"...më mashtrove", "më tradhtove, ik, o ik"!** Ndërsa Kunji, si më njerëzor, shprehet në tekst se ajo na kishte një jaran, prandaj i ikte natën nga krevati dhe mbetej vetëm si hu gardhi, brenda katër mureve të shtëpisë, brenda dhomës së kurorës, me shtrat e jatak mëndafshi bosh, pa femër:

Shoqet plasën nga inati, shpirt,
o more xhan,
Pse më ikën nga krevati,
moj aman, aman?
Më kanë thënë se ke jaran,
moj aman, aman...

Dhe Sosja e qan këtë këngë. Bile e këndojnë shpesh të tre. Duke u dehur nga suksesi porositi te Huri një këngë nga ata më nudo, pra më lakuriq për të ndezur jaranët e rinj. Huri tashmë ka fituar përvojë, se, në këto situata të ndihmon edhe teknika moderne, mjetet, informatika, etj., që po të jesh pak i zgjuar i mbush me plot nuanca ose xhingrra – mingrra, siç u themi ne që s'kemi haber fare nga kënga. Por dhe Kunji nuk mbetet pas. Për publikun tonë, thotë, se mbështetet fort në tabanin e virgjër të fqinjëve, në taban popullor, në melodi me motive turke, sllave a greke. Se aty – aty janë alla turçe, hop sllave e bullgare e alla arnautçe. Ja ç'bën mjeshtri. Merr një disk, përcakton këngën dhe e rregjistron melodinë nga ana e prapme, pra e përmbys dhe del një biçim melodie lakuriq. Pastaj gatuan tekstin, një tekst që të jetë sa më i shkurtër për Sosen që të mos lodhet duke e mësuar përmendësh. Këtë gjë bën dhe Kunji në anën tjetër. Ndodh që ai, atë që përmbys Huri, e kthen prap përmbys dhe Kunji, kështu, dalin të dy në një liman. Të dy i bijen një legeni, por secili e ruan të fshehtën e këtij zbulimi, se, siç thonë kritikët, ka ndodhur që dhe dy shkencëtarë kanë bërë të njejtin zbulim njëherësh. Dhe zbulimi duhet mbajtur sekret se, mezallah, ta përvetësojnë të tjerët e të zhvatin fitimet, se këtu te ne, s'ka ligj që mbron autorët. Në të vërtetë me këtë lloj marifeti janë mbajtur e kanë fituar para. Sosja gjithmonë besonte te origjinaliteti i tyre. Një këngë ia ujdis Kunji e tjetrën Huri. Këtë rradhë i ra më qafë Hurit:

3

– Të më bëjsh një këngë të mirë, më të mirë se atë këngën që ma ujdisi Kunji rradhën tjetër dhe filloi t'i këndonte vargjet e para:

Ashik, ashik, o ashiku i jem,
Afrou pak ta bëj nji vend, o ashiku jem!

– Mos ki gajle! – i tha Huri.- Por mos u mburr me Kunjin se ai vjedh. Vjedh, moj Sose, vjedh këngë turke. Këngë të bëj unë, që të përshtaten vetëm ty. Prandaj mos ndërro kunjat.

– Kështu më flet dhe Kunji për ty, - foli Sosja. – thotë se i ke hyrë ne hu këngës së bukur dibrane.

– Konkurencë, Sose, konkurencë...

Dhe ia mori përsipër t'i bënte një këngë të bukur Soses soliste. Shkoi në shtëpi dhe me vrap ngrehu magnetofonin, vuri në punë kompjuterin, kaloi disa melodi dhe u ndal te kënga

"Ulluk, bulluk, o usta Murat,
Herë me bukë e herë pa bukë,
o usta Murat".

E ktheu diskun, që ta niste melodinë nga fundi për të dalë në krye, nga nota e fundit për të dalë tek e para. Vuri veshin dhe u habit. Dilte ajo kënga e Soses, që i kishte kompozuar Kunji.

– Kodoshi,- mërmëriti Huri, - këtu e paska vjedhur atë këngën e Soses, që këndon dasëm më dasëm. Hë, moj Sose! Ja ku ta gjeta! Sose, Sose, t'u sosshin varrat! Mbete pa këngë... – gjëmonte me vete. E vinte mbarë diskun, dilte " **Ulluk, bulluk**...", e kthente prapa dilte **"Ashik, ashik-u"** i Kunjit. Dha e mori, dy javë, por nuk gjeti asgjë që të mos gjasonte me ata të Kunjit. Ah, Kunj, mor Kunj, sa dobiç paske qenë"!

Sosja e pa që Huri nuk bëri gjë dhe prap shkoi te Kunji.

– Më bëj një këngë ti, se..

Deshi t'i thoshte se Huri kishte dështuar, por mendoj se këto gjëra janë sekrete profesionale. Që ta ndihmonte ca Kunjin, Sosja shkoi dhe bleu një disk me këngë greke.

– Dëgjoj një herë këto, se do ndoshta të vjen frymëzimi. Kështu i dua unë, të ngjajshme, por jo si këto.

E mori diskun Kunji dhe shkoi të frymëzohej duke i marrë një për një këngët e duke i përmbysur për të arritur te melodia origjinale që duhej për suksesin e Soses.

– Hajde, hu, hajde! Na paske marrë më qafë. Ma paske vjedhur sekretin, o Hu!

Kur i përmbyste Kunji, dilnin kompozimet e Hurit, që përbënin repertorin e së famshmes Sose. Kur i përmbyste Huri, dilnin këngët e Kunjit. Fut kunj e nxir hunj u bë kjo punë. Erdhi një ditë që këto marifete i ranë në vesh Soses. E mori diskun, që kishte promovuar kohët e fundit dhe e futi në aparat. I përmbyste, dilnin këngë turke e greke. I kthente në anën tjetër dilte Sosja me Kunjin dhe Hurin e saj.

– Kam paguar një dynja me pare. – u lemeris Sosja.- I hëngërshin për mort! E bëri diskun copë – copë dhe nuk e di në se do të kthehet te kënga e bukur dhe e pastër e gurrës sonë popullore, apo do të merret prap me Kunjin dhe Hurin.

Unë nuk e kam parë qëkur as në skenë e as në dasma.

Tiranë, dhjetor 2013

Fusha e Korabit, mrekullitë dhe misteret e saj

(Vijon nga faqja 10)

Rruga e këtyre tufave që shkonte deri në një million krerë kalonte nga Dibra e Madhe, në urat dhe pranë lumejve të saj, Drinit të Zi dhe Radikës. Po kësaj rrugë nusja pret t'I kthehet i shoqi. Ajo ka një frikë që e shpreh, se kur vajzat ose gratë shkina do t'u lajnë rrobat, rregzinat, mos vallë ato ua vënë syrin edhe burrave të tyre, që kur i shohiin me tufa të mëdha kujtojnë se janë të pasur e martohen me dëshirë e qejf të madh me ta. Apo u rrëbejnë ndonjë dele dhe shkojnë një natë në shtrat me ta. Bredh kështu mendja e njeriut, veçanërisht, kur njeriun që do nuk e ke afër. Sa e sa herë mëndon për të. Mos është kjo vallë vetëm xhalozi gruaje?! Ky ishte një merak që s'e linte rehat. Madje edhe nëse vonohen një dy apo tre ditë në kthim, ajo bëhet edhe më merak dhe I thotë që të shkreh një pushkë e ta lajmëroj se po vjen: dixhe ni fishek.

Vargjet e mëposhtme dhe fjalori shoqërues, e japin më të plotë dramën:

Shkuen gjemt e ri, o njera un-o
Lan orgjaçet n'zi
Shkuen posaj shkuen,
Shkinat do t'i duen,
Do t'I duen shkinat
Si t'u lajnë rregzinat.

Si t'ishte sebepi, o njera un-o
T'më mirrshe me vete
Si t'vajsha me taj
Rregzinat t'I laja
Bukën të gjatuja,
Koliben ta ruja.

Shajivi sip o bie, o njera un-o
ferexhe a kie,
ferexhja ba kllajë
fugje me nji dllajë
Ferexhja ba çullë,
Fugje me nji gjurë,
ferexhja e shkurtë
a t'mërdhojfin gjujtë,
ferexhja e vjetër
T'baj dada nji qetër.
Po na çelën shpenra, o njera un-o
nuk na hihet mrena,
banja si t'ja bajsh
Për shënxherxh të vajsh,
Me dhen e me shqerra,
Të na gëzoet zemra
Kur dalish n'atë kep, o njera un-o
Dixhe ni fishek,
Te ura e Radikës,
Duel ylli I dritës
Te ura e Izvairit
Topi I tranafajlit
Si na erdh shënxhexhi
Erdh i miri e i keçi

4. NJË PËRFUNDIM PA MBYLLJE

Kënga nuk është e re, madje me bindje mund të thuhet se është shumë e hershme, sepse edhe vetë shtegëtimi ka qenë i hershëm. Këtu bashkoheshin e gjenin njeri-tjetrin, shpirti artist i dibranit me krenarinë kombëtare, sikurse ishte edhe mali më i lartë në Shqipëri, Korabit. Në tre - katër dekadat e fundit, ajo këngë është e pasuruar nga duart të kujdesshme. Kur isha I ri dhe kam pasur gjyshen gjallë, sa herë flitej për ish skuadrat sportive (futbolli, volejbolli i femrave, mundja etj) që mbanin emrin "Korabi" e pyesja atë në se kishte pasur rast ta shihte malin. Ajo më thosh: Malin e Kurupit? Në strukturën e kësaj fjale, sigurisht kanë ndodhur ndryshime gjuhësore në pikpamja fonetike e mbase dikur ai mal është thirrur Mali i Kurupit.

E frymëzuar nga kjo këngë, ka rreth dy dekada që këndohet edhe një këngë tjetër, me të njëjtin titull:"Fusha e Korabit". Është një këngë e suksesshme, sepse jo vetëm nga dibranët, ajo dëgjohet e shijohet mrekullisht, por edhe nga shqiptarët e krahinave të tjera. Nuk mund ta dëgjosh atë këngë pa të kaluar mornica në trup dhe të mos ndjesh një krenari në shpirt. Mbase është vështirë të kuptohet se këtë sukses, kjo këngë e ka si meritë të tekstit poetik apo si meritë e zërit melodioz që e përcjellë atë. Sigurisht që të dyja, pasi ky tekst poetik mund të shpalosej vetëm me një muzikë e zë, ku ka emocione dhe dashuri sintezë për foklorin, për traditat. Ja edhe teksti tjetër:

Shkove u harrove, o njera un-o/ Një letër s'e çove, o njera un-o, / Një letër një kartë, o njera un-o, /Ta mbaj dada n'arkë, o njera un-o/.

Prap na çeli Grama, o njera un-o,/ Ke xhurma t'pret nana, o njera un-o, / Merr pare me fajde, o njera un-o/. Mos harro e hajde, o njera un-o/ Merr udhën e hajde, o njera un-o.

Nëse do të kisha mundësi t'i kthehesha edhe një herë kësaj perle, shpresoj se vlera të reja do të gjeja në të.

PAK FJALOR:
çilimit – qilimit
dadë- thirret motra e madhe, kur ka edhe motra e vëllezër më të vegjël
dixhe – diqe, harxhoje
dllajë – dëllinjë
gjurë – gur
grajta – ngrita
I keçi – i keqi
Izvairit – urë në Dibër të Madhe
kraua – krua (nga: kroi)
mërdhojfshin – kanë të ftohtë, mërdhijnë,
o njera un-o – o e mjera unë (përsëritet pas çdo vargu)
pashterkë - lloj përparëseje, punuar në vegjë me kuadrate
për shënxherxh të vajsh – për shëngjergj të vish
qasa tu ka – plasa duke qarë
Radika – lumë në Dibër të Madhe
ruja - ruaja
sajt - sytë
shajvi sip o bie – shiu që po bie
shtraue - shtruar (rrobat për fjetje)
tëj – ti (përemri vetor i vetës së dytë njëjës)
thkeve – ktheve
xheç – gjeta
xhurma – gjurma

portret

"Është kënaqësi e madhe të ndihmosh njerëzit. Falë Zotit që Amerika na ka dhënë mundësi të punojmë e të kemi sukses kështu që kemi mundësi edhe të ndihmojmë"

Ylber Pilku - bujar e aktivist i njohur në Amerikë

Nga **VEHBI BAJRAMI**

Shqiptarët e ardhur në Amerikë nga trojet shqiptare në Ballkan jetojnë në mes dy botërave: në mes të vendlindjes dhe vendit ku jetojnë. Po të mos ishin mërgimtarët shqiptarë në Amerikë e vende të tjera të botës, jeta e shumë shqiptarëve në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Malësi e Preshevë do të ishte tepër e vështirë për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike. Shuma njëvjetore e ndihmave të mërgimtarëve për të afërmit e tyre në vendlindje është qindra miliona dollarë.

Kësaj here do t'u prezantojmë njërin prej atyre bashkatdhetarëve që jo vetëm ndihmon ata që kanë nevojë në vendlindje, por për dy dekada është i angazhuar edhe në aktivitete kombëtare në komunitet, Ylber Pilkun nga Dibra e Madhe, i cili jeton në New York që nga viti 1988. Edhe ai si shumë të tjerë, jetën e ndan midis vendlindjes dhe Amerikës. Por ajo që e dallon nga shumë të tjerë janë ndihmat e mëdha që ka dhënë për vendlindjen dhe aktivitetin e zhvilluar në mërgim.

Një portret të shkurtër të Ylber Pilkut dhe familjes së tij e ka dhënë edhe gazetari Fatos Daci.

"Pilkët janë një fis i nderuar e i respektuar në Dibër e jashtë saj për veprimtari atdhetare e patriotike. Këtë veprimtari patriotike, të parët, e nisën gjashtë vëllezërit: Mehmet, Mahmut, Sadik, Ramiz, Nazif dhe Sali Pilku, të cilët ishin delegatë në Kongresin e Manastirit, në atë kongres që vendosi fatet e mëtejshme të gjuhës sonë të bukur e të ëmbël shqipe. Një fotografi të tyre, të atyre viteve, por të zmadhuar, Ylberi e mban në një vend të dukshëm në zyrën e tij, ashtu si ka vënë në një kornizë të bukur edhe fotografinë e babait, Jasharit, e të nënës së tij. Jashari është rritur jetim, sepse babai i tij i vdiq kur ai ishte vetëm 5 vjeç. Edhe babai i tij qe një zogist i vendosur.

Si i tillë, ai, për shumë vite punoi në radhët e xhandarmërisë shqiptare dhe kontribuoi për vendosjen e rendit e të qetësisë në ato vite të hershme. Ndërsa, në kohën e Italisë, Jashari ka qenë magazinier në magazinat qendrore në Tiranë. Këtë mundësi ai e shfrytëzoi për të furnizuar qytetin e tij, Shehrin, dhe Dibrën, pa kursim e me çfarë i nevojitej. Edhe të pesë vëllezërit e Ylberit: Fatmiri, Besniku, Xhaferi, Asllani dhe Fitimi janë njerëz që nderohen e respektohen", shkruan ai.

Ylber Pilku, një biznesmen i njohur në komunitetin tonë, themeloi kompaninë e tij të ndërtimeve në vitin 1991. Që nga viti 2000 kompania e tij, sot me emrin "Pilku Construction Services Inc.", e specializuar për skelat e të gjitha madhësive, dhe për të gjitha lartësitë, (i pari shqiptar në këtë lloj biznesi në Amerikë) bën punë në shtetet New York, New Jersey dhe Connecticut por edhe në shtetet Georgia, Rhode Island etj..

Ka disa vite që kompaninë e drejton djali i Ylberit, Valoni.

"Unë dhe bashkëshortja Vjollca i ndihmojmë Valonit po ai i ka përgjegjësitë më të mëdha në drejtimin e kompanisë", thotë z. Pilku.

Si ka ecur biznesi i kompanisë gjatë këtyre viteve?

"Biznesi gjithmonë ka ecur mirë. Për një kohë të gjatë kam marrëdhënie të vazhdueshme



Ylber dhe Vjollca Pilku



.Ylber Pilku me djemtë Valonin dhe Atdheun.

me klientët. Ka ndodhur që në një punë kam humbur para, por klientit nuk ia kam kthyer shpinën. Kam respektuar marrëveshjen. Në çdo biznes duhesh të jesh i drejtë e i sinqertë me klientin dhe ta bësh punën siç e kërkon ai", thotë z. Pilku.

Për llojin e punës që bën, sipas tij, kompania sot është më e madhja në Brooklyn dhe e treta në New York.

Po konkurenca, si ndikon ajo në biznesin e tij?

"Konkurenca është e mirë. Ata që mendojnë ndryshe gabojnë. Më i miri gjithmonë ka punë, pa marrë parasysh konkurrencën", thotë z. Pilku dhe shton se në mesin e klientëve të tij kanë qenë edhe Donald Trump, Chetrit Group., Helmsley Spear, John Katsimatidis, etj.

Ylber Pilku gjatë gjithë kohës sa jeton në Amerikë ka qenë aktiv në komunitet. Që nga demonstratat për lirinë e Kosovës deri te mbrëmjet që janë organizuar për ta ndihmuar atë materialisht në kohën kur ajo kishte më së shumti nevojë: ndihmë për luftëtarët e lirisë në Kosovë, Maqedoni e Preshevë, ndihmë për të mbështetur legjislatorët që ishin bërë avokatë të çështjes së Kosovës në Kongres, ndihmë për të varfërit si në Kosovë ashtu edhe në Maqedoni e Shqipëri, ndihmë për të shëruar ata që nuk kishin para për të paguar shpenzimet e mjekëve, ndihmë për studentët, ndihmë për botime librash e televizone, ndihmë për xhami e kisha, ndihmë për lirimin e Ramush Haradinajt e Fatmir Limajt nga Gjyqi i Hagës, ndihmë edhe për të përcjellë arkivole nga Amerika etj.



Nga e majta: Harry Bajraktari, kongresisti Eliot Engel, Ylber Pilku dhe anëtari i Këshillit të Bashkisë së New York-ut, James Vacca.

Akoma pa mbushur një vit në Amerikë atij i kujtohet se dërgoi 500 dollarë për të ndihmuar spitalin e Dibrës.

"Është kënaqësi e madhe të ndihmosh njerëzit. Falë Zotit që Amerika na ka dhënë mundësi të punojmë e të kemi sukses kështu që kemi mundësi edhe të ndihmojmë", thotë z. Pilku, i cili këtë vit vizitoi vendlindjen me qëllim për të ndihmuar konferencën kushtuar 100 - vjetorit të Kryengritjes së Dibrës, e quajtur

Ylber Pilku është nga Dibra e Madhe dhe jeton në New York që nga viti 1988. Edhe ai si shumë të tjerë, jetën e ndan midis vendlindjes dhe Amerikës. Por ajo që e dallon nga shumë të tjerë janë ndihmat e mëdha që ka dhënë për vendlindjen dhe aktivitetin e zhvilluar në mërgim.

ndryshe si "Kryengritja Dibrane 1913" e cila u mbajt në Dibër e Tiranë ku z. Pilku ishte sponsorizuesi kryesor i saj, përfshirë edhe mbrëmjen përmbyllëse në Tiranë ku morën pjesë rreth 300 vetë. Ai hoqi edhe shpenzimet e transportit nga Dibra në Tiranë dhe anasjelltas për pjesëmarrësit e konferencës

Kryengritja e vitit 1913 nga historianët konsiderohet si lufta e parë e shqiptarëve kundër pushtuesve serbë për të mbrojtur territoret që mbetën jashtë Shqipërisë pas shpalljes së Pavarësisë më 1912 dhe pas konferencave ndërkombëtare, e sidomos pas vendimeve të Konferencës së njohur të Londrës, që rezultoi me copëtimin e trojeve shqiptare dhe aneksimin e pushtimin nga ushtria serbe.

Për dy vjet me radhë Ylber Pilku hoqi shpenzimet e mbrëmjeve që u organizuan në Dibër për 7 Marsin - Ditën e Mësuesit ku morën pjesë qindra bashkatdhetarë.

Ylber Pilku sponsorizoi edhe ngritjen e bustit të Iljaz Pashë Dibrës që u vendos në Peshkopi si dhe harxhimet e ceremonisë përuruese. Dëshira e tij ishte që kjo përmendore të vendosej edhe në Dibër, por siç thotë ai, kryetari i komunës nuk e lejoi.

Edhe gjatë luftës në Maqedoni, si gjatë luftës në Kosovë e Preshevë, z. Pilku qe aktiv në komunitet. Përveç shumave të mëdha materiale ai sponsorizoi një program të radios në New York për të informuar bashkatdhetarët me gjendjen në vendlindje. Vetë e dha idenë dhe vetë pagoi të gjitha harxhimet duke ua lënë në besim gazetarëve drejtimin e programit.


"Vetëm në një rast ndërhyra në program. Ata që drejtonin programin donin ta quanin Gëzim Ostrenin tradhëtar. U thashë se kjo nuk lejohet", tregon z. Pilku.

Ky është një portret i shkurtë i Ylber Pilkut, të cilin e prezantojmë në këtë numër të 28 Nëntorit edhe për faktin se për disa vite me radhë ka ndihmuar në ngritjen e flamurit shqiptar në Manhattan.

Marrë nga gazeta "Illyria"

> Ylber Pilku është nga Dibra e Madhe dhe jeton në New York që nga viti 1988. Edhe ai si shumë të tjerë, jetën e ndan midis vendlindjes dhe Amerikës. Por ajo që e dallon nga shumë të tjerë janë ndihmat e mëdha që ka dhënë për vendlindjen dhe aktivitetin e zhvilluar në mërgim.

Disa nga mirënjohjet për Ylber dhe Vjollca Pilkun.







Rruga e Arbërit nr. 92

Haxhi Maqellara: "Jam një njeri i lumtur, sepse këndojë atë që e dua - këngën me taban dhe të pastër popullore shqiptare "

intervistë

Një jetë e tërë me këngën popullore shqiptare!

Nga **BEQIR SINA**

Haxhi Maqellara, është këngëtari dibran në Shetet e Bashkuara të Amerikës, që ka kënduar më shumë se 40 vjet - vetëm këngën folklorike dhe popullore atë që si thotë ai të pastër dhe me taban shqiptare. Haxhiu, është këngëtari që ka marrë deri tani, dhjetëra çmime dhe mirënjohje nga Kosova, Dibra e Madhe, Peshkopia, Tirana dhe shqiptarët e Amerikës.

Haxhi Maqellara, pak kohë më parë u kthye nga vendlindja, ku vizita kësaj rradhe thotë ai ishte e ngrakuar me emocione të papërshkruara. Mbasi, nuk ishte thjesht ç'mallja me Dibrën dhe Tiranën, shprehet ai, por edhe supriza që më bën Tirana dhe dibranët" .

"Natyrishtë, këtë nuk mundet t'a "fshefi" nisi të rrefehet për gazetën tonë në një mbasdite në shtëpinë e tij në Staten Island ishullin e "dibranëve në Nju Jork duke shtuar se :"Muajin e kaluar përjetova kënaqësinë më të madhe në karrijerën time artistike 40 vjeçare, si këngëtar dhe si kompozitor. Para disa muajve ishte Bashkia e Tiranës me kryetar zotin Lulëzim Basha me miratimin unanim të Keshillit te Bashkise duke që më akordoi titullin "Mirënjohje e qytetit të Tiranës", dhe me propozimin të Shoqatës "Tirana", dhe kryetarit të saj zotit Arben Tafaj, të cilin e faleminderoi jashtë mase.

Se kisha pritur kurrë tregon Maqellara, që urimet të "rridhnin lumë', të më vinin nga të gjitha anët, prej nga Tirana, Kosova, Peshkopia, Dibra e Madhe dhe diaspora - shqiptaro amerikane, bashkëkombasit e mi këtu në Amerikë, "Gëzimi, ishte tepër i madh dhe i papërceptuar, thotë ai sepse, ky titull më vinte në vigjilje e 60 vjetorit të lindjes dhe të 40 vjetorit të aktivtetit tim artistik."

Kështuqë, mezi prisja të shkoja në Tiranë dhe të merrja titullin e madh - në atë Tiranë zëmer madhe bujare dhe fisnike, e cila para 100 vjetëve na hapi dyert ne dibranëve muhaxhirë, të cilët ikën dhe lanë shtëpitë e tyre, si rezultat i spastrimit të paparë dhe barab sllavo - serb, thotë bilbili i këngës Dibrane, Haxhi Maqellara, i emocionuar.

Tirana kryeqyteti ynë nderoi kështu Haxhi Maqellarën në 40 vjetorin e ngjitjes në skenë, duke organizuar edhe një mbrëmje Gala në restorant "Berluskoni" në Tiranë, ku morën pjesë artistë të elitës nga Tirana, Dibra e Madhe, Peshkopia, Kosova dhe Diaspora, shqiptarët e Amerikës Shoqata Atdhetare Dibra, kryetari Musa Paçuku. Organizimi ishte i jashtëzakonëshëm pohon ai. Mbasi dy artistë të dalluar, Behar Mera dhe Veli Rada i dhanë sharm spektaklit ndërsa Mjeshtri i madh i skenës Bujar Kapexhiu ishte udhëheqësi i kësaj mbrëmje.

Kënga - hymn "Faleminderit moj Tiranë" e ka marrë subjektin e tekstit të saj nga një eksod tragjik brenda kufijve të Shqipërisë Etnike.

Haxhiu risjell kujtimet e tij më tej, duke treguar se: "Në odat Dibrane, gjithmonë është folur për mikëpritjen e zemërbardhësinë e Tiranës, për bujarinë dhe fisnikërinë, që tironasit, treguan gjatë ikjes së dibranëve në eksodin tragjik të viti 1913, kur u kryen masakrat serbe mbi popullsinë e pambrojtur shqiptare. Dibranët, tregon ai gjetën strehë në Tiranë, dhe kjo kurr nuk është harruar sidomos nga dibranët kudo që janë.

Ai rrefen se si i dëgjonte këto biseda nga goja e më të moshuarave nëpër oda në raste dasmash a mortesh, dhe gjithmonë e kishte mëndjen të bënte një këngë për atë pritjen bujare. Dhe momenti erdhi, thot ai, kur autori i njohur i teksteve të këngëve, Jorgo Papingji dhe kompozitori Edi Balili, krijuan këngën prekës dhe kuptimplote "Faleminderit moj Tiranë".



Haxhi Maqellarës

Në vitin 1988, vetë Haxhi Maqellara e la Dibrën, që e deshte aq shumë, dhe i kishte dhënë aq shumë, me kolegët e tij me artin e tij të bukur dhe mori rrugën e mërgimit për tu vendosur "përjetësisht" në vendin kampion të lirisë dhe demokracisë në botë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, vendin e ëndrrave të të gjithë njerëzimit dhe të artistëve të botës.

Ai u kthye nga SHBA, në vendlindje mbasi kishte kënduar gjatë viti 1987 për rreth 8 muaj. Atëhere, vendlindja e tij ishte nën sundimin e Beogradit në të ashtuquajturën "Jugosllavi". Në vitin 1988 - Haxhiu, mori rrugën e mërgimit , mbasi kushtet në vëndlindje ishin ashpërsuar ; kultura dhe arsimi kalonin çaste tepër të vështira, ishte koha kur represioni serb po arrinte kulmin. Ishte koha kur Kosova me lëvizjet e saj mbar popullore, kishte nisur e para rrugën e shpërbërjes së "Jugosllavisë'' që nuk egzistonë më mbsa shkërrmoqjes së saj.

Në atë kohë edhe pse i ofruan prap një vend në skenë, Haxhi Maqellara, nuk pranoi duke u solidarizuar me popullin e vet. Si mund të këndonte ai në mort? Kur qelitë ishin mbushur plot, me shqiptarë të pafajshëm dhe askush nuk e ndjnte veten të lirë. Nuk këndoi, por ndërkohë që emri i tij ishte gjendur në listën e zezë të 215 intelektulave, që policia sekrete serbe, po merrte masat për t'i burgosur ata si shkatarë të trazirave të asaj kohe kundër rregjimit të Beogradit.

...Haxhi Maqellara është këngëtari dhe kompozitori që u ka kushtuar këngë simboleve kombëtare dhe heroinave shqiptare. Ai është i pari kompozitor shqiptar, që i ka kushtuar këngë bijës shqiptare Nëna Terezes, nobelistes shqiptare , bamirses së madhe. Por, këngët e tij gjithmon evokojnë patriotizëm dhe atdhedashuri nëpërmjet notave të shpirtit të këngëtarit. Ai i këndoi Ganimete Terbeshit, Ibe Plaikuqit, Shote Galicës, Kosovës, Dibrës dhe Tiranës, i këndoi plagës së pashërueshme kurbetit, por edhe nënës shqiptare.

Ky ishte momenti që ai e la vendlindjen dhe erdhi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Nju Jork , ishullin e "dibranëvë" Staten Island - për të bërë realitet ëndrrat e tij.

Në shtëpinë e tij në ishullin e "dibranëve" Staten Island, ku ai gruaja Fatbradha tre fëmijët nusja e djalit dhe nipi i tij jetojnë së bashku, i morëm këtë intervistë, mbas marrjes së çertifikatës "MIRENJOHJE DIBRANE" dhënë me rastin e 28 Nëntorit, 101 vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë nga Shoqata Atdhetare Dibra".

Mirënjohjet më të fundit të Haxhi Maqellarës

Në nëntor 2007 Shoqata Votra Dibrane në Dibër të Madhe i ka dhënë mirënjohjen këngëtarit Haxhi Maqellara si solist dhe kompozitor i këngës popullore me motivicionin: "Për kontributin e dhënë dhe që vazhdon të japë në intepretimin, kultivimin dhe afrimin e këngës popullore shqiptare - veçanërisht asaj Dibrane".

Në tetor 2008 Njësia e vetadministrimit lokal Komuna Dibër e Madhe - Kryetari i saj Agëtim Fida, nderoi zotin Haxhi Maqellara këngëtar dhe kompozitor me rastin e 35 vjetorit të aktivitetit të tij artistik dhe për merita të veçanta në promovimin e vlerave të muzikës popullore nga të gjitha trevat shqiptare, posaçërisht asaj Dibrane.

Këshilli i Bashkisë së qytetit të Peshkopisë me vendim të posaçëm mbështetur në Ligjin për organizmin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore me nismën e Komisionit të Historianëve të rrethit Dibër dhe propozimin e Zyrës A.K.R.S. pranë Bashkisë së Peshkopisë - Këshilli i Bashkisë vendosi dhënien e titullit "Nderi i Kulturës" - për këngëtarin Haxhi Maqellara me motivacionin:"Për kontributin e shquar në krijimin e interpretimin dhe ruajtjen e vlerave të këngës Dibrane, veçanërisht në Amerikë".

Shoqata Tirana këshilli drejtues i shoqatës Tirana, nderon me çmimin "Mirënjohje Tiranase" zotin Haxhi Maqellara me këtë motivacion : " Për pasqyrim nëpërmjet këngës të lidhjes historike të Dibranëve me Tiranën".

Në emër të qytetarëve të Tiranës - Kryetari i Bashkisë së Tiranës zoti Lulëzim Basha dhe kryetari i Këshillit të Bashkisë së Tiranës zoti Njazi Kosovrasti, nderuan me këtë çmim me motivacionin: "Me titullin "Mirënjohje e lartë Tiranëse" artistin e mirënjohur të folklorit shqiptar, në ruajtjen e vlerave kombëtare, integrimin kulturor të folklorit shqiptar në botë, si dhe për kultivimin e artit dhe muzikës tradicionale të qytetit të Tiranës" . Kam përvilegjin që në ëmër të qytetarëve të Tiranës t'ju ofrojë këtë titull dhe t'ju ofrojë të gjitha të drejta e patjetërsueshme që burojnë prej këtij titulli.

Me rastin e 101 Vjetorit të Pavarësisë Së Shqipërisë, Shoqata Atdhetare Dibra në Nju Jork, bashkëqytetarët e tij në Amerikë, në shenjë respekti dhe nderi i dhanë më 28 Nëntor 2013 - Çmimin "MIRENJOHJE DIBRANE", këngëtarit dibran Haxhi Maqellara me motivacionin: "Këngëtar me vlera të mëdha kombëtare, dhe artistike, i shquar edhe si veprimtarë i dalluar i çështjes kombëtare, njëri prej themeluesve të Shoqatës Atdhetare Dibra në SHBA."Bilibili i këngës Dibrane", këngëtari i njohur në Shqipëri, Kosovë e mbarë trojet shqiptare, këngëtari që ngriti peshë Kosovën dhe tokat shqiptare, më këngët e tij patriotike !"

Zoti Maqellara gjatë gjithë karjerës suaj keni marrë shumë çmime, dhe çertifikata mirënjohje, vlerësime të ndryshme, por më së fundi ju u vlerësuat edhe nga bashkëqytetarët e tu - komuniteti dibran në Amerikë. Pra, si e vlerësoni ju këtë çmim nga dibranët në Amerikë - SHAD ?

H. Maqellara : Edhe ky çmim si gjithë të tjerët, është një mirënjohje të cilën unë pas atij çmimi që më dha Tirana, do ta "ruaj si syt e ballit" i themi ne shqiptarët.

Ky është një vlerësim nga bashkëpatriotët e mi dibran në Amerikë, që unë mbas kaq vjetësh që jam larguar nga Dibra, ua kushtojë prindërve të mi, të dashur dhe të ndjer të cilët më lindën dhe me edukuan në frymën tonë kombëtare.Gjithashtu, këtë mirënjohje si gjithë të tjerat, ia kushtojë edhe familjes time të ngushtë bashkëshortes time Fatbardha, fëmijëve Burimit, Mimozës dhe Goxhes, nuses së djalit Mirelës dhe nipit tim të dashur Eduartid.

Të them të drejtën më pelqeu shumë sesi Shoqata Atdhetare Dibrane, më në fund po i trajton dhe jep atë që mertiojnë njerëzit që kan merita dhe kan dhënë kontribut në komunitetin dibran, si në qytetin tonë edhe në SHBA. Andaj, mendojë, që kjo traditë të vazhdojë, që të gjithë ata që kan bërë për Dibrën dhe dibranët, kombin shqiptarë të marrin "Mirënjohjen qytetare Dibrane" që u takon.

Të nderohen në festa të tilla edhe dibranë të tjerë, me qëllim që të nxirren në pah vlerat e dibranëve dhe kontributi i tyre, ndërsa të tjerë të nxiten për të bërë edhe më shumë, për Dibrën dhe çështjen kombëtare.

Meqënëse, jemi tek çmimet nuk mund të rrimë pa permendur edhe atë të Këshillit Bashkiak i Tiranës dhe Bashkia e Tiranës, zotit Luzim Basha, që u ka nderuar para një muaji me titullin "Mirënjohje e qytetit të Tiranës". Si keni arritur ju të ruani dhe kultivoni këtë muzikë folklorike, dibrane dhe tiranase dhe si do të ruhet më tej kjo ?

H. Maqellara : Pyetje shumë e bukur kjo! Nga kushtet e "egra" të emigracionit, kam qenë gjithmon i prirë të bëjë vetëm muzikë folklorike me tabanin popullor të asaj krahine, që i përkas Dibrës por edhe Tiranës, ku dibranët kan qenë pjesë e saj - këtu e 100 vjet më parë.

Gjithashtu, kam punuar shumë me Grupin muzikor "Fisnikët" në Nju Jork, të ruajm dhe të kultivojmë muzikën e pastër dibrane, Dhe, kjo për vet faktin - mendojë unë se edhe muzika shqiptare në diasporë mund të ruhet e kultivohet në breza tek shqiptarët, nëpërmjet dasmave, festave dhe gazemndeve të ndryshme që kemi ne shqiptarët e Amerikës.

Pra, duke interpretuar muzikë me taban popullor, duke u ikur atyre dukurive dhe veseve të huaja që janë futur "kot më kot" në muzikën tonë të bukur popullore. Sepse, ajo nuk na nderon edhe si komb ne në diasporë, por përkundrazi ajo na "deformon" ne si komb !.

Duke pasur parsysh se jemi në Amerikë, vendin kampion të demokracisë lirisë dhe të drejtave të njeriut, vendin e mundësive të mëdha, ne jemi të perveligjuar.

Kur dihet se në vende të tjera, emigracioni është i "egër" si thatë ju për të asmiluar lehtë. Këtu, është shumë më leht të ruash dhe kultivosh kulturën tendë, nëse dëshiron askush nuk të pengon.

(Vijon në faqen 19)

Libri i Xhezair Abazit mbyllet me një epilog të shkëlqyer të Gafur Mukës: ***"Pa na kndo dhe një këngë o Hazis Ndreu!"***, që tashmë është Hazis Ndreu i Dibrës dhe gjithë Shqipërisë.

Hazis Ndreu, përfaqësuesi më i denjë i antropologjisë kulturore dibrane

(Vijon nga faqja 14)

Aq shumë na pëlqenin rapsoditë e tij, sa që kishim filluar t'i mësonim përmendësh, t'i recitonim në shkollë dhe të garonim midis njeri tjetrit se kush i dinte ato më mirë etj. Ne të gjithë e admironim atëhere nga larg artistin e shquar Hazis Ndreu, sigurisht pa e ditur se në një të ardhme të afërt, unë do të mund të njihesha nga afër me të, madje do të isha një nga miqtë e tij të shumtë.

Faza II i referohet kohës së pjekurisë. Ishte viti 1979, kur pas studimeve të larta isha emëruar mësues i historisë dhe gjeografisë në shkollën 8 vjeçare të Arrënmallës dhe më vonë drejtor i shkollës 8 vjeçare të Gur-Lurës(Lurë). Ishte koha kur lexoja gjithçka që lidhej me historinë, sidomos me historinë e Dibrës. Ka qenë një gëzim i veçantë për mua kur në revistën "Shkenca dhe Jeta", gjej një artikull studimor mbi lokalizimin e betejës së Torviollit të studiuesit H. Ndreu[1], i cili dy vjet më vonë u botua në revistën "Studime historike"[2], pronë e Institutit të Historisë dhe Akademisë së Shkencave.

Faza III lidhet me vitet e punës në Peshkopi tashmë si arkeolog i atij rajoni(1982-2003). Ajo fillon me punën për përgatitjen e konferencës shkencore kushtuar luftës së Dibrës kundër pushtimit serb në vitet 1912-1921 (1982), dhe vazhdon deri në fund të jetës së tij. Tashmë Hazizi ishte konfirmuar si historian dhe etnolog i njohur në të gjithë Shqipërinë e jashtë saj. Në këtë kohë ai kishte botuar "*Tregime alegorike dibrane*"(1983, ribotuar në 1993) dhe kishte vjelur me qindra faqe të dhëna burimore nga arkivi i popullit në të 4 anët e Dibrës dhe arkivi i Institutit të Historisë në Tiranë. Ndër botimet e tij të mëvonshme përmendim "*Kastriotët dhe Skënderbeu në trojet arbnore*"(1997) dhe "*Dibra në udhën e historisë*" (2003-pas vdekjes).

Kam patur fatin të kaloj shumë kohë me Hazis Ndreun historian dhe etnolog, përfshirë edhe ndonjë shërbim të përbashkët në terren. Unë e shfrytëzoja kohën e çmuar të bashkëbisedimit me Hazis Ndreun për të përfituar sa më shumë prej tij dhe pse jo për t'ju afruar mekanizmit të alegorisë dibrane, që është padyshim, shkalla më e lartë e komunikimit idiomatik. ndërsa ai, si mjeshtër i këtij stili bisedimi, për çdo dukuri shoqërore, sillte ndonjë tregim alegorik konçiz dhe nëpërmjet reagimit tim verifikonte shkallën e përvetësimit të këtij stili të foluri. Megjithatë, gjithnjë kam menduar se koha e bashkëbisedimit me të, ka qenë shumë e kufizuar. Miqësia me një njeri dhe aq më tepër një koleg, sidomos kur ai është më i vjetër se sa ti, është shumë e çmuar, dhe vlera e saj shtohet progresivisht me vitet e ndarjes.

Një moment të rëndësishëm të veprimtarisë së tij përbën padyshim Simpoziumi shkencor Ndërkombëtar **"Dibra dhe etnokultura e saj"** mbajtur në Dibër tëMadhe me 19-21 nëntor 1993. H. Ndreu do të ishte pjesë e Këshilllit të përbashkët organizues me 11 anëtarë të këtij simpoziumi. Kishte vetëm një vit që ishte thyer perdja e hekurt e ndarjes, dhe organizimi i veprimtarive të përbashkëta të të dy Dibrave ishte më se e domosdoshme. Gjatë punës sonë në terren, kemi parë dhe kuptuar më qartë presionin e fortë asimilues të shtetit maqedonas mbi shqiptarët e Dibrës me rrethinë, të Rekës apo të Zhupës, që nga moslejimi i përdorimit të gjuhës shqipe dhe shkollave shqipe, diskriminimi i tyre për punësim dhe shkollim dhe deri tek "shpikja" e termit "*maqedonas muslimanë*" etj. Për rëndësinë e studimeve historike, sidomos në këtë pjesë të Shqipërisë Lindore, ai shpesh i referohej prof. E. Çabejt që shkruante: **" Hapi i parë në likuidimin e një populli është të fshishë kujtesën e tij historike. Shkatëroni librat e tij, kulturën e tij, historinë e tij. Atëhere vini dikë të shkruaj libra të rinj, të krijojë një kulturë të re, të shpikë një histori të re. Para se të kalojë shumë kohë kombi do të harroj se çfarë është dhe çfarë qe"[3].** Në moshën 65 vjeçare, ai ngjitet në kalanë e Koxhaxhikut dhe të Modricës, shkon thuajse në të gjithë fshatrat e Dibrës së Madhe, të Rekës dhe të Pollogut, ngjitet në kalanë e Tetovës dhe të Shkupit, dhe arrin të na japë tri kumtesa të shkëlqyera, me vlera të spikatura historike: "*Toponimia historike e Dibrës mbi Kastriotët dhe Skënderbeun*"[4], "*Kryengritjet antiosmane në gjysmën e dytë të shek. XVI në Dibër*"[5] dhe "*Kryengritjet popullore në Dibër gjatë viteve '30-70 të shekullit XIX*"[6] . Ai do të ishte në vendin e nderit dhe do të thoshte fjalën e tij të mençur në të gjitha veprimtaritë historike e kulturore mbi momentet më kruciale të historisë sonë të Rilindjes e të Pavarësisë, të zhvilluara edhe gjatë periudhës së fundit të jetës së tij (1994-2000) në Dibër të Madhe, në Peshkopi dhe në Tiranë.

Më në fund dëshëroj të risjell në kujtesën e këtij auditori të nderuar një episod të bukur dhe mjaft domethënës të veprimtarisë së shumanshme të këtij njeriu të ditur dhe të mençur. Në një simpozium mbi Skënderbeun dhe epopenë skënderbejane në Krujë(1968), ai do të mbante një kumtesë ku mbron origjinën dibrane të heroit tonë kombëtar. Në seancën e diskutimeve, përfaqësuesi i Krujës në esencë thotë se: "***Skënderbeu ishte nga Kruja, që kishte qenë edhe kryeqenda e shtetit të tij".*** Pas tij e merr fjalën z. Hazis Ndreu. Për të mbrojtur pikëpamjen e tij të drejtë, por edhe për të mos e fyer kolegun krutan, ai u përgjigj me gjuhën ezopiane të tij se ***"Në të vërtetë Skënderbeu ishte nga Dibra, por kalin e ka pas nga Kruja"!*** Me këtë sentencë të zgjuar, të thënë në çastin dhe vendin e duhur, u mbyllën punimet e këtij simpoziumi.

Studimet e mëvonshme mbi heroin tonë kombëtar, veçanërisht monografia e K. Frashërit mbi Skënderbeun[7], konfirmuan hipotezën e mbrojtur nga Hazis Ndreu në disa studime dhe monografi të tij historike.

Libri i Xhezair Abazit mbyllet me një epilog të shkëlqyer të Gafur Mukës pas të cilit siç e ka thënë mjeshtërisht prof. Gafuri, "*askush nuk i shpëton ngasjes të thotë:* ***"Pa na kndo dhe një këngë o Hazis Ndreu[8]!"***, që tashmë është Hazis Ndreu i Dibrës dhe gjithë Shqipërisë.

Fjala përshëndetëse në promovimin e librit ***"Hazis Ndreu-Ezopi i Dibrës"***

1. H. Ndreu, Mendime rreth lokalizimit të fushës së Torviollit", Shkenca dhe Jeta, 1979,3,237-242.
2. H. Ndreu, Mbi lokalizimin e betejës së Torviollit, Studime Historike 1981, 4.
3. E. Çabej, Studime filologjike të shqipes, vol. I, Prishtinë 1965.
4. H. Ndreu, Dibra dhe etnokultura e saj, vol. I, Dibër 1995, f. 147-152.
5. H. Ndreu, Dibra dhe etnokultura e saj, vol. I, Dibër 1995, f. 153-159.
6. H. Ndreu, Dibra dhe etnokultura e saj, vol. I, Dibër 1995, f. 173-178.
7. K. Frashëri, Skënderbeu, Tiranë 2002.
8. Xh. Abazi, Ezopi i Dibrës, Tiranë 2013, 319.

(Vijon nga faqja 18)

Gjithashtu, ne kemi televizione , radio dhe gazeta të komunitetit, që na mbajnë gjallë me frymën kombëtare shqiptare. Duke pasur si i thonë një "Shqipëri të vogël" këtu në Amerikë, ne shqiptarët kemi shumë mundësi të ruajm dhe kultivojmë muzikën, kulturën dhe traditën shqiptare kudo.

Kur jemi në përgjigjen tuaj rreth kësaj çfarë ju u përgjigjet. A mendoni se aktivitetet kulturore dhe artistike të shqiptarëve të Amerikës janë në përputhje me numërin kaq të madh të shqiptarëve që janë në SHBA?

H. Maqellara : Jo! nuk është aspak!, mbasi jemi aq shumë sa duhet të kemi edhe më shumë aktivite dhe veprimtari kulturore e artistike, shqiptare.

Më shumë koncerte e festivale, takime me artistë e këngëtar, promovime librash e artsitësh të rinjë, e të reja këngëtarësh, shkrimtarë, artistë dhe libra, si dhe pjesë të tjera teatrale, filma e të tjera e të tejra, aktivitete e veprimtari kulturore e sportive në komunitin shqiptarë.

Duke shkuar në të njëjtën linjë me kërkesat e disaporës shqiptare në Amerikë, që janë shumë të mëdha.

E them këtë, sepse kemi rënë si "viktimë" e biznesve, ku çdo veprimtari dhe aktivitet apo edhe fest kombëtare, po shfrytëzohet vetëm për të bërë biznes, pa parë anën cilësore dhe profesionale , ruajtjen e kultivimin e kulturës dhe artit shqiptarë.

Do të ishte mirë duke parë se kemi kaq shumë këngëtar dhe artistë në komunitet, mbrëmjet , dasmat, gazmendet, festivalet dhe festat kombëtare, koncertet, t'ju lihen komuniteti të arstitëve shqiptarë, atyre që janë profesionist dhe dijnë të bëjnë art dhe jo një DJ-je që ia humb vlerat muzikës shqiptare. Çdo mbërmje mendoj duhet që t'i jepet një karakter tjetër , ai totalisht artistik dhe kombëtar dhe jo vetëm për të bërë biznes.



Haxhi Maqellara, është këngëtari dibran në Shetet e Bashkuara të Amerikës, që ka kënduar më shumë se 40 vjet - vetëm këngën folklorike dhe popullore

Çfarë mendimi keni për brezin e ri të këngëtarëve të muzikës popullore në komunitet ?

H. Maqellara : Çdo komunitet jo vetëm ne shqiptarët, në diasporë bërthamën e tyre e kan tek të rinjët e të rejat, këngëtarët të cilit lindin nga komuniteti. Ata duhen të përkrahen dhe mbështeten vazhdimisht më të gjitha mënyrat edhe nga ne që jemi me eksperiencë dhe profesionist. Ti inukrajojmë dhe t'ju "hapim rrugë" atyre nëpër koncerte, dasma, gazmende dhe festivale të ndryshme.

Gjithmon, unë personalisht kam qenë mbështetës i tyre dhe kam insistuar që në vazhdimësi të zhvillojnë aktivitetin e tyre. Sepse, vetëm në atë mënyrë mund të mbrrijnë dhe mund të trashëgojnë nga brezat e vjetër në komunitet, atë çka është me taban dhe e pastër shqiptare..

Dhe jam i entusiasmuar që kemi plotë të rinjë e të reja këngëtare në komunitet - duke u uruar atyre suksese. Një ndër ta është edhe nipi im - djali i vëllait Agronit, Bledar Maqellara, një bariton i talentuar dhe me prespektivë të madhe, për në skenën e Operas së Nju Jorkut. Një solist i kompletur më të gjitha elementet që kërkohen, por që do më shumë përkrahje dhe mbështetjen tonë të gjithve për të arritur në majat e suksesit.

A janë "pjekur" kushtet dhe ka ardhur koha të kemi një festival të muzikës popullore me këngëtar të komunitetit ?

H. Maqellara : Mendojë se edhe më përpara kemi pasur kushte dhe kohë, por ka munguar "vullneti" i ynë i të gjithëve pa prejashtim, pra ana finaciare. Megjithëse, kemi një festival të Kishës Katolike Shqiptare "Zoja e Shkodrës", që duhet lavëdëruar për punë që bënë, por kurrësesi ai mund të mbush atë boshëllëkun qe kemi të bëjmë një festival të mirëfilltë të këngës e valles popullore. Ai është një festival i këngës së kënduar dhe veprave të interpretuara, që ruan e kultivon me mënyrën e vet diçka shqiptare në diasporë. Ndërsa, çdo festival ka karakter tjetër, ka atë të pruarjes së këngës dhe valles së re popullore atë burimore folklorike shqiptare.

Nëse do të kishit një mesazh për kolegët e tu, muzikanët dhe adhuruesit e tu - cili do të ishte ?

H. Maqellara: Mesazhi im është për të gjithë kolegët e mi - muzikanët këngëtar e kompozitor, që të kultivojnë sa më shumë muzikën folklorike dhe popullore me taban shqiptar.

Ndërsa fansave të mi u dëshirojë të dëgjojnë sa më shumë muzikë popullore dhe folklorike, vetëm të pastër shqiptare. Duke ruajtur dhe kultivuar atë ne do të jemi më krenar me qenë shqiptar. Se kështu mendojë se doti shpëtojmë edhe atij "asmilimit të egër të emigracionit" dhe do të njifemi më shumë si komb shqiptarë kudo që të jemi me vlera të mëdha që i kemi dhe nuk duhet t'i humbim.

Motoja e tij ishte: Fetë që besojnë në një Zot janë degë të një peme.

Baba Rushit Tollja, kleriku

Nga **DESTAN RAMA**

VENDLINDJA

Sa herë e shqiptojmë emrin Stikçan, menjëherë, ndoshta edhe në mënyrë instiktive i shtojmë togfjalëshin 'Në Strugë të Çon'.

Me këtë togfjalësh mendohet të ketë lidhje emri i fshatit Strikçan. Në verilindje të tij ndodhet një fushë e bukur prej disa hektarësh e cila njihet që në kohë të hershme me emrin Fushë-Gurrë. Këtu ka qenë ndërtuar nga ilirët një qytezë me emrin 'QYTEZA DIBRANA'. I vërtetuar ky fakt nga kërkimet që kanë kryer ekspeditat arkeologjike të drejtuar nga dy arkeologët dibranë A. Bunguri, I.Kaca.

Nëpër këtë qytezë kalonte Rruga e Arbrit, e cila të çonte ne Strugë nëpërmjet luginës së Drinit të Zi. Fshati është i pozicionuar në gjithë shpatin verior te zgjatimit te malit me të njëjtin emër deri aty ku bashkohen Lumi i Okshtunit me atë të Bulqizës. Relievi i fshatit vjen me kodra e lugina të cilat shfrytëzohen nga fshatarët për nevojat e tyre në bujqësi, blegtori, frutikulturë etj.

Fshati Strikçan ka qene fqinji lindor i fshatit të hershëm 'GROPA, Fshati i Pal e Zakaria Gropës, andej nga shek. XII-XIII. Me këtë fshat Strikçani kishte marrëdhënie shumë të mira njerëzore. Këtej kalonte rruga e vjetër këmbësore në drejtimin lindje-perëndim; Ura Spile-Qafa e Çerenecit-Shkëmbi i Urës- Strikçan-fshati Gropa-Varret e Vrame e më tej. Strikçani njihet herët si një ndër fshatrat që kanë shfaqur dashuri e zell të madh për shkollën, dijen, por njëkohësisht ka qene fshati i mikpritjes, i dashurisë njerëzore dhe i sofrës bujare. Në familjen e Tolleve, këtu në Strikçan lindi dhe u rrit biri i tij gojëmbli, mikpritësi, adhuruesi i fesë bektashiane, atdhetari i flaktë, Baba Rushit Tollja me 1878. Në familje qëndroi deri në moshën 18-19 vjeç.

NË KURBET (NË USHTRI)

Kishte dëgjuar se nga zona e tij patën shkuar në kurbet shumë veta, në Stamboll, për të punuar, prandaj vendosi që edhe ai të shkonte atje. Meqë nuk gjeti punë hyri në ushtri. Këtu shumë shpejt u miqësua me shokët dhe si djalë i zgjuar dhe i shkathët që ishte tërhoqi vëmendjen e eprorëve. Ata filluan ta donin, ta respektonin e ta trajtonin sikur të ishte shoku i tyre. Por edhe këtu nuk e gjeti vetveten, ndaj vendosi të largohet. Ndoshta...malli ndoshta kërkimi i vetvetes. U kthye pranë familjes, por edhe këtu nuk qëndroi gjatë.

NË TEQEN E MARTANESHIT

Fjalët shumë të mira që dëgjonte vazhdimisht për Teqen e Martaneshit për Baba Jashar Krenën, nga prindërit e tij ju bënë shtyse shpirtërore dhe e nxitën te shkonte atje. Në teqe gjeti njeriun që kishte ëndërruar prej kohësh. Baba Jashari me ëmbëlsinë e fjalëve mikpritëse, i la përshtypje shumë të mira. Ndaj mori guximin e iu lut ta mbante në teqe, madje shfaqi dëshirën për t'u bërë Dërvish.

Ngadalë more birë. Teqja është shkollë dhe shkolla bëhet më klasa, - i tha Babai. Rushiti uli kokën, u skuq ne fytyrë dhe pas pak foli: Si të urdhërojë nazari. Un jam gati të bëj çdo punë. Babi u bind



se kishte përpara një djalë plot dëshirë e pasion, që do t'i vlente teqes, prandaj e pranoi. E mbante afër, se i pëlqente interesimi i tij për të mësuar. Kështu nuk kaloi shumë kohë dhe u bë myhib. Biles nga vlerësimet e babait, veshi para kohe edhe petkun e Dervishit. Tani kryente detyra më të vështira, madje në disa raste merrte nisma pa i thënë kush, por Babi nuk ia prishte, i pëlqente, sepse kishte besim se gjithçka e bënte për të mirën e teqes.

NË TEQEN E BLLACËS

Kur ndërroi jetë Baba Jashari ai nuk u ndodh aty, Ishte me shërbim fetar në Turqi. Si u kthye prej andej, shkoi te Baba Isufi në Teqen e Bllacës. Si Dervish i kompletuar që ishte me përgatitje e përvojë, Babë Sufa e ngarkonte me punët e detyrat që i pati bërë vetë, sidomos jashtë teqes. Mbasi ndërroi jetë Babë Sufa Dërvish Rushiti u dekretua Baba. Ai e ngriti më lart këtë teqe e zgjeroi e rregulloi e pasuroi. Mbi të gjitha arriti t'i çojë ujin e munguar deri më tani. Ardhja e ujit në teqe qe festë. U gëzuan pa masë shërbyesit e saj, por edhe vizitorët e pa numërt që vinin nga Gryka e Madhe, Gryka e Vogël e më tej.

> Baba Rushit Tollja ka bërë një punë me shumë pasion e aftësi për shuarje grindjesh ngatërresash e hasmërishë; për luftën kundër veseve të këqija e çdo ligësie, për t'u sjellë njerëzve paqe, mirësi, mirëkuptim, dashuri e vëllazëri.

DASHURI DHE RESPEKT PA KUFI

Në vitin 1924 disa anëtarë të këshillit dhe përfaqësues të Teqes së Martaneshit shkuan në Bllacë dhe iu lutën Baba Rushitit të vinte në Teqen e tyre, ku gëzonte shumë dashuri dhe respekt.

- Po Bllacën kujt t'ia lë? - pyeti Babai

- Mbaji të dyja, - tha njëri nga Martaneshasit. Nazari mban më shumë, për atë teqe ku ka derdhur aq djersë e mend, - vazhdoi bisedën ai. Për hatër të Ballëm Sulltanit, po edhe tuajin dëshirën e atij populli do ta plotësoj, - tha Baba Rushiti.

Teqja e Martaneshit kishte një veprimtari më të gjerë prandaj i duhej të merrej më shumë me punët e saj. Kur e donte puna, drejtimin e punëve te teqes ua linte vartësve, të cilët ishin të përgatitur mirë dhe me ndërgjegje të pastër, ndaj Babai thoshte se largohej me zemër të ngrohtë.

PUNË ME VLERA TË MËDHA SHOQËRORE E KOMBËTARE

Baba Rushiti ka bërë një punë me shumë pasion e aftësi për shuarje grindjesh ngatërresash e hasmërishë; për luftën kundër veseve të këqija e çdo ligësie, për t'u sjellë njerëzve paqe, mirësi, mirëkuptim, dashuri e vëllazëri. Kryesorja ishte se vepronte ne çdo rast me drejtësi, dinte të zbulonte të vërtetën, dhe ta çonte punë e nisur deri në fund. Në bisedë me folës popullor, si: M.Tollja, M.Isaku, I.Kika etj zbulojmë se raste të tilla ka pasur në Godvi, Zerqan, Kostenjë, në Grykë të vogel, në Shëngjerq, Shënmeri, Çermenikë, Elbasan, etj. Baba Mustafa i Elbasanit e merrte me vete gjithmonë kur shkonte të zgjidhte probleme me popullin, - thotë Mustafa Tollja. Babai kujdesej vazhdimisht edhe për shëndetin e njerëzve dhe për marrëdhëniet në familje. U shkonte për vizitë në familje në gëzime, veçanërisht në raste fatkeqësish. Baba Rushiti me tërë veprimtarinë e tij ka treguar se është përpjekur për ta ngjallur jetën e jo për ta shuar; për të mbrojtur dinjitetin e njeriut, si qenie e Zotit mbi tokë që meriton dashuri, nderim, respekt, harmoni e vëllazërim. Vetëm me pajtimin e gjaqeve ai ka shpëtuar qindra jetë njerëzish. Baba Selim Kaliçani me një statistikë të përafërt që na ka dhënë me shkrimet e tij, mësojmë se në Dibër ka pajtuar 30 hasmëri, në Çermenike 18, në Martanesh 20, ne Shëngjergj e Shënmëri 40.

Për këtë punë me vlera shoqërore e kombëtare i është dërguar një letër falënderimi nga Ahmet Zogu ku thuhet: "Mbretëria Shqiptare të Përgëzon për punën e mirë që ke bërë e po bën me popullin. Për këtë edhe un përulem shenjtërisht para jush u jap fjalën se Mbretëria Shqiptare do të jetë mirënjohëse ndaj jush".

FUQIA HYJNORE/MISTIKE

Baballarët e Teqes së Ballëm Sulltanit e kanë shfaqur shejterinë e tyre fare hapur në shumë raste. Në vitin 1943 fashistët Italian i vunë zjarrin disa herë Tyrbes, por ajo mbeti ashtu siç ishte e madhërishme me krye drejt qiellit nga e kishte origjinën.

Baba Rushit Tollja me forcën e tij hyjnore, mistike ka shpëtuar qindra shpirtra njerëzish nga gjynahet. Ata kishin krijuar një besim të tillë mbi forcën mistike të tij sa shumica e thërrisnin vet për ndihmë dhe ai nuk përtonte në asnjë rast pa marrë parasysh se cilës fe i përkisnin apo fisi e krahine...Motoja e tij ishte: Fetë që besojnë në një Zot janë degë të një peme. Ne jemi lule të një degë. Kulmi i fuqisë së tij mistike arriti në vitin 1967 kur jezitia u vuri kazmën edhe varreve. Trupi i baba Rushitit u gjet sit ë ishte varrosur atë ditë.! U dyndën të gjithë fshatrat për të parë e nderuar njeriun e Zotit, këtë njeri të paparë ndonjëherë. U vunë në lëvizje organet e pushtetit dhe organizmat e tjera për të shpërndarë njerëzit... Trupi i tij i vdekur por i gjallë ne mes të të gjallëve që kishte ndërruar jetë në 1929 tanimë pushon në fshatin e lindjes, Strikçan.

Të afërm të familjes së tij, të drejtuar nga Sabri Tollja i ngritën Teqen në perëndim të lagjes Tolle në një vend të bukur; në një kodër dominuese në hapësirën e luginës e rrethuar me drurë lisi, një bukuri e vërtetë një gërshetim i bukurisë hyjnore me atë natyrore. Në oborrin e vogël të saj janë vendosur disa karrige. Aty ulen vazhdimisht vizitorë të shumtë të cilët vijnë këtu për të takuar njeriun e Zotit, për të marrë urata e bekime për të gjetur shërim nga sëmundjet, drejtësi e paqe në jetë. Vepra e tij hyjnore mistike, e shoqërore le të bëhet dritë e të ndriçojë vazhdimisht udhën e njerëzimit...

REFERENCAT:

- Histori e baballarëve të Teqes së Martaneshit

(Baba Selim R. Kaliçini)

- Drita e bekuar rrezaton.....Besim, Vëllazërim, Urtësi, Mirësi.

(Z.Sula, Q.Lila, A. Biçaku)

- Folës popullor: M. Tollja, M.Isaku, I.Kika etj....



Doni te
informoni
komunitetin
rreth jush
per dicka
qe ju intereson atyre?

SHKRUANI NË GAZETË!
BASHKËPUNO EDHE TI!

rrugaearberit@gmail.com

Shkruar sipas kujtimeve
të Bajram H. Manit

Shkrimtari Haki Stërmilli ka vizituar Muhurrin

Nga Dr. **SELMAN MEZIU**

Njerëzit që kanë përqafuar diturinë, kanë zbuluar në gërxhet e brishta të jetës, shenjat, dëshmitë, margaritarët e së vërtetave të fshehura nën qerthullat e shekujve. Kjo udhë ka patur gjithnjë lakoret e saja të mundimshme, por fitilat e përflakura, të kureshtjeve, të synimit për të arritur në zemër të së vërtetës kanë shpërthyersi vetëtima dhe flakërima e saj ka ndriçuar shtatoren e së vërtetës historike.

Ishte verë e vitit njëmijë e nandëqind e dyzetë e katër. Ndodheshim në Sllovë, ishim pjestartë çetës partizane më të njajtin emër, - kështu e filloi bisedën Bajram Hysen Mani nga fshati Shqath i krahinës së Muhurrit.

Në zjarminë e luftës partizane, u njohën luftëtari e shkrimtari Haki Stërmilli me Bajramin. Një ditë kur po ecnin rrugëve të Sllovës ai e pyet luftëtarin në krahë:

- A mund të shkojmë dhe të shohim, Gjerdhin e Epërm dhe të Poshtmin, Mazrekat e disa ngulmime të Kastriotëve në krahinën e Muhurrit?

- Me gjithë qejf, me një udhë, kalojmë edhe nga shpaja eme se me ka marrë malli për familjen, - iu përgjigj duke i buzëqeshur e parë në sy bashkëfolësin.

E thanun e bamun. Pasi morën lejen tek komandanti i çetës nisen për udhë, duke kaluar nëpër fshatrat Kastriot, nën Kodrën e Kubenit, Vakuf, Rreth Kale. Kaluan Drinin tek shtepia e Hamit Manit, në vendin e quajtur Kepi i Mane. Sgurisht Drini kishte pak uji, ato përveshën pantallonat duke mbajtur me kujdes pushkët se revolverët i kishin lidhur mirë në brez.


Pas udhëtimit të vështire përmes shenjave e varreve, si dhe fermanave e te tjera arritën tek shtëpia e Ali Renës tek Xhamia në Lindërsa të Lace, ku pinë kafe dhe hangrën drekën, me plotë shije, dhe nën buzëqeshjen dhe bujarinë e të zotit të shtëpisë.

Hakiu e pyeti Aliun mbi Gjerdhin e poshtëm, Gjerdhin e sipërm, kishat, fisin e Berishe, Mazrekat, Algjonet, Xhutezën etj. I gjithë bashkëbisedimi u shkruajt në një fletore, me një laps plumi të zi, që herë pas here e prefte me një thikë të cilën e mbante me vete.

Panë muret e kishës së Shmrisë, pothuajse te shkatërruara, një lisë që nuk e mbërthenin dy burrame kunore shumë të gjane, fare pranë saj, këto mbi trojet e Berishe në veri të Krekzës ose ku ndodhej xhamia. Në vnesh hangrën nga manat e zesë, ku langu i tyne i ngjyrosi për çudi, me të kuqtë alle gishtërijt e pllamët e duarve. Ato ishin trup mëdhenj, me kurorat e hapura ku shquhej e gjelbërta e thellë. Ndërkohë shijonin frutet e tyre dhe të dy vrisnin menen sepse kishin langun e kuq këto.

Në ngjitjen përgjatë udhës kamsore, panë lagjen e Algjone pra Farruke, Dabiçe, Sine, Xhane, Tanush ku dukeshin themelet e disa shtëpiave të tyre dhe nëpër ara e livadhe panë kurorat e disa pemëve frutore si, kumbullave, manave, kajsive, mollave etj. Në arat e Shmetrave Bajrami i tregoi Stërmillit, themelet e një kishe tjetër ku dukeshin shenjat e mureve fare pak. Më pas arritën te Teçja e Çikut,me qoshe e çemerët e dyerve e të dritareve me gurë të gdhendur bukur. Rrethuar me pyje lisi të dendura, kurorë medhenj por të çrregullta. Një fllad i freskët frynte e iu hyri menjëherë në gjokset e hapura nga vapa e lodhja dhe iu mbushi mushkritë me ajër të pastër.

Arritën në qafë të Shëne Lleshe, ku pushuan për pak minuta nën hijen e një dardhe, edhe kjo me pamjen e sajë


HAKI STERMILLI

DIBRA
NE PRAK TE HISTORISE

Haki Stërmilli u mahnit nga kjo qytezë strategjike, ku në anën lindore shikimi ndalohej në murajën natyrore, padyshim me përmasa gjigande të Runjës, malin e Shmrais, luginën e përroit të Shqathit ku përplasesh shikimi në kurrizin malor, rrafshja e Merke, maja e Mollës, maja e Rame, zbriste tek Qafa e Epërme e Poshtmja duke u varur me kurriz, shpate qetësisht në luginën e Murrës. Panaorama gjigande e Gropës së Dibrës, me murajën e stërmadhe të vargmalit Korab, Maja e Deshatit e deri në Malet e Sharrit në Radikë, ku mezi dukeshin.

TIRANË 3.IV.1940

madhështore, padyshim iu ngjalli kenaqësi. Ngjiten në maje të Xhutezës, ku vështrimi iu kapi tre tuma të mëdhaja. Në krahun lindor, jugor e prendimore dukeshin copra muresh me gjërsi një metër dhe lartësi nga dyzetë centimetra në një metra.

Shoqëruesi i tregoi, arat e Sheshave, ku mazrekasit mbanin dhe stërvitnin ushtrinë, mazdrekat të rrethuar me kurrize dhe mure në pjesët lindore e Veri - Lindore, ku ka qene banuar nga familja e pasur e Mazrekasve, në Arë të Kurte ka qenë vendbanim, banorët e së cilës kanë qenë në shërbim të kësaj familje të madhe bujare.

Hakiu u mahnit nga kjo qyteze strategjike, ku në anën lindore shikimi ndalohej në murajën natyrore, padyshim me permasa gjigande të Runjës, malin e Shmrais, luginën e përroit të Shqathit ku përplasesh shikimi në kurrizin malor, Rrafshja e Merke, Maja e Mollës, maja e Rame, zbriste tek Qafa e Eper e Poshtmja duke u varur me kurrize, shpate qetësisht në luginën e Murrës. Panaorama gjigande e Gropës së Dibrës, me murajën stërmadhe te vargmalit Korab, Maja e Deshatit e deri ne Malet e Sharrit në Radike ku mezi dukeshin.

Hyseni i priti krahahapur, dhe me fjalën e pare të shprehjes se mikpritjes: Bujurmi! I biri e prezantoi me shkrimtarin Stërmilli, i foli mbi shkollimin e tijë, librat e ndryshme të shkruara, burgun që kishte bamun në kohën e sundimit të mbretërisë së Ahmet Zogut etj.

Hakiu në bisedë e sipër e pyeti mbi Kishën e Malit të Shmrais, ku ai i shpejgoi se ka qenë e fuqishme në kohën e Kastriotëve. Ka patur dymbëdhjetë dhoma, muret i ka akoma me lartësi qe shkon deri në një metër. Ka patur dymbëdhjetë mijë dhi plleja ku qumështi i tyre dërgohesh me lugje në Kishen e Limthit pranë Arapit të poshtëm, në rrugën kamsore që lidh, Arën e Shënkollitme fshatin e sipërpërmendur.

Më tej plaku i Mane pjesmarrës në shume beteja kundër hordhive serbe, si në atë të Kolosianit, të Rrafshes së Merke, të Gjarëcës, pjesmarrës në kuvendin e Arrasit i shprehet se Muhurrakët kanë qenë Bujqit e Skënderbeut, dhe me fisin e Berishe kane patur lidhje gjaku dhe kanë bashkëpunuar ngushtësisht me ato.

Ai i shënoi të gjitha ne fletoren e tijë të zakonshme. Pas dy netësh në shtëpinë e Hysen Manit dy partizanët largohen për në Sllovë për të vazhduar luftën kunder pushtuesve gjerman.

Pas afërsisht shtatëdhjetë vjetësh, ne bahemi të ditur se shkrimtari Stërmilli gërmonte në vende të ndryshme të Dibrës, për të shkruar mbi historinë e sajë, e lanun në harresë, mshtjellun me rrjetën e mospërfilljes, dhe e fshehur marrezisht nga dallama e zezë sterrë e paditurisë.

I mençuri nga natyra, i dituri nga shkollimi e studimet, njeriu i kulturshëm Haki Stërmilli interesohesh, në mes të tallazeve të frikshme, vdekjeprurëse, të luftës Nacional Çlirimtare për të hedhur dritë diturie me shkronjat dhe fjalën shqip të shkruar, mbi bëmat e heroit legjendar Skënderbeut, familjes së Kastriotëve, dhe origjinën e tyre nga familia bujare e Mazrekasve.

Nuk vonoi shumë dhe ai doli me studimin historik "**Dibra në prak të historisë**" ku mjerisht ka mbetur ende pas shtatëdhjetë vjetësh, dorëshkrim. Lexohet, studiohet ashtu, me shkrim dore ose i shtypur si mos më keq, nga kopja që ndodhet në Muzeun e qytetit të Peshkopise. Historia e Dibrës, që e ka fillesën e vetë në kudhrën e luftës për me jetue të lirë në mes unazës gjigande të këtyre malave kreshnikë e krenarë, kujeta kacafytesh me vdekjen kurdoherë dhe gjithëkund. Pikërisht nga kjo përflakje del në dritë pjella e sajë nga mendje e të ndriturit Haki Stërmilli ''Historia e Dibrës. ,, E gatuar me mundime të mëdha, me cfilitje shpirti, me çurke gjaku e djerse, me netë të panumurta të pagjum. Së fundi e shkruar me laps në një fletore të thjeshtë, ruajtur në gji nëpër shtigjet e luftës për liri, nga biri trevës Dibrane me plotë dinjitet njerëzor dhe njëkohesisht i mëkuar me kulture, dituri e shkollim

PENTAGRAME HISTORIKE.

Librin ai e shkruajti. Por fatkeqësisht ai mbeti për 40 vjet si dorëshkrim pak ose aspak i shfrytezuar nga studiuesit e historisë, krahinore apo mbarë shqipetare. Në vitin 1980,Drejtori i Kombinatit Poligrafik, Hajri Hoxha, me mundësitë e atëhershme e shtypi vetëm në disa kopje të cilat ua dha vetëm disa studiuesve dibran, dhe pak kopje ia dhuroi Muzeut të Peshkopisë. Studimi ka vetëm146 faqe, nuk ka në përbërje harta,skica dhe fotografi.

Me poshtë mund të lexoni parathënien të shkëputur nga origjinali:

Parathënie

Ngjarjet e zhvillueme ne qarkun e Dibrës dhe prej Dibranëve qysh në kohët e lashta, jam i bindun se kanë me sherbye si landë për historin e nesërme. Prandaj vendosa me i përmbledhë në këtë vepër.

Burimet qe kane ndihmue për këte qëllim, s'janë vetëm veprat dhe dokumentat e ndryshme, por edhe kujtesa e pleqëve. E populli që i ka ndigjue e jetue, simbas meje, asht dëshmitari më i drejtë i çdo ngjareje. Prandaj, pangurue, po nis nga puna.

Shtoj ehe se ne përgatitjen e nji pjese të landës ka ndihmue edhe Z.Haki Sharofi, Zeqir Kodra, Abdullah Izeti, Gani Strazimiri, Tahir Koçi, Remzi Tërshana, Zihni Çiça e të tjerë.

Tiranë, më 3-IV-1940
(Haki Stërmilli)

Kuptohet qartë që shtatëdhjetë e tre vjetë më parë, shkrimtari dibran, i njohur në lamin kombëtar e ndërkombëtar, shkruajti historinë e parë të Dibrës, duke u bazuar ne burimet e shkruara edhe pse të kursyeshme. Por ato janë në gjuhën italisht, gjermanisht, serbisht, dhe në burimet gojore të vjelura nga ai vetë.

Edhe pse regjimi i kaluar botoi veprat e shkrimtarit në fjalë, por la mjerisht jashtë përfshirjes në këto historinë dibrane. Lind natyrshëm pyetja: Përse valle ndodhi kështu?

Kane kaluar njëzetë e tre vjetë që udhëtojmë ne kalvarin e demokracisë, dhe as shteti, as edhe një shoqatë dibranësh e çfarëdo lloji qoftë, as edhe një pronar (afarist) nuk mori inisiativën të investojë për botimin e kësaj vepre të shumë kërkueshme nga shkruesit e historisë së Dibrës dhe krahinave të ndryshme të saje por edhe me gjerë.

Kush vallë do të jetë i pari investitor që do të derdhë lekë për botimin e kësaj vepre me vlera të pazëvendësueshme në historigrafine dibrane? Artikullshkruesi shpreson se farën e diturisë dikush do ta mbjellë.

Në shekullin XIX e XX, ku kemi konflikte të rënda midis pushtetit osman dhe shqiptarëve, shumë njerëz të shquar me origjinë shqiptare nuk e mohojnë origjinën e tyre, por këtë e thonë hapur. Kështu do të bënte poeti i madh dhe filozofi dr. Riza Tefiku me origjinë nga Dibra. Ai me ndjenjën e krenarisë me vetëdije të plotë kombëtare do të firmoste: "Deputeti i Adrianopojës Riza Tefik Dibrani".

Riza Tefik Dibrani

Nga **XHELAL ROÇI**

(Vijon nga numri i kaluar)

Dr. Riza Tefiku ishte edhe publicist. Ai i ka dhënë shumë gazetarisë sidomos asaj turke. Në gazetat, revistat dhe në shtypin e kohës ai ka shkruar pa ndërprerë artikuj, studime e shkrime me karakter të ndryshëm.

Riza Tefiku nga përkrahës i turqve të rinj, u bë një nga kundërshtarët kryesorë të drejtuesve të organizatës "Bashkim e Përparim". Ai kaloi menjëherë në opozitë i nisur nga fakti se ata nuk mbajtën e nuk zbatuan asnjë nga premtimet e bëra, përkundrazi mbasi erdhën në pushtet filluan shtypjet e persekutimet e ndjekjet ndaj shqiptarëve. Riza Tefiku për shkaqe politike u burgos dy-tre herë nga autoritetet qeveritare turke dhe herën e fundit e përzunë nga Turqia. Mbasi doli nga burgu i mërzitur nga këto veprime hoqi dorë përkohësisht nga politika dhe vendosi të merrej me shkrime publicistike, kulturore, me lexim e me përkthime literature të ndryshme.

Riza Tefiku në kohën e luftërave ballkanike dënoi aktet e shteteve fqinje që i vërsuleshin Shqipërisë. Ai në organet e shtypit të kohës dënoi veprimet e shteteve të mëdha që vendosën copëtimin e shtetit shqiptar. Rizai luftonte për krijimin e një shteti shqiptar të pavarur e kufijtë që përfshinin katër vilajetet e Shqipërisë, pra për Shqipërinë e Madhe për bashkimin e ... shqiptarëve. Ai argumentonte që shqiptarët duhet të kenë shtetin e tyre, gjuhën e tyre zyrtare, nëpunësit e tyre amtare nëpër shkolla.

Largimi nga politika e Riza Tefikut ishte e përkohshme. Ai nuk mund ta mbante veten e nuk mund të qëndronte indiferent nga valët e tmerrshme të politikës dhe kështu, ai, mori pjesë në kabinetin qeveritar të Damad Ferit Pashës, në vitin 1918, u caktua me detyrë Ministër i Arsimit në Turqi.

Më vonë u bë kryetar i Këshillit të shtetit turk dhe në konferencën e paqes pas luftës së parë botërore mori pjesë si i deleguar i posaçëm i shtetit turk ("Misticizmi islam dhe bektashizmi", vepër e cituar).

Në këtë vite ai u caktua Kryetar i Komisionit Legjislativ në Parlamentin Turk e më pas u detyrua të emigroi përsëri nga Turqia për shkak të kontradiktave dhe të mosmarrëveshjeve me autoritete qeveritare të vendit (Turqisë) si kundërshtar i Mustafa Qemal Ataturkut.

Riza Tefiku që gjatë kohës që ishte student, ai vazhdonte të merrej me psikologji. Në këtë kohë, kjo ishte një shkencë e re e sapo ndarë si disiplinë nga filozofia. Riza Tefiku i kushtonte një vëmendje të veçantë psikologjisë i shtyrë nga dy gjëra: Profesioni i tij i mjekut dhe pasioni i veçantë që kishte për filozofinë e në veçanti për psikologjinë. Këto dy shkenca ishin të lidhura me njëra-tjetrën. Ai për psikologjinë vazhdonte të gjurmonte e të zbulonte në vazhdimësi materiale për studim. Këtë e dëshmon interesimi i tij për të shtën në dorë veprën "Psikologjia" të Hasan Tahsimit, përpjekjen që bënte ai për njohjen prej tij të dijetarëve dhe të autoriteteve në fushën e psikologjisë. Në këtë drejtim nuk kanë munguar dhe përkthimet që ka bërë ai, nga literatura perëndimore dhe shkrimet me karakter psikologjik nga vetë Riza Tefiku në shtypin turk të kohës si dhe leksionet që jepte nëpër shkolla e në mënyrë private për këtë lëndë.

Dr. Riza Tefiku ishte edhe publicist. Ai i ka dhënë shumë gazetarisë sidomos asaj turke. Në gazetat, revistat dhe në shtypin e kohës ai ka shkruar pa ndërprerë artikuj, studime e shkrime me karakter të ndryshëm.

Për ilustrim, po përmendi një studim të botuar në turqisht në vitin 1911 në organin "Mussaver Arnaut" (Shqiptari i Lustruar) që e nxirrte atdhetari shqiptar Dervish Hima. Ky studim i kushtohej rilindësit Hoxha Tahsimi, jetës dhe veprave të tij në shërbim të kombit shqiptar. Riza Tefiku ishte në treshen që botoi revistën turke "Ulum-i Iktisadijeve, Ictima i dij Mecmuasi", revistë e parë sociologjike (e nxjerrë bashkë me Ahmet Shuaipi dhe Mehmet Xhevid). Kjo ishte një revistë përparimtare, e kohës me frymë demokratike e me drejtim perëndimor. Në artikujt e Riza Tefikut të botuar në të, por dhe në shkrimet e tij botuar në organet e tjera, ngriheshin probleme të shkollës, arsimimit të njerëzve, të emancipimit të gruas, të karakterit laik të shkollës, probleme të gjuhës sa më të përpunuar, për ta bërë atë sa më të kuptueshme për të gjitha shtresat e popullit, e nevojat e pasqyrimit të halleve të popullit e të tjera. Në këto shkrime ndihej dora jo vetë e gazetarit por e sociologut që fshihej pas tij dhe e filozofit. Ai ishte nga personat e rrallë që kishte njohuri speciale në këto dy lami të shkencës shoqërore, ndoshta si askush tjetër në atë perandori. Vetë Riza Tefiku në një artikull të vetin shënonte; se unë kam shkrime e studime të posaçme nga fusha e jetës shoqërore, studime të mirëfillta sociologjike. Për studiuesit e ardhshëm të kësaj figura madhore do të jetë një punë më vete hulumtimi, grumbullimi, sistemimi e botimi i shkrimeve të tij të shumta gazetareske të shpërndara gjithandej në shtypin e kohës, sidomos në atë të Stambollit, por edhe të Selanikut apo ndonjë qyteti tjetër si Izmiri.

Gjithashtu grumbullimi, studimi i kujdesshëm dhe sistemimi i gjithë kësaj krijimtarie do të kërkonte kohë e punime të veçanta.

RIZA TEFIKU GJUHËTAR

Për Riza Tefikun nuk kanë qenë të huaja problemet gjuhësore, qofshin për gjuhën turke apo për atë shqipe. Ai asnjëherë nuk i ka lënë jashtë vëmendjes së vet problemet e gjuhës. Një poliglot si Riza Tefiku dhe një njeri i letrave si ai, detyrimisht që do të merrej me ta. Ne konkretisht nuk mund të themi se çfarë veprash i ka kushtuar kësaj dege të shkencës, se veprat e tij ne nuk i kemi në dorë, as edhe shtypin e kohës ne nuk kemi mundësi ta njohim, por me përafërsi mund të themi, se problemet që kanë shqetësuar Dr. Rizain kanë qenë ata që kanë zier me opinionin intelektual të kohës, si për shembull çështja e pastrimit të gjuhës, duke e afruar sa më shumë atë me gjuhën e folur të popullit, për ruajtjen e gjuhës nga fjalët e huaja, qofshin këto me origjinë perëndimore apo lindore si arabe apo persiane, çështja e fjalorëve gjuhësor, e mënyrës, e metodës së hartimit të tyre, të teksteve mësimore e gjuhësore si gramatika e të tjera.

Studimi, përpunimi e përsosja e programeve në shkolla për përvetësimin e gjuhës e shumë e shumë probleme të tjera, që ishin të mprehta në atë kohë.

Një problem tepër i ndjeshëm në atë kohë qoftë për turqishten qoftë për shqipen ka qenë çështja e alfabetit. Dr. Riza Tefiku ka qenë që gjuha shqipe të përdoreë alfabetin latin dhe jo atë arab. Sipas profesor Ali Vishkos në kumtesën konvergjencat dhe divergjencat në çështjen e alfabetit të njësuar të shqipes, mbajtur në tribunën lidhur me përvjetorin e 85 të Kongresit të Manastirit, me datën 17 nëntor 1993 në Tetovë. Në këtë kumtesë që ai lexoi, përmendi: "Në muajin mars të vitit 1910, filozofi shqiptar, Riza Tefik beu, ka mbajtur në klubin e shqiptarëve atdhetarë të Stambollit një kumtesë shkencore, ku foli për rëndësinë e njësimit të alfabetit të shqipes dhe për pranimin nga shqiptarët e alfabetit latin për këtë gjuhë.

Ai e quante domosdoshmëri përdorimin e alfabetit latin dhe ai e mbrojti me zjarr përdorimin e tij për gjuhën shqipe. Pikërisht këtë e bëri në kohën kur vlonin diskutimet për alfabetin e gjuhës shqipe, duke dalë në kundërshtim të hapur me idhtarët e alfabetit arab për shqipen, që kishin edhe mbështetjen e fuqishme të qeverisë xhon turke.

Riza Tefiku ka qenë një penë e fortë në fushën e letërsisë turke qoftë si post, qoftë si prozator. Qysh herët iu kushtua leximit dhe filloi të shkruante vjersha. Në vitin 1908 hyri në shoqatën letrare. "Letërsia e Re".

Tërë jetën u muar me aktivitete letrare deri sa vdiq. Ai njihet si një nga poetët e shquar në letërsinë turke. Turkologu rus e quante Riza Tefikun njeri të talentuar, që jetoi në fillim të shekullit XX, ndërsa studiuesja e sotme Garbuzova e çmon së tepërmi këtë ideolog, filozof, publicist, gjuhëtar të asaj kohe. Ndër dy grupet e rrethit letrar të viteve '90 të shekullit të shekullit të XIX dhe të fillimit të shekullit XX të grumbulluar rreth gazetës "Serviti Funun" (pasuria e shkencës). Ajo e vendosi atë në krye të krahut intelektual individualist apo nacionalist siç e quan Gordlevskij.

Nën ndikimin e tij do të ishin dhe të tjerët. Në këtë grup bënin pjesë edhe dy miqtë e Rizait, shkrimtarët Tefik Fikret dhe Mehemt Emin. Ndërsa përballë këtij grupi qëndronte grupi i Mehmet Akifit, i cili më pas ra nën ndikimin e ideve pan-islanistëve.

Grupi i parë ishte ai i quajturi "arbcilik", do me thënë pr perëndimor, si të thuash përfaqësotne krahun me përparimtar, demokratik, gjë që bënte nder me të dalluarit Riza Tefik Shqiptarin.

Në veprën e tij "Haluku Defteri" (Fletore e Halukut) faqe 54, Tefik Fikreti i kushton Riza Tefikut një poezi ku e ngre shumë lart atë, në atë kohë. Ai e quan i vetmi filozof dhe i pari në kuptimin modern të fjalës.

Në veprat e Riza Tefikut figuron një përmbledhje vjershash. Një vepër tjetër e tij ndoshta në prozë është vështrimi i jetës. Pa hyrë në detaje mund të themi, duke u mbështetur tek Gordlevski, autoritet i zoti dhe shumë kompetent në këtë fushë dhe si turkolog edhe si njeri që i ka njohur vetë shumicën e letrave të brezit të Riza Tefikut e para tij. Me thjeshtësinë e vargut dhe të folmes së tij, ai të kujton vargjet e popullit, të lirikave popullore. Fjala e riza Tefikut do të hynte në zemrën e popullit dhe ky demokratizëm i ideve provon se interesat e popullit, fillojnë të shqetësojnë krahun e inteligjencës tjetër osmane.

Pata rast të shijoj, shënon Gordlevski, disa poezi të poetit në turqisht, origjinali dhe dy prej tyre të përkthyera në rusisht, të cilat dëshmojnë për talentin e spikatur të poetit, forcën e vargut të tij, ngrohtësinë që përcjellin fjalët e tij tek lexuesi. Duke folur për vjershën "Fati" ku poeti i këndon Rumelisë, vendeve malore ku fryn era, ku rrjedhin me rrëmbim ujërat, ai kujton jetën e bukur të fshatit. Si duket poeti i këndon Dibrës së vet, ku me sa duket ka shkuar edhe në moshë të pjekur shtigjeve malore, pyjeve e ka parë ku kullosin bagëtitë e të tjera.

Gordlevskij nënvizon se me mprehtësinë e shprehjes "Fati" i Riza Tefikut të kujton "Vargjet e hekurta" të Lermontovit.

Si kritik letrar Dr. Riza Tefiku është dalluar për analizat letrare që u ka bërë disa veprave të letërsisë turke. Qysh para hyrjetit ai ka bërë jo vetëm poezi por edhe kritika letrare që tërhiqnin vëmendjen e lexuesve.

Riza Tefiku është marrë gjerësisht me historinë e letërsisë turke. Në universitetin e Kajros në Egjipt, në kohën kur ai u largua nga Turqia, Riza Tefiku ka punuar disa vjet si pedagog (Profesor) i letërsisë turke. Ai ka qenë shef i katedrës së letërsisë turke në atë universitet. Riza Tefiku ka bërë edhe përkthime letrare nga bota perëndimore dhe lindore, por neve do të përmendim se ai, sikurse bëri Fan Noli në gjuhën shqipe, Riza Tefiku, përktheu në gjuhën turke në bashkëautorësi "Rubairat" e famshme të Omar Khajanit. Riza Tefiku ka mbajtur disa tema e konferenca në favor të gjuhës shqipe të shkronjave shqipe dhe këto gjenden të grumbulluara në fondin e materialeve të klubit të Stambollit, një ndër këto ka qenë tema kryesore e emërtuar: "Lëvizja Kombëtare Shqiptare pas kushtetutës osmane", mbajtur më datën 21 korrik 1908. Riza Tefiku, filozofi dhe Ruditi, dibrane me origjinë shqiptare është vlerësuar një nga krerët kryesorë të këtij klubi. Për këtë flet edhe Sejfi Vllamasi në librin e tij "Kujtime e Ballafaqime Politike në Shqipëri nga vitet 1897 deri 1942" faqe 36.

Në vjershën "Fati" ka një moment që padyshim të tërheq vëmendjen e të kujton thënien e Pashko vasës, "Feja e shqiptarit është shqiptaria". Nga leximi i vjershës të krijohet përshtypja se ai i ka bërë vizita vendit të vet Shqipërisë dhe kjo është e logjikshme sepse ai i kushton disa poezi në gjuhën turke. Kuptohet këtu, ai diçka largohet nga konkretja, duke u munduar ta përgjithësoi. Duke goditur arbitraritetin dhe zullumet e pushtetmbajtësve turq, duke fshikulluar duart grabitqare e vrasëse të tyre, ai thotë: "Se ata pikojnë gjak dhe bëjnë shkatërrime. Por ja, erdhi agimi, shprehet ai në mënyrë të figurshme. Zjarri i hidhërimeve të popullit do t'i detyrohet ai në mënyrë të figurshme. Zjarri i hidhërimeve të popullit do t'i detyrojë xhelatët të fshihen. Xhamia, thotë autori, është shkatërruar, domethënë, njerëzit ndoshta kanë humbur besimin, por mihrabi, (vendi i lutjes së myslimanëve, të tillë janë shqiptarët), nuk duhet shkatërruar. Poeti bën thirrje: "Faluni për vendin, gjunjëzohuni përpara tij, do me thënë përpara atdheut, tek kombi, tek Shqipëria. Kjo do ruhet, ky është mesazhi që sjell autori për shqiptarët. ai shënon se s'ka fe pa atdhe. Dhe ajo që i vënë vulën atdhetarizmit të tij të flaktë, janë distiku i vargjeve, ku thotë haptas, se i ati i tij është shqiptar nga Dibra. Zaten me këtë në shekullin XIX e XX, ku kemi konflikte të rënda, midis pushtetit osman dhe shqiptarëve, shumë njerëz të shquar me origjinë shqiptare nuk e mohojnë origjinën e tyre, por këtë e thonë hapur. Kështu do të bënte poeti i madh dhe filozofi dr. Riza Tefiku me origjinë nga Dibra. Ai me ndjenjën e krenarisë me vetëdije të plotë kombëtare do të firmoste: "Deputeti i Adrianopojës Riza Tefik Dirbani". Sipas zakonit të vjetër në Shqipëri shumë njerëz në mërgim, merrnin emrat e fshatit, krahinës për mbiemra.

Këtë përcaktor të kësaj figure me zë në periudhën e Rilindjes sonë kombëtare do ta përsërisnin bashkëkohësit dhe ai do të hynte në të edhe në literaturën e mëvonshme me emrin filozofi Riza Tefik Dibrani (Libri i Hasan Kaleshit, vepër e cituar).

FILOZOFI DR. RIZA TEFIKU

Megjithëse Riza Tefiku u mor me shkenca të ndryshme, por ky parapëlqente më shumë filozofinë. Bile këtë pasion të vetin për këtë shkencë, ai ua transmetonte shokëve dhe studentëve, ai u ngjallte dashurinë për këtë lëndë dhe i bënte ata të donin filozofinë. Kështu ai bënte një punë të veçantë. Përveç veprave që kemi përmendur më sipër, ai i pari në Turqi bëri studimin, interpretimin dhe klasifikimin e pikëpamjeve të Bekonit, dhe të Hegelit, dy koritej të filozofisë.

Filozofinë ai e studionte si mjet për të zbuluar të vërtetën, për t'iu dhënë zgjidhje problemeve që shtronte koha e jeta. Gjithashtu ai u bë një njohës i rrymave filozofike të kohës siç ishte pozitivizmi. Në një tekst të historisë së filozofisë botërore, ku flitet për filozofinë në Turqi në fund të shekullit XIX në fillim të shekullit XX përmenden shprehimisht si përfaqësues të filozofisë dy figura; Riza Tefik Dibrani dhe Zija Gokal.

Për të parin theksohet, "Filozofi Riza Tefiku" nga Dibra, me këtë emër hyri dhe në literaturën turke dhe kudo. Kështu u thirr edhe në popull. Me të drejtë profesori nga Kosova Hasan Kaleshi e quan filozofi i parë turk, në kuptimin modern.

(Vijon në numrin e ardhshëm)

Më 7 dhjetor 2013, në orët e para të mëngjesit, ndërroi jetë i pavdekshmi, Rexhep Doda.

Rexhep Doda, *shembulli i punës dhe dashurisë*

Nga **SALI AJAZI**

Më 7 dhjetor 2013, në orët e para të mëngjesit, ndërroi jetë i pavdekshmi, Rexhep Doda. Ai ishte pinjoll i shtëpisë së Dodës në Reç të Dibrës.

Falë, ish-ministrit të Arsimit, Marash Ivanaj, i cili akordoi 10 bursa shtesë, jo për miqtë e të afërmit e eputetëve, por për bijtë e patriotëve të Reç e Dardhës, duke i ndarë pesë për Reçin Dardhë, duke i ndarë pesë për Reçin e pesë për Dardhën. Një nga këto bursa iu dha familjes së njohur të Rexhep Dodës, për në internatin Mati "V" 1933-1934. Për vitet e shkollës fliste i ndjeri për mësuesit dhe drejtorin e shkollës dhe mendja e tyre përqendrohej në veçanti në kaligrafinë e shkrimit. Ata që shkruanin më bukur, mësuesi ia bënte prezent, shkrimin e tyre, drejtorit. Përmendte me konsideratë të lartë mësuesin e muzikës, i cili u mësonte këngët patriotike dhe qysh në klasën e tretë na mësoi solfezhin, Rexhepi dhe Servetja zotëronin veglat, mandolinën dhe vajza pianon. Vetëm ne të dy arritëm ti zotëronim ato vegla, me të cilat jepnin koncert lirisht për shkollën, etj. Rexhepi jo vetëm në shkollë, por për jetën e tij ishte elitar model veçanërisht në estetikë, kaligrafi dhe në memorie, dhunti këto që i vuri në veprim gjatë gjithë jetës në punët e shumta e të ndryshme e mjaft të rëndësishëm që ka kryer në interes të shoqërisë e të atdheut.

Pasi të mbaroi Internatin e Matit, në atë moshë të re merr udhën e vjen në Tiranë, për të kërkuar që të vazhdojë studimet në njërin nga internatet apo gjimnazet e kohës. Ardhja në Tiranë kishte vështirësitë e veta, si të moshës së re, largësisë dhe të tjera vështirësi ishin sepse as nuk njihte njeri, askush nuk e njihte që ta drejtonte apo strehonte. Siç tregonte edhe vetë ishte rropatur për 24 ditë në derë të Ministrisë së Arsimit dhe pas kaq kohësh e kishin pritur e nisur për në Internatin e Kastriotit në Peshkopi, që do të hapej atë vit. Por atë vit ai nuk u hap se ishte lënë për vitin tjetër. Rexhepi kthehet në shtëpi për t'u larë e për para që duheshin për udhëtim dhe niset prapë për Tiranë. Ministria e Arsimit cakton të shkojë në shkollën e Golemit, të cilën e mbaroi ashtu si të parën në Burrel edhe këtë me rezultate të shkëlqyera.

* * *

Lufta Nacionalçlrimtare edhe maturantët i bëri pjesë të saj duke i radhitur në forcat partizane. Nga gjimnazi i Gjirokastrës erdhi kushëriri Riza Doda edhe të dy bashkë u nisën të organizuar për në Dibër, takimi me komandantin Haxhi Lleshi u bë në fshatin Katund i Ri i Luznisë, në shtëpi të Ali Likës. Aty erdhi edhe Dali Ndreu, Beshir Laçi dhe tre të tjerë për të shkuar në aksionin e parë partizan. Rexhepi në vend të pushkës kishte mandolinën. Aliu i zoti i shtëpisë e pyet ç'është kjo? Rexhepi ia shpjegon dhe i thotë do ta lë këtu ta kenë fëmijët për t'u mësuar. Pas darkës kishin kënduar këngën e tre heronjve të Shkodrës në tingujt e mandolinës



Në vitet 1952-1960 Rexhep Doda ishte kryetar i Komitetit Ekzekutiv në rrethin e Dibrës. Ai e ndërtoi Dibrën me idetë e tij të ndritura. Vepra e parë ishte Bulevardi "Gjokë Doçi", lulishtja me të njëjtin emër dhe bustin e tij në mes. Kudo qyteti ishte sistemuar me blina e asfalt...

së Rexhepit dhe në orën 11.00 të natës ishin nisur drejt Dibrës së Madhe, për t'i bërë pritë italianëve tek ura e Spiles. Daliu i thotë Rexhepit se ti do të jesh ndihmësi im dhe që në nisje i dorëzon torbën e fishekëve të mitralozit. Ende pa zbardhur zunë pozicionet dhe prisnin autokolonën italiane. Erdhën makinat, autoblindat dhe filloi lufta. Aksioni i parë u krye me sukses, trupat që mbeten të gjallë u strehuan poshtë urës së Spiles. Rexhepi i kishte thënë Dali Ndreut që a të shkoj t'ju hedh këto tre bomba? Ai i kishte thën jo. Pas aksionit mbledhin trofeun dhe ngjitën në Fushë Sfidën, atje bënë analizën e aksionit dhe Daliu i propozon Haxhiut që Rexhep Dodës t'i japin një nga armët e që do ta zgjedhë vetë, komandanti i përgjigjet: pushkën ta zgjedhë dhe Rexhepin do ta marrim në Labinot, se ju tha se ishte trim. Dhe ashtu u bë. Rexhepi mori pushkën më të re.

Lufta e nisur me këtë aksion, mbaroi me çlirimin e Shqipërisë, Rexhepi ishte në Himarë dhe e ngarkuan me përgatitjen e 200 ushtarëve për t'i stërvitur, për ceremoninë që do të mbahej për të nderuar eshtrat e 200 të rënëve në tokën e Kosovës për mbrojtjen e saj. Stërvitja vazhdoi deri në datën e caktuar kur arkivolet erdhën në fshatin Lurosit të Himarës. Aty kishin ardhur nënat e tyre të gjitha të veshura me të zeza, për të marrë pjesë në rivarrimin e djemve të tyre.

Pas një lufte të gjatë për mbrojtjen e atdheut të cilët u sakrifikuan, por mbetën të dashur për në atdhe. Në tribunën e ngritur për këtë qëllim kishin ardhur autoritetet dhe ministri i mbrojtjes, Kadareja. Ceremonia filloi me parakalimin e trupës ushtarake, në krye të tyre, Rexhep Doda. Para tribunës ai kishte dhënë komandën "djathtas – ndero!". Ushtarët ishin të të njëjtës gjatësi, djem të rinj si plepa të gjatë të gjithë me mustaqe, të pajisur me armë e fishekë, realizuan tre të shtëna me breshëri njëherësh me komandën "zjarr". Me të mbaruar parakalimi, më thirri në tribunë Ministri, më uli pranë vetes, më uroi për punën e bërë. Më pyeti se ku kisha mbaruar studimet ushtarake. U përgjigja: "Shkollën Bujqësore të Kavajës!". Po këto komanda ku i ke mësuar? Prapë i tregova se kam patur ndihmën e Ferit Mukës, i cili ka mbaruar në Itali. Dhe unë ashtu ia kam marrë me shënime dhe i praktikoja gjatë stërvitjes. Dhe njëherë më përgëzoi dhe thirri Rita Markon të cilin e kishte komandant të bregdetit dhe i tha "Rexhepi nesër do të niset për në Tiranë!".

Direkt në regjimentin tankist, komisar i të parit regjiment të tillë në shqipëri me gradën major. Për kryerjen e detyrave kisthe shok veten, prandaj s'kemi pse të zgjatemi...

Aktivitetin dhe kontributin Rexhepi e ka nisur herët qysh në vitin 1942 partizan, pjesëmarrës i luftës Nacionalçlirimtare, fillimisht siç e thamë më lart, ndihmës mitralier me Dali Ndreun, pastaj n/komandant i çetës së Sllovës. Me formimin e Brigadës XVIII S ka qenë komisar i batalionit të I-rë të Brigadës, me gradën kapiten. Nga viti 1945-1952, ka shërbyer në ushtri me gradën Major, komisar në tanke.

Në vitet 1952-1960 Kryetar i komitetit Ekzekutiv në rrethin e Dibrës. Ishte ajo kohë kur Rexhepi priste të dërgohej për studime ushtarake në Akademinë Frunxe në Moskë. Edhe si kryetar Komiteti ai shkëlqen aq sa Rexhep Doda dhe Kryetari i Parës, Panariti me urdhër të Kryeministrit Mehmet Shehu, për çdo muaj merrnin 1000 lekë të vjetra mbi rrogën organike. Dibrën e ndërtoi me idetë e tij të ndritura, Rexhepi i cili e transformoi atë. Vepra e parë ishte Bulevardi "Gjokë Doçi", lulishtja me të njëjtin emër dhe bustin e tij në mes. Kudo qyteti ishte sistemuar me blina e asfalt bashkë me agrononim e talentuar Xhavit Hysa e Agush Selishtën si lulishtar. Blinat i ka marrë nga Korça e M. Grabockës.

Pas operacionit në Moskë e mbajtën në Tiranë, me detyra të rëndësishme. Fillimisht në Kryeministri, kryetar i Degës së Ankesave e Kërkesave (1961-1964), zv. President i B.Q.K. konsumit të Republikës (1966-1971), Kryetar i komitetit të Kulturës Fizike dhe Sporteve të Shqipërisë (1971-1985). Dhe në fund zv. Rektor i Universitetit Bujqësor të Kamzës, Tiranë.

Rexhepi pas të gjithë atyre detyrave të suksesshme si elitë i çdo kolektivi mori me vete dy brenga hidhëruese deri në shpirt, vdekjen e Mandës së tij, bashkëshorten e papërsëritur (Yllin e Diamantin e jetës) dhe "humbjen" e monografisë të cilën e kisha gati për botim e kushëririt e të dëshmorit të rënë në Fushë Alie, Riza Doda, kur flsite për gjoja humbjen e materialit monografik të tij, Rexhepit i ndryshonte fytyra nga inati. Desha ta kap për zverku dhe t'ia shkulja me kamë, kur më tha se: "e kam humb". Ato materiale të mbledhura nga unë që nga Zihni Sako e shokë të tjerë të Riza Dodës të gjimnazit të Gjirokastrës. Unë nuk i përkisja dhunës dhe poshtërsive skandaloze, por amanet ta kesh. Amaneti edhe ruhet, por edhe shkruhet. Rexhepi kishte bindjen e plotë se kjo monografi e mbledhur dhe e shkruar me shumë kujdes e pasion për moshatarin e zemrës ishte e përvetësuar dhe jo e humbur".

I përjetshëm dhe i paharrueshëm emri dhe veprat e tij.

Keni ndonje shqetesim per te ndare me komunitetin?

SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!

< rrugaearberit@gmail.com >

Rruga e Arbërit nr. 92

© "M&B" Botime dhe Studio Grafike
Rr. Zenel Baboçi, Pall. "Ferar", Tiranë
Tel: (04)2233283 / 0692068603 / 0686508441 / 0673073265
E-mail: mbbotime@gmail.com www.mbbotime.com
FB: M&B - Botime dhe Studio Grafike

Ideja dhe realizimi:
Miranda GOLECI,
Bujar KAROSHI,
Hysen UKA


Për botimin ndihmuan:
Gazmend KËRKUTI
Mehmet KRASNIQI
Defrim METHASANI
Hasan STAFA
NOVAMAT
Media & Sport
albPAPER

















Perëndim në Dibër. Foto: © Gazmend KËRKUTI

KALENDAR DIBRA 2014

Sponsor kryesor:
NOVAMAT
Cilësi dhe Siguri nga një dorë
Rr. "Ismail Qemali", Kulla "Fratari", Nr. 27/A, 1001, Tiranë
Tel. +355 69 40 84 371 *Fax.* +355/44 309 202.
E-mail: info@novamat.al www.novamat.al







Një kalendar kushtuar

RRUGËS SË ARBRIT dhe MBROJTJES SË RADIKËS

Firmos dhe **komento peticionit** në **change.org**

http://www.change.org/en-GB/petitions/complete-the-construction-of-the-arb%C3%ABri-road-nd%C3%ABrtoni-sa-m%C3%AB-shpejt-dhe-me-standarde-rrug%C3%ABn-e-arb%C3%ABrit?utm_campaign=petition_created&utm_medium=email&utm_source=guides

Mbro Radikën!

Të gjitha informatat me rëndësi, si shkrime, intervista, lajme, video dhe audio, lidhur me mbrojtjen e lumit Radika mund ti gjeni në: http://saveriverradika.com
Aty ka mjaft materiale për t'u informuar si dhe për të siguruar fakte për debatet tuaja. Të gjithë ata që kanw dokumente të tjera ose informacione tw panjohura, i lusim të na i dërgojnë që ti arkivojmë bashkë me të tjerat.

Kontribuo për vendlindjen duke u pajtuar në gazetën

Rruga e Arbërit.

Merr versionin PDF ose kopjen print.

Për informacion shkruaj:
<rrugaearberit@gmail.com>

cyan magenta yellow black